

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë

34

Korrik 2017

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë – 34

ÇËSHITJE EVROPIANE DHE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë tremujore për sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 34, korrik 2017

Bordi Shkencor:

MA Arjan Dymishi (kryetar)

Dr. Foto Duro (anëtar)

Dr. Elona Dhëmbo (anëtar)

Redaktor:

Besjana Kuçi

Ndihmuan në përgatitje:

Romario Shehu

Klea Ramaj

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të

Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	6
PËRSHTATJA E USHTARAKËVE SHQIPTARË PAS MISIONIT	7
REDION QIRJAZI	
SHTETET E VOGLA TË NATO-S: SHQIPËRIA SI NJË RAST STUDIMOR	38
BRANDON RUSH BURDEN, KAPITEN, USAF	
ANËTARËSIMI I MAQEDONISË NË NATO SI NJË FAKTOR I STABILITETIT RAJONAL	61
VESNA POPOSKA	
KOMPLEKSITETI I SIGURISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR: PROCESET DHE ÇËSHTJET	77
NINA SKOČAJIČ JUVAN, ANTON GRIZOLD	
VËSHTRIM MBI TREGUN E SHËRBIMEVE PRIVATE TË SIGURISË NË SHQIPËRI QË NGA MIRATIMI I LIGJIT PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE NË 2014	106
ARJAN DYRMISHI	
ENGLISH ABSTRACTS.....	120

PARATHËNIE

Revista për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë është një botim që synon të kontribuojë në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performancën e sektorit të sigurisë, prirjet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet e debatueshme dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Nëpërmjet studimeve dhe kontributit të ekspertëve dhe studiuesve të ndryshëm lidhur me sektorin e sigurisë në tërësi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), sjell në vëmendje në numrin e ri të kësaj reviste, hulumtime dhe analiza të kryera së fundmi që fokusohen në disa tematika kryesore si:

- Përshtatja e Ushtarakëve Shqiptarë pas Misionit
- Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO si Faktor i Stabilitetit Rajonal
- Shtetet e Vogla në Nato: Rasti i Shqipërisë
- Kompleksiteti i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor

Një tjetër aspekt që ky numër trajton lidhet me analizën e tregut të shërbimeve private të sigurisë në shqipëri që pas miratimit të ligjit për shërbimin privat të sigurisë fizike në 2014.

PËRSHTATJA E USHTARAKËVE SHQIPTARË PAS MISIONIT

Redion Qirjazi¹

“Ndërkohë që shprehim mirënjohjen tonë, nuk duhet të harrojmë se vlerësimi më i lartë nuk është të bëjmë premtime, por t’i mbajmë ato” -- John F. Kennedy

Abstrakt

Çështja e personelit ushtarak, dhe në veçanti e veteranëve të misioneve luftarake, që përfshihen me sistemin e drejtësisë kriminale ka qenë gjithmonë e debatuar gjerësisht ndërmjet profesionistëve dhe akademikëve të shumtë të punëve sociale dhe psikologjisë. Hulumtimet në terren kanë përcaktuar ngahera që ka një korrelacion pozitiv midis profesionit ushtarak, misioneve luftarake, traumës së luftës, stresit post traumatik dhe nivelit të kriminalitetit. Ndonëse fenomeni është studiuar me hollësi në vendet Perëndimore, çështja nuk është prekur aspak në Shqipëri, duke lejuar në këtë mënyrë akumulimin e një sërë rastesh në të cilat është përfshirë personeli ushtarak në aktivitete të dhunshme kriminale apo dhe ekstremiste.

Pas identifikimit të një sërë rastesh, ky studim është mbështetur në literaturën ekzistente, dhe një sërë analizash në terren si: intervista me ekspertë, anketimi dhe grupe fokusi për t’i kuptuar sa më mirë shkaqet dhe impaktin e fenomenit në shoqërinë Shqiptare. Ndër shkaqet kryesore të identifikuara, kryesoret janë mungesa e mbështetjes efektive psiko-sociale, të ardhura të ulëta, papunësia pas shërbimit ushtarak dhe vështirësi në ri-integrim në shoqëri. Studimi gjithashtu diskuton mbi nevojën e ndërjegjësimit më të madh social dhe institucional mbi këtë çështje si dhe ofron rekomandime mbi metodat më të mira për të reduktuar riskun që ky fenomen të përsëritet në të ardhmen.

¹ Ky artikull është shkruar në kuadër të projektit “Think Tank Young Professional Development Program” financuar nga Open Society Think Tank Fund. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e financuesit.

1. Përmbledhje ekzekutive

Kohët e fundit, në media janë komentuar shpesh një sërë ngjarjesh kriminale ku protagonistë kanë qenë anëtarë të personelit ushtarak shqiptar (aktivë apo rezervë). Në përgjithësi ka munguar diskutimi publik për shkaqet, motivet si dhe për format e reagimit sa më efektiv ndaj këtyre ngjarjeve. Qëllimi i këtij kërkimi është të sjellë në vëmendje këtë çështje duke informuar grupet e interesit për peshën që ka ky fenomen dhe duke identifikuar disa nga faktorët që i shtojnë ushtarakët shqiptarë të përfshihen në sjellje kriminale, të dhunshme dhe ekstremiste. Për më tepër, ky punim do të tentojë të nxisë një debat konstruktiv me grupet e interesit për implikimet e mundshme dhe zgjidhjet që mund t'i jepen problemit në të ardhmen. Kërkimi është fokusuar në përdorimin e literaturës akademike për ta vendosur atë mbi baza kërkimore si edhe në hulumtim në terren të përqendruar në diskutime me ekspertë, intervista të strukturuar dhe burime parësore si dokumente institucionale.

Kërkimi arrin në përfundimin se ka një lidhje të qartë mes pasojave psikologjike të misionit dhe tendencës për t'u angazhuar në aktivitete të dhunshme. Duke marrë parasysh kontekstin shqiptar dhe faktorë të tjerë, si gjendja e keqe ekonomike dhe mungesa e mbështetjes psiko-sociale, e bëjnë rrezikun edhe më të madh. Janë një sërë faktorësh që mund të ndikojnë në prirjet e ushtarakëve për përfshirje në sjellje kriminale. Megjithatë, një pjesë e mirë e këtyre faktorëve përfshihen në kategoritë e *paqëndrueshmërisë ekonomike dhe mungesës së mbështetjes psiko-sociale*. Ndonëse emëruesi i përbashkët i përcaktuar nga të gjithë ekspertët dhe vetë personeli ushtarak është mungesa e sigurisë ekonomike dhe duke pasur parasysh se profesioni i armëve është tepër kërkues dhe plot stresse, siguri i një mbështetjeje të vazhdueshme psiko-sociale për ushtarakët mund të ndihmojë në zbutjen e tendencave negative të përfshirjes në sjellje të dhunshme dhe kriminale.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura duhet të investojnë në ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për personelin ushtarak në mënyrë që të përmirësohen aftësitë operacionale dhe të ulët rrezikun e përfshirjes në aktivitete kriminale në të ardhmen. Ministria dhe Forcat e Armatosura duhet të tregohen proaktivë dhe puna e tyre të orientohet drejt zgjidhjes së problemit, ndërkohë që duhet të fokusohen në parandalimin, mbështetjen dhe ri-integrimin e ushtarakëve në nevojë. Çështja duhet të trajtohet me më shumë vëmendje për shkak të rrezikut të madh që ekziston në rastet e përfshirjes së ushtarakëve në veprimtari kriminale. Në të kundërt, ajo që Shqipëria ka hasur deri tani mund të jetë thjesht maja e ajsbergut.

2. Metodologjia

Për ta shpjeguar sa më mirë fenomenin në kontekstin shqiptar, për këtë studim u përdor një qasje e metodologjisë mikse. Kjo metodologji përfshin:

- (1) intervista me 2 ekspertë të Shërbimit Psiko-Social të Ushtrisë Shqiptare (një prej tyre vazhdon të jetë oficer aktiv), 3 ekspertë të shërbimeve për ushtarakët aktivë dhe në rezervë;
- (2) literaturë akademike për të shpjeguar se si e mbështesin studimet e deritanishme situatën me ushtarakët shqiptarë;
- (3) burime parësore, si dokumente zyrtare për të ilustruar përpjekjet (ose mungesën e tyre) e ndërmarra nga institucioni për t'u përballur me fenomenin; dhe
- (4) intervista të strukturuar në formën e anketave me anëtarë të FA, të cilët kanë shërbyer në njësi që kanë prodhuar numrin më të madh të rasteve të ushtarakëve që kanë kryer veprime kriminale.

Janë intervistuar gjithsej 32 individë nga repartet e Forcave Speciale, Komando dhe Batalioni i 2-të. Intervistat janë shpërndarë proporcionalisht ndërmjet oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve. Qëllimi i kësaj metodologjie ka qenë të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fenomenit, duke kombinuar përfundime shkencore, opinione ekspertësh, të dhëna faktike institucionale dhe së fundmi perceptimin e ushtarakëve 'në terren'.

3. Konteksti

Në 9 shkurt 2017, 2 ish-anëtarë të forcave elitare Komando kryen një grabitje me armë të 3.2 milionë dollarëve amerikanë. Paratë i përkisnin një banke të nivelit të dytë dhe po transportoheshin jashtë vendit nga një shoqëri private e sigurisë. Kjo ngjarje e detyroi Ministrin e Brendshëm të nxirrte një urdhër ku urdhërohej Policia e Shtetit "të ofronte siguri të përkohshme për transfertat e parave të bankave të nivelit të dytë derisa shoqëritë private të sigurisë të plotësonin kriteret e sigurisë."²

² Deklaratë nga Gjovalin Loka, Shef Transporti në Policinë e Shtetit, nga Arbi Fortuzi, "Rritja e sigurisë së transportit të parave nga bankat e domosdoshme, masat e kërkuara nga Ministria e Brendshme", Agjencia Telegrafike Shqiptare, 15 shkurt 2017, aksesuar 15 prill 2017, <https://www.ata.gov.al/rritja-e-sigurise-se-transportit-te-parave-nga-bankat-e-domosdoshme-masat-e-kerkuara-nga-ministria-e-brendshme/>.

Fatkeqësisht, kjo nuk është hera e parë që ish anëtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë përfshihen në aktivitete të paligjshme. Që nga 2011, rezervistë dhe forca aktive të FA janë përfshirë në grabitje, trafikim droge, mbështetje për krimin e organizuar dhe madje kanë luftuar në mbështetje të organizatave terroriste. Në total, 24 anëtarë të forcave të armatosura kanë mbështetur aktivitete kriminale ose terroriste gjatë këtyre viteve.³ Prej tyre, 3 janë dënuar për vjedhje armatimi dhe municioni, 5 kanë luftuar përkrah organizatave terroriste si ISIS (duke përbërë kështu rreth 5-7% të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që kanë luftuar në Siri)⁴ dhe 16 të tjerë janë përfshirë në aktivitete të rënda kriminale si vrasje, bashkëpunime me krimin e organizuar, trafikim droge dhe grabitje.

Deri tani këto ngjarje janë trajtuar si aktivitete të thjeshta kriminale. Duke vepruar kështu, i është vendosur kapaku përpjekjeve për të kuptuar shkaqet thelbësore që i shtyjnë ushtarakët të përfshihen në veprimtari të tilla kriminale. Strategjia e ‘reagimit’ është thjesht një përpjekje për të mjekuar simptomën dhe jo shkakun e fenomenit. Kjo gjë ngre pyetje nëse institucionet tona të sigurisë e kanë parë si problem këtë fenomen dhe nëse kanë marrë masat e nevojshme *parandaluese* duke qenë kështu proaktivë dhe jo reagues ndaj situatës.

4. Fenomeni në tërësi

Ushtarakët në rezervë gjithmonë e kanë pasur të vështirë të ri-integrohen në shoqëri. Ky fenomen shtrihet në kohë dhe në vende të ndryshme, ndonëse efektet e traumës së luftës dhe vështirësitë për ri-integrim u studiuan për herë të parë pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, studiuesit filluan të bëjnë lidhjen mes përvojës luftarake dhe vështirësive për ri-integrim social dhe prirjet për përfshirje në veprimtari kriminale vetëm pas luftës së Vietnamit.⁵ Faktorët nxitës të këtij fenomeni janë nga më të ndryshëm, por që përherë të pranishëm janë *mungesa e stabilitetit ekonomik, vështirësitë për t’u integrua*

³ Shtojca A, Tabela 2. Shënim: Tabela 2 përfshin rastet e përfshirjes kriminale por edhe një rast vetëvrasjeje për të ilustruar ndikimin e stresit post-traumatik tek ushtarakët.

⁴ Raport nga zyra e Prokurorisë së Përgjithshme në 2016; siç është e cituar në “Balkan Jihadist: The Radicalization and Recruitment of Fighters in Syria and Iraq”, *Balkan Investigative Reporting Network*, mars 2016, f. 8, aksesuar në 10 prill 2017, <http://www.balkaninsight.com/en/file/shoë/Balkan-Jihadists.pdf>.

⁵ Michael D. White, Philip Mulvey, Andrew M. Fox & David Choate, 2012 “A Hero’s Welcome? Exploring the Prevalence and Problems of Military Veterans in the Arrested Population”, *Justice Quarterly*, 29:2, 261, 2012, DOI: 10.1080/07418825.2011.560890.

në shoqëri dhe stresi. Në fakt, studime të luftërave të fundit në Afganistan dhe Irak kanë treguar se stresi është më kryesori ndër faktorët që e bëjnë të vështirë për veteranët⁶ të ri-integrohen në shoqëri. Edhe pse lidhja mes shërbimit ushtarak dhe përfshirjes në veprimtari kriminale është ende e paqartë,⁷ studiuesit kanë sugjeruar se “trauma, ekspozimi ndaj luftës, simptomat e stresit post-traumatik, abuzimi me substanca të dëmshme dhe problemet e mosintegritimit pas misionit, mund të parashikojnë mirë nivelin e kriminalitetit mes veteranëve” dhe rreziku për t’u përfshinë në një sjellje kriminale rritet eksponencialisht kur dy ose më shumë nga këta faktorë janë të pranishëm në të njëjtën kohë.⁸

Një nga pasojat më të njohura të misioneve luftarake, madje dhe të stërvitjeve ushtarake, mbi ushtarakët, është stresi post-traumatik. Hulmimet mbështesin pa ekuivok teorinë se stresi post-traumatik kontribuon në rritjen e dhunës, rrjedhimisht duke i bërë ushtarakët më të prirur për t’u angazhuar në aktivitete të dhunshme, qofshin ato në shtëpi, në komunitete apo dhe jashtë shtetit.⁹ Për më tepër, disa nga studimet më të fundit evidentojnë një lidhje të qartë mes simptomave të stresit post-traumatik dhe vetëvrasjeve.¹⁰ Nga një studim i kryer në vitin 2007 nga doktorë klinikë u zbulua se veteranët e prekur nga stresi post-traumatik kanë probabilitet 7-8 herë më të lartë për të kryer vetëvrasje.¹¹ Po ashtu, studimet kanë dëshmuar se niveli i stresit post-

⁶ Termi ‘veteran’ në Shqipëri është i rezervuar vetëm për Veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të viteve 1942-1944. Megjithatë, për qëllimet e këtij studimi të gjithë anëtarët e Forcave të Armatosura që kanë shërbyer në misionet luftarake jashtë vendit si Afganistan dhe Irak, do të referohen si ‘veteranë’.

⁷ Po aty. 265

⁸ McGuire, J., Rosenheck, R. A., & Kaspro, W. J. “Health Status, Service Use, and Costs among Veterans Receiving Outreach Services in Jail or Community Settings”. *Psychiatric Services*, 42, 201–207, 2003.

⁹ Davis Morris, “War is Hell and the Hell Rubs off”, *Slate Magazine*, 17 April 2014, aksesuar në 02 prill 2017, http://www.slate.com/articles/health_and_science/medical_examiner/2014/04/ptsd_and_violence_by_veterans_increased_murder_rates_related_to_war_experience.html.

¹⁰ Steven G. Koven, “PTSD and Suicides Among Veterans: Recent Findings, Public Integrity”, 2016, 1, DOI: 10.1080/10999922.2016.1248881.

¹¹ Zivin, K., Kim, M., McCarthy, J., Austin, K., Hoggatt, J., Walters, H., & Valenstein, M., “Suicide Mortality among Individuals Receiving Treatment for Depression in the Veterans Affairs Health System: Associations with

Patient and Treatment Setting Characteristics”, *American Journal of Public Health*, 97:12, 2007, 2193,

DOI:10.2105/ajph.2007.115477.

traumatik ka qenë më i lartë tek veteranët e luftës së Irakut dhe Afganistanit sesa tek ata të konflikteve të mëparshme që nga Lufta e Dytë Botërore, me 25% të veteranëve të prekur.¹² Prandaj, veteranët e luftërave moderne kanë probabilitet më të lartë për t'u prekur nga stresi post-traumatik. Hulumtime të tjera kanë zbuluar se “agresiviteti që rrjedh prej stresit post-traumatik është më i lartë tek personat me përvojë luftarake”¹³ dhe se “veteranët me stres post-traumatik përdorin agresivitetin si përgjigje ndaj stimulimeve sociale më shumë se personat të cilët nuk kanë stres post-traumatik.”¹⁴

Këto hulumtime kanë vlerë të veçantë, sepse ofrojnë analiza sasiore të të dhënave nga luftërat e Afganistanit dhe Irakut, konflikte në të cilat kanë marrë pjesë dhe FA të Shqipërisë që nga viti 2003. Rrjedhimisht, rezultatet janë lehtësisht të aplikueshme dhe për “veteranët shqiptarë” të këtyre luftërave.^{15*} Në këtë drejtim në Shqipëri nuk është zhvilluar asnjë kërkim klinik. Fakti se se ushtarakët shqiptarë kanë përjetuar të njëjtat trauma lufte nënkupton se (1) janë më të rrezikuar nga stresi post-traumatik sesa qytetarë të thjeshtë dhe se (2) janë më të rrezikuar të angazhohen në sjellje të dhunshme në të ardhmen. Edhe pse këto janë përfundime të përgjithshme që mund të aplikohen për të gjithë veteranët e luftës, analizimi i kontekstit të veçantë shqiptar do të jetë me rëndësi për të kuptuar spektrin e plotë të shkaqeve që mund t'i shtyjnë ushtarakët shqiptarë të përfshihen në veprimtari kriminale dhe ekstremiste.

Rasti i Shqipërisë

Përfshirja e ushtarakëve shqiptarë në aktivitete terroriste dhe kriminale është relativisht një fenomen i ri. Megjithatë, që nga viti 2011, ushtarakë shqiptarë

¹² Seal, K, Bertenthal, D., Miner, C., Sen, S., & Marmar, C., “Bringing the War Back Home: Mental Health Disorders among 103,788 U.S. Veterans Returning from Iraq and Afghanistan Seen at Department of Veterans Affairs Facilities”, *Archives of Internal Medicine*, 107:5, 2007, 476, DOI:10.1001/archinte.167.5.476.

¹³ Orth, Ulrich, & Wieland, E., “Anger, Hostility, and Posttraumatic Stress Disorder in Trauma-Exposed Adults: a Meta-Analysis”, *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 74, 2006, 698–706. DOI:10.1037/0022-006X.74.4.698.

¹⁴ Jakupcak, M., Conybeare, D., Phelps, L., Hunt, S., Holmes, H. A., Felker, B., et al., “Anger, Hostility, and Aggression among Iraq and Afghanistan War Veterans Reporting PTSD and Subthreshold PTSD”, *Journal of Traumatic Stress*, 20, 2007, 945–954.

¹⁵ * Termi ‘veteran’ në Shqipëri është i rezervuar vetëm për Veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të viteve 1942-1944. Megjithatë, për qëllimet e këtij studimi të gjithë anëtarët e Forcave të Armatosura që kanë shërbyer në misionet luftarake jashtë vendit si Afganistan dhe Irak, do të referohen si ‘veteranë’.

janë përfshirë *gjithmonë e më shumë*, në aktivitete kriminale. Në Tabelën 2 (Shtojca A) jepet një përmbledhje e të gjitha ngjarjeve që lidhin ushtarakë shqiptarë me sjellje të dhunshme ekstreme, si krime të rënda, mbështetje për terrorizmin dhe madje një rast vetëvrasjeje. Momentalisht, në Shqipëri nuk janë bërë kërkime për këtë fenomen, ndërkohë që numri në rritje i ushtarakëve që përfshihen në veprimtari kriminale bën më se të nevojshëm nisjen e një debati serioz dhe gjetjen e zgjidhjeve konkrete.

a) Sa serioz është problemi?

Është e rëndësishme të kuptohet se fenomeni nuk është një rastësi. Në literatura jepen shumë raste të lidhjes mes misionëve luftarakë dhe tendencave kriminale të ushtarakëve.¹⁶ Hafemeister dhe Stockey kanë zbuluar se “veteranët mund të jenë veçanërisht të cenueshëm nga simptomat e stresit post-traumatik, të cilat mund të lidhen me akte të dhunshme dhe sjellje të ngjashme kriminale.”¹⁷

Ky fenomen vihet re edhe në kontekstin shqiptar. Ndonëse mund të duket statistikisht natyrale që ish ushtarakë të kthehen në kriminelë duke konsideruar numrin e madh të ushtarakëve që ushtria ka trajnuar gjatë 8 viteve të fundit (që nga 2009), nga krahasimi i të dhënave vihet re se ushtarakët shqiptarë kanë qenë më të prirur drejt ekstremizmit të dhunshëm sesa homologët e tyre nga rajoni.

Fakti qëndron se 5-7% e “luftëtarëve të huaj” në Siri, të ardhur nga Shqipëria, kanë qenë ish ushtarakë, dhe kjo, në vetvete, duhet të jetë sinjal alarmi për autoritetet qeverisëse shqiptare. Kjo është ndër përqindjet më të larta të individëve të radikalizuar brenda forcave të armatosura të një vendi dhe për këtë arsye duhet hetuar me tej.

Tabela në faqen tjetër tregon numrin e ‘luftëtarëve të huaj’ të nisur nga Ballkani Perëndimor dhe që kanë qenë pjesë e forcave të armatosura:

¹⁶ Thomas Hafemeister L., Stockey, Nicole A., "Last Stand? The Criminal Responsibility of War Veterans Returning from Iraq and Afghanistan With Posttraumatic Stress Disorder," *Indiana Law Journal: Vol. 85: Iss. 1, Article 3*, 2010, pg. 94, available at: <http://www.repository.law.indiana.edu/ilj/vol85/iss1/3>.

¹⁷ Po aty. 94

#	Shteti	Ushtarakë si Luftëtarë të Huaj
1	Shqipëria	5
2	Bosnja	0
3	Kosova	0
4	Maqedonia	0
5	Mali i Zi	0
6	Serbia	0

Tabela 1: Ushtarakë të Ballkanit Perëndimor që kanë qenë ‘luftëtarë të huaj’¹⁸

Siç shihet edhe me sipër, përfshirja e personelit ushtarak në aktivitete të ekstremizmit të dhunshëm është e paprecedentë mes 5 vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (BP), të cilat argumentohet se po përballen me të njëjtat sfida social-politike. Nëse radikalizimi i ushtarakëve do të ishte rastësi, atëherë të gjitha vendet e BP duhet ta kishin përjetuar këtë fenomen. E, megjithatë, deri tani, kjo gjë është vënë re vetëm në Shqipëri.

Për më tepër, tendencat kriminale tek veteranët ushtarakë shqiptarë janë rritur që nga viti 2011. Sipas Kujtim Boriçit, një oficer ushtarak i dalë në rezervë

¹⁸ Shënim: të dhënat janë mbledhur nga një sërë burimesh (dokumente dhe ekspertë), të cilët kanë studiuar fenomenin në rajon:

1. Për Kosovën, Arife Muji informoi përmes një korrespondence se në Kosovë nuk është identifikuar asnjë rast i ushtarakëve të angazhuar si ‘luftëtarë të huaj’. Në kërkimin e saj mbi ri-integrimin e luftëtarëve të huaj nuk paraqitet asnjë e dhënë e tillë. http://www.qkss.org/repository/docs/Reintegration_842325.pdf
2. Edhe për Maqedoninë, Filip Stojkovski konfirmoi se në kërkimet e organizatës së tij nuk janë hasur raste të tilla. Po ashtu, Raporti i Analytica nuk jep gjetje të tilla http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf
3. Asnjë luftëtar i huaj boshnjak nuk ka qenë anëtar i Forcave të Armatosura. Kjo shfaqet dhe në raportin “The Lure of the Syrian War: The Foreign Fighters’ Bosnian Contingent” <https://goo.gl/adttwg>.
4. Për Serbinë, Vladimir Erceg, që punon me Qendrën Ballkanike për Politikën e Sigurisë (BCSP), informon se qendra e tyre nuk ka hasur asnjë rast të ushtarakëve serbë që shkojnë të luftojnë në konflikte të jashtme dhe se nuk ka asnjë të dhënë zyrtare që të provojë një gjë të tillë.
5. Dina Bajramspahić nga Institute Alternativa e Malit të Zi konfirmoi se burimet zyrtare në Mal të Zi nuk kanë identifikuar asnjë ushtarak që të ketë marrë pjesë si ‘luftëtar i huaj’.

dhe aktualisht gazetar, në 2008, nga rreth 4,130 të burgosur për krime të rënda, vetë 3 ishin ushtarakë dhe në të tre rastet akuza kishte qenë 'aksident automobilistik me pasojë vdekje'.¹⁹ Boriçi beson se "për aq kohë sa ushtarakët shqiptarë përballen me sfida sociale dhe ekonomike, ata do të vazhdojnë të jenë të prirur të devijojnë nga parimet etike të profesionit ushtarak dhe të ndërmarrin rreziqe duke u përfshirë në veprimtari kriminale."²⁰

Profesionistë civilë, që kanë punuar si psikologë me ushtarakë shqiptarë në të shkuarën, pohojnë se profesioni ushtarak, dhe në veçanti misionet luftarake, i bëjnë ushtarakët të angazhohen më shumë në veprimtari të dhunshme sesa qytetarët e thjeshtë. Aleksandra Puci, ish kreu i Shërbimit Psiko-Social në Ministri të Mbrojtjes, qartësisht thekson se shumë nga ish misionarët shqiptarë "janë kontigent me nivel të lartë risku për t'u rekrutuar nga grupe terroriste, pasi asnjë prej tyre nuk ka shpëtuar pa pasoja psikologjike."²¹ Po ashtu, Albana Telhai, ish kreu i Shërbimit Psiko-Social në Forcat e Armatosura, e cila ka ofruar këshillim profesional për shume prej veteranëve shqiptarë, beson se "jo vetëm këto ngjarje nuk janë rastësi, por ka shumë mundësi që ushtarakë të tjerë të përfshihen në aktivitete të ngjashme kriminale në të ardhmen."²²

Rrjedhimisht, mangësia e parë institucionale vjen nga mosvlerësimi dhe mosanalizimi i plotë i problemit. Ashtu siç mund të pritet, kjo qasje nuk është mënyra më efektive për të siguruar zgjidhje të aplikueshme. Për shembull, në një koment të kohëve të fundit për një agjenci lokale lajmesh, Ministrija e Mbrojtjes u shpreh se "ky është një problem i ngjashëm për të gjitha ushtritë" dhe se "e gjithë shoqëria duhet të çohet dhe t'i mbështesë këta njerëz ([ushtarakë në rezervë])."²³ Ndonëse kjo është e vërtetë, është po aq e rëndësishme që institucioni të përballlet me problemin për të arritur rezultate sa më efektive.

¹⁹ Intervistë me Kujtim Boriçin, 4 Maj 2017.

²⁰ Po aty.

²¹ Intervistë me Aleksandra Puci, 8 maj 2017.

²² Intervistë me Albana Telhai, 25 prill 2017.

²³ *BalkanWeb*, "Krimet e ish-Komandove/Kodheli: Problem i Gjithë Ushtrive, Jo Vetëm në Shqipëri", 6 mars 2017, aksesuar 24 Prill 2017
<http://www.lapsi.al/lajme/2017/03/06/komenti-i-mimi-kodhelit-p-r-ish-komandon-q-i-preu-kok-n-fqinjtit-sh-rbeu-para-2013#.wRj51uuGPdc>

b) *Sa i madh është rreziku?*

Analiza më elementare për përcaktimin e rrezikut bëhet përmes vlerësimit të ndikimit dhe mundësive që ka ky rrezik që të ndodhë. Në rastin e përfshirjes së ushtarakëve në aktivitete kriminale ose ekstremiste, ndikimi është i lartë dhe gjasat që ngjarja të ndodhë përsëri janë të moderuara (një gjë e tillë do të shihet edhe në perceptimin që kanë vetë ushtarakët mbi mundësinë e ndodhjes së këtij fenomeni në të ardhmen – shih rezultatet e anketës në vijim). Ky gjetje mbështetet dhe nga ekspertë të fushës, ku sipas psikologut ushtarak Daniel David, “mbi 40% e ushtarakëve të diagnostikuar me stres post-traumatik përfshihen në aktivitete kriminale.”²⁴ Është e vetëkuptueshme që ky nivel risku mund të ketë ndikim të madh social dhe përbën kërcënim për sigurinë.

Së pari, *ndikimi në shoqëri është i lartë* kur ushtarakët kryejnë sjellje të dhunshme dhe jo-sociale, pasi ata jo vetëm dëmtojnë besimin e publikut duke u shndërruar në kriminelë dhe terroristë, por edhe sepse pasojat janë gjithashtu të rënda. Për shembull, fakti që veteranët e shumë vendeve perëndimore, nga luftërat në Afganistan dhe Irak, “përfaqësojnë grupimin më të madh profesional brenda burgjeve”²⁵ ka shkaktuar shumë pakënaqësi tek njerëzit në këto shoqëri dhe madje e ka detyruar sistemin e drejtësisë të krijojë praktika gjyqësore unike për t’ju përgjigjur këtyre rasteve.²⁶

Dëmi social dhe ekonomik i shkaktuar përmes veprimeve kriminale të veteranëve shqiptarë në atdhe ka një efekt po aq të madh negativ sa edhe veprimtaria e ‘luftëtarëve të huaj’ në Siri. Në njërin krah grabitjet e bankave, pengmarrja, prodhimi i mjeteve të improvizuara shpërthyesë, bashkëpunimi me krimin e organizuar, trafikimi i lëndëve narkotike si dhe vrasja brutale e qytetarëve të pafajshëm dëmtojnë sigurinë e brendshme, ndërkohë që në krahun tjetër, pjesëmarrja e ushtarakëve shqiptarë në luftëra të huaja përkrah grupeve terroriste dëmtojnë imazhin e Shqipërisë si dhe kërcënon sigurinë kombëtare. Për shkak të natyrës së “mbyllur” të ushtrisë, çfarëdo lloj publiciteti negativ mund të ndikojë shumë negativisht në besimin e publikut

²⁴ Daniel David, “*Post-traumatic stress disorder and the causal link to crime: A looming national tragedy*” Leavenworth, KS: School of Advanced Military Studies, U.S. Army Command and General Staff College, 2008.

²⁵ Verity Wainwright, Sharon McDonnell, Charlotte Lennox, Jenny Shaw & Jane Senior, “Soldier, Civilian, Criminal: Identifying Pathways to Offending of Ex-Armed Forces Personnel in Prison”, *Psychology, Crime & Law*, 22:8, 741, 2016, DOI:10.1080/1068316X.2016.1181175.

²⁶ Judge Michael D. Hawkins, “Coming Home: Accommodating the Special Needs of Military Veterans to the Criminal Justice System”, *Ohio State Journal of Criminal Law*, Vol. 7:2, 563-573: 572, 2010, ISSN: 1546-7619.

tek institucioni. Kjo vlen për të treguar se sa herë që Forcat e Armatosura nuk angazhohen dhe nuk komunikojnë me publikun për ngjarje të papritura negative, publiku në pjesën më të madhe të rasteve do ta interpretojë si pranim të fajit nga ana e FA.

Sipas Drejtorit të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), Thoma Konduri, “shumë ushtarakë, rezervistë apo aktivë, nuk ndihen të vlerësuar për shërbimin e tyre – dhe fatkeqësisht veprimet e disa personave mund të dëmtojnë rëndë institucionin, profesionin e ushtarakut dhe vendin.”²⁷ Ushtarakët që marrin rrugën e krimit dhe të terrorizmit kanë pothuajse të njëjtin ndikim në sigurinë e vendit dhe, ndonëse anëtarë të tjerë të shoqërisë kryejnë vepra penale, për shkak të vështirësisë në profilizim, ata asnjëherë nuk identifikohen me një komunitet apo profesion të tërë si në rastin e ushtarakëve, (pra stigma negative eventualisht bie mbi të gjithë profesionin ndonëse veprimet janë individuale).

Së dyti, *probabiliteti* është i moderuar, pasi ushtarakët e kanë më të lehtë të angazhohen në veprimtari të dhunshme. Sipas *The Military Psychologist* (revista shkencore *Psikologu Ushtarak*), ushtarakët kanë më shumë mundësi të përfshihen në aktivitete të dhunshme për shkak të aftësisë dhe stërvitjes që kanë bërë për të prodhuar dhunë.²⁸ Në fakt, sipas Wainwright *et atl.*, “niveli i dhunës dhe agresionit që kultivohet gjatë shërbimit” në formën e stërvitjes ushqehet gjatë stërvitjes si pjesë e “bërjes së një ushtaraku” dhe “programimit” të tij për të shfaqur vetëbesim të tepruar dhe të ndërmarrë rreziqe më të mëdha.²⁹ Kjo është arsyeja pse emëruesi i përbashkët për të gjitha krimet e kryera nga ushtarakë shqiptarë është njohuria dhe aftësia për të përdorur sisteme të ndryshme armësh dhe të angazhohen në taktika, të cilat lehtësojnë veprimet kriminale.

Stërvitja ushtarake mund të krijojë vetëbesim të madh tek individë që dëshirojnë të përfshihen në aktivitete kriminale duke nxitur sensin e tyre të paprekshmërisë dhe duke ‘fryrë’ vetëbesimin mbi shanset e suksesit falë

²⁷ Intervistë me Thoma Konduri, 20 prill 2017.


²⁸ Brandt A. Smith, “Posttraumatic stress disorder (PTSD) in the criminal justice system: Veterans’ Treatment Courts are based on ‘drug treatment courts’ and folloë an agenda of addressing the problems that led to the criminal behavior”, *The Military Psychologist*, Prill 2014, aksesuar më 15 maj 2017,

<http://www.apadivisions.org/division-19/publications/newsletters/military/2014/04/ptsd.aspx>

²⁹ Verity Wainwright, et. al., “Soldier, Civilian, Criminal: Identifying Pathways to Offending of Ex-Armed Forces Personnel in Prison,” 749.

“ekspozimit të tyre në misione luftarake dhe stërvitje në aplikimin e dhunës.”³⁰ Prandaj, edhe nëse qëllimi për t’u angazhuar në aktivitete kriminale do të ishte i njëjte midis civilëve dhe ushtarakëve, probabiliteti i ndërmarrjes së një veprimi mbi këtë synim do të jetë më i lartë tek ushtarakët për shkak të vetëbesimit më të lartë për të qenë të suksesshëm në këto operacione.³¹ Për më tepër, në kontekstin shqiptar, rezervistët ushtarakë kanë nivel më të lartë papunësie dhe përballen me një mungesë mbështetjeje social-ekonomikë, faktorë këta që i bëjnë të jenë më të prirur për të ndërmarrë rrezikun (ngaqë ndihen se nuk kanë asgjë për të humbur).

Rrjedhimisht, një përfaqësim me grafik i nivelit të riskut që ka të bëjë me përfshirjen e ushtarakëve shqiptarë në aktivitete kriminale dhe terroriste do të dukej si më poshtë:



³⁰ Po aty. 749

³¹ Rastësisht, në 1998, gjenerali turk që përgjigjej për trajnimin e njësisë së parë të Forcave Speciale Shqiptare, paralajmëroi se “nëse këto trupa elitë nuk trajtohen si duhet financiarisht dhe moralisht, ata mund të shndërrohen në kriminelë jashtë ushtrisë.” *Koha Jonë*, “Profecia e Gjeneralit të Huaj: ‘Po s’i Trajtuat mirë, do të kthehen në Kriminelë”, 6 Mars, 2017, aksesuar 2 Prill 2017, <http://www.kohajone.com/2017/03/06/profecia-e-gjeneralit-te-huaj-per-komandot-shqiptare-nese-nuk-i-mbani-do-kthehen-ne-kriminele/>.

Sa për zhvillimet e fundit mbi këtë çështje dhe analiza bazë e riskut e përcaktuar më sipër, rekomandimi është që Ministria e Mbrojtjes të bëjë një monitorim të fenomenit dhe të përgatisë masa për të reaguar. Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera të sigurisë duhet të shqyrtojnë implikimet kriminale të FA si një kërcënim serioz për stabilitetin dhe rendin në vend, pasi në fund të fundit një kriminel i përgatitur është gjithmonë më i rrezikshëm sesa një i paafhtë.

A. Faktorët katalizatorë

Të gjitha studimet akademike, intervistat dhe konsultimet me ekspertë të fushës nxjerrin dy kategori kryesore si përgjegjëse për përfshirjen e ushtarakëve në aktivitete kriminale: (1) *paqëndrueshmëria ekonomike* dhe (2) *mungesa e mbështetjes psiko-sociale*. Duke qenë se këto kategori janë tepër të gjëra, në pjesën e mëposhtme do të diskutohen disa nga shkaqet specifike që ndikojnë prirjet e ushtarakëve drejt sjelljes kriminale dhe ekstremiste – pa dyshim, disa nga këta elementë u mbivendosen dy kategorive kryesore të përmendura më sipër.

Së pari, *neglizhenca institucionale* ka krijuar një vakum në zbatimin e politikave në mbështetje të ushtarakëve shqiptarë në detyrë. Me kalimin e kohë kjo ka krijuar një sens braktisjeje brenda anëtarëve të Forcave të Armatosura dhe një ndjesi se janë neglizhuar nga institucioni, të cilit i kanë shërbyer për një kohë të gjatë. Intervistat e strukturuar që u zhvilluan për qëllime të këtij studimi dëshmonin se edhe vetë ushtarakët besojnë se institucioni nuk ofron mbështetje të mjaftueshme. Në fakt, 80% e të intervistuarve e vendosën “mungesën e mbështetjes institucionale” si arsyen e dytë më të rëndësishme (pas “pagave të ulëta”) që mund t’i shtyjë ushtarakët drejt kriminit.³²

Shumica e ushtarakëve nuk përfitojnë nga mbështetja bazë që presupozohet të përfitohet nga statusi i tyre i veçantë.³³ Kjo përfshin shërbime karriere, mbështetje për familjen, mbështetje pas daljes në rezervë si dhe pensione

³² Intervistë e strukturuar me 32 anëtarë të FA, të mbledhur nga njësi elitë, të cilët përfaqësojnë më së miri popullatën e ushtarakëve që janë përfshirë në aktivitete kriminale në të shkuarën.

³³ Në një intervistë me të, Thoma Konduri u shpreh se ligji më i fundit “Për statusin e rezervistëve”, Ligji Nr. 10367, datë 23.12.2010, nuk po vihet në zbatim dhe të drejtat e ushtarakëve nuk po përmbushen sipas ligjit.

kalimtare, të cilat janë reduktuar në “thërrime.”³⁴ Rrjedhimisht, kjo paaftësi e institucionit për të përmbushur detyrimet bazë ndaj ushtarakëve është me shumë mundësi një nga faktorët më realë të pakënaqësisë brenda Forcave të Armatosura. Nuk është për t’u habitur që dhe ish punonjës civilë të FA, dhe në veçanti të shërbimeve psiko-sociale, e kanë dalluar këtë mangësi, për të cilën shprehen se “ushtarakët shqiptarë nuk trajtohen aspak si homologët e tyre të vendeve të tjera të NATO-s.”³⁵ Megjithatë, duhet pranuar se jo të gjitha mangësitë strukturore burojnë nga institucioni. Në fakt, ka një mungesë të dukshme vendosmërie dhe organizimi nga shoqatat e ushtarakëve për të “luftuar” për të drejtat e tyre, dhe për të njëjtësuar qëllimin e tyre duke e shpërndarë mesazhin dhe “zërin” e ushtarake tek të gjitha audiencat e mundshme. Gjithsesi, duhet pranuar se kjo vjen me së shumti si rrjedhojë e paaftësisë për t’u organizuar sesa nga mungesa e dëshirës.

E dyta, dhe ndoshta më e rëndësishme, është *të ardhura të ulëta, papunësia jo proporcionale dhe vështirësitë për t’u ri-integruar në shoqëri*. Pjesa më e madhe e anëtarëve të FA, si në shumë vende të ndryshme të botës, e gjejnë veten të papunë për një kohë të gjatë, duke qenë se njohuritë e tyre profesionale nuk përputhen me nevojat e tregut të punës jashtë ushtrisë. Për më tepër, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të përgatitur për një jetë jashtë profesionit të armëve, prandaj kur u ndodh diçka e tillë, ata janë pothuajse gjithmonë të papërgatitur për t’u përballur me realitetin e ri.

Kur kësaj i shtohen dhe *të ardhura të ulëta*, sfida për të përballuar tranzicionin bëhet shumë më e vështirë. *Sipas anketimit të zhvilluar, 86% të ushtarakëve mendojnë se arsyeja kryesore që do t’i shtynte ushtarakët shqiptarë për të marrë pjesë në akte të dhunshme dhe kriminale është ‘mungesa e stabilitetit financiar’; dhe të pyetur “çfarë mendoni se mund të bëjë institucioni për t’ju ardhur në ndihmë ushtarakëve?” të gjithë personat që iu përgjigjën pyetjes vendosën “rritje rrogash” si një nga mjetet.*³⁶ Kjo situatë nuk është unike për ushtarakët shqiptarë. Studime të shumta kanë dëshmuar se për shumë ushtarakë, “largimi nga Forcat e Armatosura është më shumë sesa thjesht largimi nga një vend pune; për ata kjo nënkupton humbje të një familjeje të

³⁴ Neritan Gjergo, Intervistë me Thoma Konduri, “Diskriminim për Ushtarakët, Kërkohet Pensioni i Merituar”, 6 qershor 2015, aksesuar, 3 prill 2017, <https://www.pressreader.com/albania/shekulli/20150606/281874412020058/> TextView.

³⁵ Intervistë me Aleksandra Pucin

³⁶ Intervistë e strukturuar me anëtarë të FA.

dytë dhe të një forme jetese.”³⁷ Për shkak të kësaj lidhjeje të ngushtë me “familjen ushtarake” dhe paaftësisë për t’u përshtatur shpejt me jetën civile, rezervistët mbeten një grupim me nivel të lartë risku social.

Tranzicioni i tyre mund të jetë veçanërisht i vështirë edhe sepse ata aplikojnë mendësinë prej ushtaraku në çdo punë të re. Kjo është pikërisht një nga arsytet më të rëndësishme se pse programet e ri-integrimit janë të rëndësishme për t’u bërë të mundur rezervistëve ushtarakë të përshtaten më lehtësisht me jetën civile pas largimit nga profesioni i ushtarakut. Sipas Jamie Grove, programet e ri-integrimit nuk ndihmojnë vetëm ushtarakët por edhe familjet e tyre duke u mësuar atyre si të mbështesin dhe menaxhojnë jetesën pas ushtrisë.³⁸

Ekspertët besojnë se sa më efektiv të jetë ri-integrimi në komunitet, aq më e lehtë do të jetë për rezervistët të përshtaten me jetën civile.³⁹ Në të kundërt, mungesa e praktikave të ri-integrimit mund të shkaktojë pasoja shumë të dëmshme, si depresion dhe vetëvrasje, pasi “sipas shumë studimeve ka një lidhje të qartë mes stresit post-traumatik, vetëvrasjes dhe shërbimit ushtarak”.⁴⁰ Fatkeqësisht, i tillë ka qenë dhe rasti i një ish operativi të Forcave Speciale Shqiptare. Rrjedhimisht, vështirësitë e integrimit vijnë prej paaftësisë për “t’u përshtatur me humbjen e *familjes së ushtrisë*, pasi ajo u krijon një sens varësie nga Forcat e Armatosura.”⁴¹

³⁷ Verity Wainwright, Sharon McDonnell, Charlotte Lennox, Jenny Shaë & Jane Senior, “Soldier, Civilian, Criminal: Identifying Pathways to Offending of Ex-Armed Forces Personnel in Prison”, *Psychology, Crime & Law*, 22:8, 747, 2016, DOI:10.1080/1068316X.2016.1181175.

³⁸ Jaime Grove, "Military Reintegration and Resiliency: An Examination of Programs and Civilian Counselor Training", Spring 2015, *Educational Specialist*. Paper 3., aksesuar më 22 prill 2017, <http://commons.lib.jmu.edu/cgi/vieëcontent.cgi?article=1006&context=edspec201019>.

Po ashtu, sipas Th. Kondurit, niveli i lartë i papunësisë tek ish ushtarakët është tepër evident në Shqipëri për shkak të mungesës së kualifikimit për tregje alternative pune.

³⁹ Veliska J. Thomas PhD, LCSW & Stan L. Bowie PhD, MSW, “Sense of Community: Is it a Protective Factor for Military Veterans?”, *Journal of Social Service Research*, 42:3, 313-314, 2016, DOI: 10.1080/01488376.2015.1109575.

⁴⁰ Steven G. Koven, “PTSD and Suicides among Veterans—Recent Findings”, *Public Integrity*, 0: 1, 2016, DOI: 10.1080/10999922.2016.1248881.

⁴¹ Verity Wainwright, Sharon McDonnell, Charlotte Lennox, Jenny Shaw & Jane Senior, “Soldier, Civilian, Criminal: Identifying Pathways to Offending of Ex-Armed Forces Personnel in Prison”, *Psychology, Crime & Law*, 22:8, 747, 2016, DOI:10.1080/1068316X.2016.1181175.

Arsyeja e tretë ka të bëjë me *distancimin nga vlerat etiko-profesionale* të Forcave të Armatosura.⁴² Udhëheqja politike ka ndikuar në shumë aspekte të profesionit ushtarak. Nga një sondazh i zhvilluar nga IDM në 2009 rreth perceptimit të personelit të Forcave të Armatosura mbi marrëdhëniet civile-ushtarake u arrit në përfundimin se në përgjithësi udhëheqja politike i tejkalon limitet e autoritetit të saj, ndërkohë që cenon kompetencat që i përkasin personelit ushtarak.⁴³ Më specifikisht, sipas kësaj ankete 60% besojnë se udhëheqësit civilë nuk kanë aftësitë e duhura për të përmbushur përgjegjësitë e tyre dhe 76% bien dakord se udhëheqësit civilë ndërhyjnë në çështje që i takojnë drejtuesve ushtarakë.⁴⁴

Personeli ushtarak vazhdimisht është përballur me zvogëlim e kompetencave në çështje të brendshme të ushtrisë dhe, rrjedhimisht, kjo është reflektuar edhe në vlerat dhe misionin e institucionit. Ky ndryshim përgjegjësish dhe rolesh ka shkuar aq larg sa ushtarakët vendosin të qëndrojnë në ushtri vetëm për të pasur mundësinë të shkojnë në misione për qëllime të pastra financiare. Ky këndvështrim i ri i të parit të institucionit thjesht si një mjet për të marrë një rrogë në fund të muajit, ndërkohë që braktisen vlerat tradicionale të profesionit, bën që shumë ushtarakë ‘të humbasin’ busullën morale dhe integritetin profesional që është i ndërthurur mbi parimet e përkushtimit ndaj atdheut dhe shoqërisë. Duke marrë në konsideratë fokusimin e ri mbi përfitimet materiale, rreziku që ushtarakët të përfshihen në veprimtari kriminale për qëllime përfitimi financiar bëhet më i madh.

E katërta, por jo nga rëndësia, ka të bëjë me *mungesën e mbështetjes efektive psiko-sociale dhe mundësimin të shërbimeve të tjera mbështetëse* për rezervistët dhe veteranët. Nën udhëzimet specifike të NATO-s, në vitin 2012,

⁴² Sipas Kolonelit në rezervë Dr. Sulejman Abazi, që ka kryer mjaft studime mbi gjendjen psiko-sociale të FA përpara dhe pas vitit 1997, ndërkohë që roli dhe vlerësimi për ushtrinë ra pas vitit 1997, po ashtu ra edhe morali i trupës. Me kalimin e kohës, mbështetja financiare, logjistike dhe përkrahja për uniformën u zbeh, dhe ushtria “humbi respektin dhe vlerësimin në shoqëri.” Rrjedhimisht, morali i ulët bëri që shumë ushtarakë të fokusohen në përfitimet financiare të profesionit, të cilat, në vetvete, duke qenë ndër më të ulëtat në administratën shqiptare, nuk ofrojnë shumë motivim për të ruajtur një respekt të palëkundur për uniformën, normat profesionale dhe madje ligjin. Në fjalët e Dr. Abazit, “ka pak dinjitet në varfëri.”

⁴³ Gjergji Vurmo, “Report: Armed Forces Perceptions on Civil Military Relations”, in *Democratic Control and Civil Military Relations – still an Unfinished Business, Institute For Democracy and Mediation*, December 2009, 125-134, accessed 28 April 2017, http://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2014/12/KONTROLLI-DEMOKRATIK-DHE-MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-CIVILO-USHTARAKE_dhjetor-2009.pdf.

⁴⁴ Po aty. 131, 133

Ushtria Shqiptare hapi Sektorin Psiko-Social, i ngarkuar me detyrën për të bërë vlerësimin psikologjik tek Forcat e Armatosura dhe në veçanti për personelit që largohej apo kthehej nga misioni. Në 1 tetor 2012, Ministri i Mbrojtjes nxori udhëzimin Nr. 10, “Për Hartimin e Politikave të Personelit të Sektorit Psiko-Social dhe Shanseve të Barabarta në FA”, në të cilin përcaktohen qëllimi, përgjegjësitë dhe rëndësia e Sektorit Psiko-Social.⁴⁵

Tetë muaj pas krijimit të këtij sektori, në maj 2013, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Shqipërisë, nxori Urdhrin Nr. 3970, datë 05.04.2013, “Për Procedurat e Vlerësimit Psikologjik të Personelit të FA”, duke listuar një sërë detyrash për t’u zbatuar nga njësi të ndryshme brenda FA, dhe me qëllim mbështetjen e nismës për të mundur shërbime psikologjike për ushtarakët.⁴⁶ Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se për herë të parë rregullohej aktiviteti i Sektorit Psiko-Social duke e formalizuar atë përmes krijimit të procedurave standarde të veprimit për punën në vijim.

Në tetor 2014 ky sektor u mbyll. Aktualisht, FA kanë shpërndarë psikologë tek njësitë ‘kyç’ të Ushtrisë Shqiptare. Megjithatë, për shkak të mungesës së koordinimit dhe planifikimit në nivel qendror, këta psikologë veprojnë të pavarur dhe pa udhëzime të përditësuara. Për më tepër, nga i gjithë grupi i psikologëve që shërbejnë në njësitë kryesore luftarake, vetëm dy prej tyre zotërojnë kualifikimet e nevojshme akademike apo profesionale për të ushtruar këto përgjegjësi.⁴⁷ Zakonisht, këta psikologë janë oficerë të thjeshtë, të cilët ngarkohen me detyrë shtesë për të ushtruar përgjegjësitë dhe kompetencat e “psikologut të njësisë.” Ata operojnë me trajnime minimale të marra në 2-3 seanca javore në kohën kur Sektori Psiko-Social ishte funksional.⁴⁸ Për më tepër, për këta psikologë kjo është një përgjegjësi dytësore, pasi detyra e tyre kryesore është të shërbejnë në shtabin e njësisive përkatëse.

⁴⁵ Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes, “Për Hartimin e Politikave të Personelit të Sektorit Psiko-Social dhe Shanseve të Barabarta në FA”, *Udhëzim Nr. 10*, 01, Tetor 2012, fq. 1-3.

⁴⁶ Xhemal Gjunksi, Shef i Shtabit të Përgjithshëm, “Për Procedurat e Vlerësimit Psikologjik të Personelit të FA”, *Urdhër Nr. 3970*, datë 05.04.2013, fq. 1-3.

⁴⁷ Intervistë me Albana Telhain, ish kreu i Sektorit Psiko-Social të AAF në Ministrinë e Mbrojtjes. Një pohim i ngjashëm konfirmohet dhe përmes një raporti të përgatitur nga *Drejtoria e Edukimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve*, “Shërbimi Psiko-Social dhe Mbështetja Psikologjike në FA: Analizë e Boshllëqeve”, përgatitur nga Aleksandra Puci, tetor 2015, fq. 3.

⁴⁸ Aleksandra Puci, “Shërbimi Psiko-Social dhe Mbështetja Psikologjike në FA: Analizë e Boshllëqeve”, *Drejtoria e Edukimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve*, tetor 2015, fq. 3, 4.

Përfundime të Ekspertëve

Disa specialist të fushës u intervistuan për të kuptuar më mirë rëndësinë e shërbimit psiko-social në reduktimin e riskut të përfshirjes së ushtarakëve shqiptarë në sjellje të dhunshme. Specialistët e intervistuar janë: Albana Telhai, Aleksandra Puci dhe një Kapiten/e që shërben si psikolog në FA por që preferon të qëndrojë anonim duke qenë se intervista nuk u miratua. Disa nga përfundimet e tyre janë:

- Rreth 20-25% të personelit ushtarak shfaqin simptoma të stresit psikologjik, ankthit, depresionit ose stresit post-traumatik. Këto simptoma intensifikohen pas çdo misioni.
- Shërbimi psikologjik duhet të forcohet më tej, pasi është shumë i dobishëm për ushtarakët
- Personeli ushtarak, ndonëse është skeptik për shkak të frikës nga stigmatizimi, ka ndjerë se shërbimi psiko-social i ka ndihmuar në punën e përditshme.
- *Ka shumë gjasa që më një numër edhe më i madh ushtarakësh të përfshihen në aktivitete të dhunshme ose kriminale.* Nga ana tjetër, me shumë mundësi sjellja e dhunshme është tashmë e pranishme në formën e dhunës në familje (ndonëse një gjë e tillë është shumë e vështirë të matet në përgjithësi në Shqipëri).

Në tetor të vitit 2015, Drejtoria e Edukimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve kreu një studim të përbashkët me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Ushtrinë Austriake me qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale të shërbimit psikologjik të Ushtrisë Shqiptare.

Raporti evidentoi një sërë problemesh me sistemin aktual, të tilla si : “numri i pamjaftueshëm profesionistësh të kualifikuar”, “mungesë mbështetjeje logjistike”, “mungesë *trajnimesh të vazhdueshme* në çështje që lidhen me shëndetin mendor”, “mungesë mbështetjeje psikologjike në misione”, “mungesë vlerësimi të përshtatshëm psikologjik pas kthimit nga misioni”, “ekzistenca e masave ndëshkimore, si nxjerrja në rezervë, për personelin që shfaq simptoma të stresit post-traumatik,” “mungesë të dhënash për të kryer studime në të ardhmen dhe “mangësi mjetesh dhe metodash për të kryer vlerësimet e duhura.”⁴⁹ Po në këtë projekt, aktorët e përfshirë në të kryen një anketim për të matur perceptimin e personelit ushtarak për shërbimin psikologjik, ku 78% u përgjigjën se shërbimi ishte “i rëndësishëm” ose

⁴⁹ Po aty. 14

“shumë i rëndësishëm” dhe 89% mendonin se një shërbim i tillë do t’i bënte FA më profesionale në tërësi.⁵⁰

Ky raport është i rëndësishëm, pasi solli në vëmendje mangësitë që ka shërbimi psikologjik që u ofrohet aktualisht ushtarakëve dhe theksoi nevojën për përmirësimin e këtij shërbimi. Kur u pyet për masat e marra dhe zbatimin e studimit, Aleksandra Puci u shpreh gjatë intervistës se Ministria e Mbrojtjes nuk pa ndonjë interes ta vazhdonte këtë projekt.⁵¹

Sot, shërbimi psiko-social funksionon më shumë si formalitet. Ushtarakët e intervistuar gjatë këtij studimi u shprehën se shërbimi aktual psiko-social nuk është efektiv në punën që bëjnë. Më se 72% e tyre u shprehën se nuk kanë plotësuar kurrë formularin e vetë-deklarimit psikologjik, ndërkohë që 75% e tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të vlerësimit ose këshillimit psikologjik. Nga ana tjetër, paradoksisht, 84% e tyre mendojnë se shërbimi mund t’i sjellë përfitime të mëdha personelit ushtarak.⁵²

Mbështetja sociale është padyshim një aspekt që përfshin një mori elementësh të tjerë, si shërbime për mbështetje për familjet, shërbime karriere, aktivitete argëtuese, mekanizma të mbështetjes financiare, shërbime mjekësore dhe shërbime të tjera civile. Ministria e Mbrojtjes nuk i ka përmbushur pritshmëritë ligjore në mundësimin e këtyre shërbimeve mbështetëse, gjë që dobëson nivelin e besimit që ushtarakët kanë tek institucioni.⁵³ Megjithatë, për shumicën e personelit ushtarak shqiptar (86% e tyre), arsyeja kryesore e shqetësimit është mirëqenia ekonomike.⁵⁴ *Në fakt, ekspertët por dhe vetë personeli ushtarak (86% e tyre) bien dakord se në kontekstin shqiptar, arsyeja kryesore që mund t’i shtyjë ushtarakët drejt sjelljes së dhunshme, kriminale apo ekstremiste, është ‘mungesa e stabilitetit ekonomik’.* Kushtet e varfra ekonomike nuk garantojnë jetesën dinjitoze të ushtarakëve dhe familjeve, gjë që çon në probleme familjare dhe rritje të stresit; me kalimin e kohës ushtarakët humbasin interes në punën e tyre dhe kërkojnë forma të tjera punësimi.⁵⁵ Ky faktor shpjegon edhe se pse mbi 250 oficerë kanë paraqitur kërkesa tek Ministri i Mbrojtjes për largim nga FA për shkak të vështirësive

⁵⁰ Po aty. 10

⁵¹ Intervistë me Aleksandra Puci,

⁵² Anketë me personelin ushtarak.

⁵³ Intervistë me Thoma Konduri.

⁵⁴ Anketë me personelin ushtarak.

⁵⁵ Korrespondencë me A. Telhai, A. Puci dhe Kapiten/e të FA

ekonomike dhe pamundësisë për të mbështetur familjet e tyre.⁵⁶ Psikologia A. Telhai e shpjegon këtë fenomen kompleks si më poshtë:

“kur ushtarakët përballen me një sërë problemesh ekonomike nga më të ndryshme, me paaftësinë për të gjetur burime alternative të ardhurash dhe me një ambient profesional shumë kërkues, tek ata lind ndjesia e mungesës së shpresës, e cila i mban ata të ‘mbërthyer’ në një gjendje të vazhdueshme apatie. Kjo situatë bën që individët të mos jenë efektivë si në punë ashtu edhe në jetën personale, pasi u frenohet motivi për vetë-zhvillim. Duke qenë se kanë pasur mungesa në jetë për një kohë të gjatë, nëse në jetën e tyre do të pësonin ndonjë krizë, do të ishin të gatshëm të ndërmerrnin risqe të mëdha, pasi janë të vetëdijshëm se kanë shumë pak për të humbur. Një formë e kësaj sjelljeje me risk të lartë është padyshim dhe përfshirja në aktivitete kriminale. Sigurisht, nëse kushtet ekonomike përmirësohen, kjo lehtëson shumë nga problemet që shfaqen në jetën private. Megjithatë, nëse nuk mund të ndryshohet ky aspekt, duhet bërë çdo gjë e mundshme për të zbutur ndikimin e stresit të shkaktuar nga profesioni (që në ushtri është shumë i lartë) përmes një mbështetjeje të mirë psiko-sociale.”⁵⁷

Pra, duket qartë se mungesa e mbështetjes psiko-sociale mund të çojë në sjellje të dhunshme dhe kriminale, por kur kësaj i bashkëngjitet dhe pasiguria ekonomike, paraqitet një lidhje e fortë midis ‘ushtarakut’ dhe ‘përfshirjes në veprimtari kriminale.’

***Çfarë mendojnë ushtarakët?*⁵⁸**

Ndonëse një pjese e madhe e këtij studimi fokusohet në hulumtime akademike dhe intervista me ekspertë, është po aq e rëndësishme të kuptohet këndvështrimi që ushtarakët ‘në terren’ kanë në lidhje me përfshirjen e personelit ushtarak në aktivitete kriminale apo ekstremiste. Në kutizën e mëposhtme jepet një përmbledhje e shkurtër e gjetjeve kryesore rreth arsyeve që ushtarakët mendojnë se janë shkaqet kryesore të këtij fenomeni. Në intervistën e strukturuar u garantua një shpërndarje e drejtë e 32

⁵⁶ Intervistë, Th. Konduri

⁵⁷ Korrespondencë me Albana Telhai

⁵⁸ Në këtë sektor do të prezantohen gjetjet e nxjerra nga intervista e strukturuar me anëtarë të FA.

pjesëmarrësve, ku 13 ishin nga Batalioni i Dytë i Këmbëorisë, 11 nga Regjimenti i Forcave Speciale dhe 8 nga Regjimenti Komando. Gjithashtu, studimi në terren përfshinte 9 oficerë, 15 nënoficerë dhe 8 ushtarë, prej të cilëve 15 ishin ushtarakë aktivë, 10 rezervistë dhe 7 preferuan të mos e deklarojnë. 73% të pjesëmarrësve (25 vetë) kishin marrë pjesë të paktën një herë në misione jashtë shtetit dhe prej tyre 80% kishin marrë pjesë në 2 ose më shumë misione (qofshin luftarake ose paqeruajtëse). Disa nga gjetjet më të rëndësishme nga ky anketim janë si më poshtë.

Gjetjet kryesore të intervistës së strukturuar me personelin ushtarak


1. Ndonëse 84.5% e të intervistuarve e shohin shërbimin psiko-social si shumë të rëndësishëm në reduktimin e tendencave për përfshirje në veprimtari kriminale, 75% e tyre deklarojnë të mos kenë zhvilluar asnjëherë vlerësim psikologjik.
2. Tre arsyt kryesore që mund t'i shtyjnë ushtarakët drejt përfshirjes në aktivitete kriminale janë:
 - a. Mungesa e stabilitetit ekonomik – 86% e vlerësuan si arsyen kryesore.
 - b. Mungesa e mbështetjes institucionale – 81% e vlerësuan si arsyen e dytë më të rëndësishme
 - c. Stresi dhe probleme psikologjike – 43% e përzgjedhën këtë si arsyen e tretë
3. 94% besojnë se profesioni i ushtarakut ka pasoja psikologjike mbi ushtarakët dhe 81% mendojnë se këto probleme rriten në rast të veteranëve. 78% kanë vënë re ndryshime në sjelljen e personelit ushtarak që kthehet nga misionet dhe 68% mendojnë se kjo ndodh *zakonisht* ose *shpesh*.
4. Mesatarisht, numri i ushtarakëve që shfaqin shenja stresi pas misionit është mes 7 dhe 10. Për koincidence, kjo shifër është e njëjtë me ato të nxjerra nga shumë studime shkencore.
5. 53% e të anketuarve besojnë se numri i ushtarakëve që në realitet janë të përfshirë në aktivitete kriminale ose ekstremiste është në fakt më i madh.
6. 75% mendojnë se të tjerë ushtarakë janë në rrezik radikalizimi dhe 2 faktorët nxitës të identifikuar janë:
 - a. Të ardhura të ulëta – 78% e zgjedhën këtë si arsyen kryesore
 - b. Mungesa e mbështetjes institucionale – 52% e zgjedhën këtë si arsyen e dytë.
7. 72% kanë njohuri për ushtarakë (aktivë apo rezervë) që janë përfshirë në aktivitete kriminale ose ekstremiste. 91% kanë njohuri për ushtarakë që vuajnë nga çrregullime të sjelljes pas misioneve ushtarake jashtë shtetit.

5. Çfarë mund të bëhet?

Hapi i parë në parandalimin e shkeljeve të mëtejshme kriminale nga anëtarë të FA është që Ministria e Mbrojtjes të marrë më shumë përgjegjësi mbi shkaqet e mundshme të fenomenit. Për më tepër, MM duhet të hartojë një strategji me anë të së cilës do t'i kushtojë më shumë burime shëndetit mendor dhe mbështetjes socialo-ekonomike të ushtarakëve shqiptarë. Strategjia duhet të ndjekë 3 parime bazë:

- A. Të jetë proaktive, jo reaguese – kjo nënkupton angazhimin në politika që njohin rëndësinë e përfshirjes së ushtarakëve (aktivë apo në rezervë) në planet afatgjatë të zhvillimit; që kuptojnë nevojat e ushtarakëve dhe hartojnë praktika për t'i përmbushur këto nevoja. Ky parim kërkon largpamësi strategjike, bashkëpunim të MM me aktorë të tjerë të rëndësishëm.
- B. Të përdoret një qasje që orientohet drejt zgjidhjes së problemit dhe jo ndëshkuese – aktualisht FA kanë pak shtysa për t'u angazhuar në raportim të aktiviteteve 'jo të përshtatshme' të ushtarakëve të tjerë për vetë faktin se institucioni i trajton problemet e brendshme me masa ndëshkimore. Kur ushtarakët dyshohen për stres post-traumatik, ata raportohen dhe zakonisht një gjë e tillë prek karrierën e tyre.⁵⁹ Gjithashtu, struktura autoritare e institucionit ua bën praktikisht të pamundur ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të organizohen me njëri tjetrin për të propozuar ndryshime. Kjo është arsyeja pse shpeshherë zgjidhje shumë të mira që mund të kalojnë nga poshtë-lart mbeten të pavëzhguara.
- C. Parandalo-mbështet-riintegro – ky cikël i vazhdueshëm do t'i bënte të mundur Ushtrisë të ruante një angazhim konstant në çështjet që shqetësojnë personelin ushtarak (aktiv dhe rezervë). Nga ana tjetër, është po aq e rëndësishme të ngrihen kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të mbështetur këtë strategji në të gjitha fazat e saj. Kjo strategji kërkon një zbatim paralel të strategjive të shumta për të përballur sfidat e shumëllojshme që mund të hasen përpara.

⁵⁹ Gjykatësi Michael D. Hawkins, "Coming Home: Accommodating the Special Needs of Military Veterans to the Criminal Justice System", *Ohio State Journal of Criminal Law*, Vol 7:2, 563-573, 563, 2010, ISSN: 1546-7619. Sipas Gjykatësit Michael Daly Hawkins, që e ka trajtuar gjerësisht përfshirjen e veteranëve ushtarakë në çështje kriminale, "fokusimi në shkeljet jo të dhunshme dhe mbështetja me një model trajtues përkundër atij ndëshkimit ka treguar efektshmëri në zgjidhjen e problemeve të stresit dhe përshtatjes me jetën civile pas kthimit nga misioni."



Disa nga veprimet specifike që mund të përmirësojnë jetën e ushtarakëve shqiptarë dhe rrjedhimisht të ulin predispozicionin e tyre drejt akteve të dhunshme dhe kriminale mund të jenë:

- 1) *Rritje pagash* – një gjë e tillë u mundëson ushtarakëve një standard jetese dinjitoze për veten dhe familjet e tyre. Stabiliteti ekonomik lehtëson stresin personal, u bën të mundur ushtarakëve të angazhohen plotësisht në misionin e tyre dhe parandalon tendencat për të kërkuar të ardhura shtesë që mund të përfitohen edhe përmes aktiviteteve të paligjshme.
- 2) *Programe të përfshirjes dhe integritit social dhe të mbështetjes sociale* – këto programe duhet të jenë në gjendje të garantojnë shërbime efektive dhe në kohë. Pjesa më e madhe e vendeve të NATO-s kanë zyra të specializuara që shërbejnë për të informuar dhe asistuar ushtarakët me procedura burokratike dhe shërbime shtesë që mund të jenë të dobishme si për shembull *shërbimet e karrierës*. Aktualisht këto programe nuk janë efikase në ushtrinë shqiptare. Programet e ri-integritit dhe përfshirjes sociale duhet të përfshijnë gjithçka duke filluar që nga konsulenca e karrierës e deri tek përgatitja e ushtarakëve për të konkurruar sa më mirë në tregun e punës. Kjo është e rëndësishme, pasi më shumë se në çdo profesion tjetër, ushtarakët e gjejnë veten *jo-proporcionalisht të papunë*. Kjo vjen kryesisht për faktin se pak profesione të tjera kanë nevojë për aftësitë teknike të ushtarakëve. Në realitet kur ushtarakët e lënë profesionin e tyre, ata do të kenë kaluar tashmë pjesën më të madhe të viteve të rinisë dhe kanë më pak përvojë për të konkurruar në profesione

të tjera. Këto programe duhet të shtrihen mjaftueshëm për t'ju komunikuar punëdhënësve të mundshëm potencialin profesional të ushtarakëve në rezervë. Shkurtimisht, në shërbimet e tjera të mbështetjes sociale mund të përfshihen rritja e bashkëpunimit me qeverinë vendore për të asistuar në ri-integrimin e ushtarakëve në shoqëri, mundësimi i shërbimeve më cilësore mjekësore për ushtarakët dhe familjet e tyre, dhënia e ndihmës financiare përmes kredive të buta, ndihmesë me kurse edukative për punësim, etj.

- 3) *Vlerësim dhe mbështetje e vazhdueshme psikologjike* – është e kuptueshme që profesioni i ushtarakut mund të shkaktojë nivele të larta stresi falë natyrës së dhunshme të profesionit. Kjo gjë është me evidente tek veteranët e luftës. Mbështetja e vazhdueshme psikologjike nuk është thjesht detyrim për të nderuar dhe vlerësuar ushtarakët për sakrificën dhe shërbimin e tyre, por është edhe një shërbim për vendin. Ky shërbim duhet të jetë shumë profesional dhe të ruhet si një strukturë e rëndësishme mbështetëse për FA. Teksa niveli i stresit të ushtarakëve ulet, po ashtu do të bie dhe rreziku i përfshirjes në aktivitete kriminale. Vlerësimi paraprak është një faktor thelbësor për të përcaktuar shëndetin mendor të ushtarakëve. Profesorët e Psikologjisë McNally dhe Shin arritën në përfundimin se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes koeficientit të inteligjencës së një ushtaraku dhe nivelit të përjetimit të stresit post-traumatik. Sipas tyre “elementë njohës mund të ndikojnë në aftësinë për të përballuar traumën, duke rezultuar në nivele të ndryshme të stresit post-traumatik.”⁶⁰ Pra, ushtarakët me shëndet të dobët mendor përbëjnë pengesë në fushëbetejë dhe një problem social në atdhe.
- 4) *Të sigurohet respektimi i statusit të familjeve të ushtarakëve* – Një gjë e tillë nuk i duhet lënë vetëm FA dhe Ministrisë së Mbrojtjes por dhe shoqatave të ushtarakëve, të cilat duhet të flasin më shpesh në emër të tyre. FA duhet të gjejë mënyra për të bashkëpunuar me homologët e tyre civilë për të garantuar një forcë të armatosur të fuqishme dhe efektive, të aftë për t'ju përgjigjur të gjitha sfidave të së ardhmes.
- 5) *Fuqizimi dhe zgjerimi i rrjetit të veteranëve* – MM në bashkëpunim me shoqatat e ushtarakëve duhet të përpiqet të organizojë një rrjet veteranësh dhe të sigurojë që të ruajnë lidhjen. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar angazhim të përhershëm të rezervistëve duke u ofruar një mundësi për të ndërvepruar, për të rritur mundësitë për punësim dhe për t'u përfshirë në një komunitet me të cilin ka një identitet të përbashkët dhe zbaton të njëjtin kod etike. Gjithashtu ky rrjet duhet të jetë vazhdimisht në

⁶⁰ Richard J. McNally and Lisa M. Shin, “Association of Intelligence with Severity of Posttraumatic Stress Disorder Symptoms in Vietnam Combat Veterans”, *The American Journal of Psychiatry*: 152:6, June 1995, 936-938, 936.

kontakt me institucionin për të ndarë me të informacione mbi zhvillimet e fundit dhe nevojat në ndryshim të FA. Bashkëpunimi mes brezave ndihmon në kalimin e përvojës për të ecur më të sigurt përpara. Fuqizimi i rrjetit të veteranëve nënkupton dhe **zgjerimin** e tij duke i njohur ushtarakët që kanë luftuar në Irak dhe Afganistan si veteranët më të rinj të Shqipërisë. Një gjë e tillë do të rriste moralin si dhe do të shërbente si një dëshmi mbi guximin dhe patriotizmin e ushtarakëve shqiptarë që kanë rrezikuar jetën për të mbrojtur interesat e vendit të tyre. Krijimi i një trashëgimie të tillë mund të jetë shumë e rëndësishme për sigurinë kombëtare përmes ruajtjes së traditës dhe krenarisë kombëtare.

- 6) *Përmirësimi i rolit të shoqatave të ushtarakëve* – Së pari, është shumë e rëndësishme që këto shoqata të mbajnë kontakte të vazhdueshme me forcat ushtarake për të mundësuar kanale komunikimi midis drejtuesve ushtarakë dhe trupave duke mundësuar që nevojat dhe kërkesat e ushtarakëve aktive dhe rezervistë të plotësohen siç duhet. Së dyti, këto organizata duhet të përdorin mjete të jashtme për të informuar dhe për të sjelle në vëmendje të publikut dhe institucioneve përkatëse problematika që shqetësojnë ushtarakët. Së treti, shoqatat e ushtarakëve duhet të shërbejnë edhe si urë lidhëse mes personelit ushtarak dhe institucioneve mbështetëse që mund t'i ndihmojnë ushtarakët dhe familjet e tyre të përballojnë vështirësitë e profesionit.
- 7) *Hartimi i elementëve normativë dhe forcimi i kodit etik ushtarak* – MM dhe FA duhet ta rrisin angazhimin e tyre me trupat për ta bërë më të qartë rolin e ushtarakëve brenda institucionit dhe brenda shtetit. Në këtë mënyrë, përforcohet sistemi i vlerave dhe lidhja e ushtarakëve me shoqërinë tonë, duke ua bërë më të vështirë atyre që të përfshihen në akte të paligjshme.
- 8) *Studime dhe monitorime* – **çdo gjë që matet dhe monitorohet, përmirësohet!** Gjërat që lihen pa u vëzhguar mund të çojnë në pasoja të paparashikueshme. Për këtë arsye, me synimin e të qenit *proaktivë*, MM dhe FA duhet të angazhohen në studime brenda institucionit për të kuptuar më mirë shkaqet e problematikave të ndryshme dhe për të qenë të aftë të ndërmarrin vendime të informuara për mënyrën se si duhet të reagojnë. Studimet mund të zhvillohen nga brenda por dhe në bashkëpunim me aktorë të jashtëm (shoqëria civile, institucione të tjera shtetërore, firma konsulencë, etj.) në varësi të nivelit të ekspertizës që kërkohet apo në varësi të qëllimit të kërkimit. Në cilindo rast, gjëja më e rëndësishme është të përfitohet sa më shumë nga kërkimi dhe zhvillimi dhe të përdoret gjetjet dhe rekomandimet e tyre për të përmirësuar punën e mëparshme. Përkujdesja ndaj ushtarakëve është një proces i pafund dhe mekanizmat për ta mbështetur këtë proces duhet të jenë të vazhdueshëm dhe të përhershëm.

Shtojca A, Tabela 2A

Nr.	Emri	Njësia	Krimi	Data e ngjarjes/ arrestimit	Dënimi	Profili	Të tjera
1	Kujtim Çeliku	Komando	Grabit dyqan bizhuterish	17 shtator 11		Nga Mulleti i Tiranës, 3 herë në Irak, 2 herë në Afganistan	Municion, lëndë eksplozive dhe arme pa leje të gjetura në shtëpi. Gati të nisej në misionin e 6-të
2	Aldo Morina	FS	Vret të dashurin e mamasë	1 janar 13	6 qershor 13		
3	Hequr konfidencialisht		Vjedhje armatimi		3 maj 13	Nënoficer furnizimi	Gjykata penale nuk e publikon emrin
4	Maringlen Bramati	FS	Vetëvrasje	tetor 13			Trauma psikologjike nga misioni
5	Diamant Rasha (Ebu Amar)	Komando	Bashkohet me ISIS - vritet	21 mars 14			Vrarë në Siri në dhjetor 2013
6	Erjon Aliaj	Komando	Bashkohet me ISIS - vritet	21 mars 14			Vrarë në Siri
7	Artur Balla (Omer)	Komando	Bashkohet me ISIS	21 mars 14			Kthyer më 5 shkurt 2014
8	Leonard Përlika	Komando	Bashkohet me ISIS	21 mars 14			Kthyer
9	Pëllumb Daçi	Komp. Mbështet.	Shet C4 në tregun e zi	19 maj 14		Major	Grupi shiti mbi 98 kg C4 dhe lëndë të tjera eksplozive
10	Ilir Dhimo	Komp. Mbështet.		19 maj 14		Rreshter	
11	Artur Çelo	Komp. Mbështet.		19 maj 14		Ushtar	
12	Emild Taku	Komp. Mbështet.		19 maj 14		Ushtar	
13	Fran Kola		Prodhon eksplozivë të telekomanduar	15 korrik 14			Përfshirë në vrasjen e biznesmenit Xhemal Çela, ekzekutimin e Baki Xhabafti dhe plagosjen e punonjësit të bashkisë Fredo Berberi
14	Kleo Gjinkola		Prodhon eksplozivë të telekomanduar	15 korrik 14			
15	Alban Donaj		Prodhon eksplozivë të telekomanduar	15 korrik 14			
16	Ndriçim Balla		Vret M.H. dhe plagos E.F. në 'Bllok'	9 shtator 13	17 shtator 14		

Nr.	Emri	Njësia	Krimi	Data e ngjarjes/ arrestimit	Dënimi	Profili	Të tjera
17	Sokol Feka	Forcat Ajrore	Transport droge nga Maroku në Spanjë	29 Janar 2015		Major në Forcat Ajrore. Pilot	Vdes gjatë një operacioni trafikimi, pasi rrëzohet helikopteri
18	Romin Davidhi	Forcat Detare	Trafik lëndësh narkotike		15 qershor 16	28 vjeç nga Durrësi	
19	Hequr konfidencialisht		Vjedhje municioni		09 qershor 16		Gjykata penale nuk e publikon emrin
20	Hequr konfidencialisht	Njësia 100	Vjedhje armatimi, municioni, falsifikim dokumentesh		26 qershor 16	Njësia 100	Gjykata penale nuk e publikon emrin
21	Medat Hasani	Komando dhe FS	Arrestuar për komplot terrorist në ndeshjen e futbollit Shqipëri-Izrael		8 nëntor 16	6 muaj në Irak	U largua në 28.7.2013 për në Siri dhe u kthye në dhjetor 2013. U radikalizua pas largimit nga ushtria. Do të mundësonte bombat e telekomanduara për t'u përdorur në stadium.
22	Ditjon Memlika	Komando	Grabit 3.2 milionë dollarë (Qafë Kashar)	9 shkurt 17		Larguar për arsye disiplinore. Një vit mision në Afganistan	
23	Naim Avdulaj	Këmbësori				Larguar nga ushtria	Kumarxhi. Arrestuar në Itali në 2012 për trafikim droge.
24	Alban Voda	Komando	Vret fqinjën duke i prerë kokën	5 mars 17		Gjendje e rëndë psikologjike. Kabul 2010-2011; Herat janar-korrik 2012	
25	Drilon Shqau	Logjistikë	Trafikim lëndësh narkotike Tiranë	29 prill 17			Komandant skuadre në Pezë Helmës

Bibliografia

- Davis Morris, “War is Hell and the Hell Rubs off”, *Slate Magazine*, 17 April 2014, aksesuar më 02 prill 2017,
http://www.slate.com/articles/health_and_science/medical_examiner/2014/04/ptsd_and_violence_by_veterans_increased_murder_rates_related_to_war_experience.html.
- Jaime Grove, “Military Reintegration and Resiliency: An Examination of Programs and Civilian Counselor Training”, Spring 2015, Educational Specialist. Paper 3., aksesuar më 22 prill 2017,
http://commons.lib.jmu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1006&context=ed_spec201019
- Judge Michael D. Hawkins, “Coming Home: Accommodating the Special Needs of Military Veterans to the Criminal Justice System”, *Ohio State Journal of Criminal Law*, Vol 7:2, 563-573, 563, 2010, ISSN: 1546-7619
- McGuire, J., Rosenheck, R. A., & Kasproë, W. J. “Health Status, Service Use, and Costs among Veterans Receiving Outreach Services in Jail or Community Settings”. *Psychiatric Services*, 42, 201–207, 2003.
- Michael D. White , Philip Mulvey , Andrew M. Fox & David Choate (2012) A Hero’s Welcome? Exploring the Prevalence and Problems of Military Veterans in the Arrestee Population, *Justice Quarterly*, 29:2, 258-286. DOI:10.1080/07418825.2011.560890.
- Richard J. McNally and Lisa M. Shin, “Association of Intelligence ëith Severity of Posttraumatic Stress Disorder Symptoms in Vietnam Combat Veterans”, *The American Journal of Psychiatry*: 152:6, June 1995, 936-938, 936
- Seal, K, Bertenthal, D., Miner, C., Sen, S., & Marmar, C. (2007) “Bringing the War Back Home: Mental Health Disorders among 103,788 U.S. Veterans Returning from Iraq and Afghanistan Seen at Department of Veterans Affairs Facilities”, *Archives of Internal Medicine*, 107:5, 2007, 476–48. DOI:10.1001/archinte.167.5.476
- Steven G. Koven, “PTSD and Suicides Among Veterans: Recent Findings, Public Integrity”, 2016, 1-13, DOI: 10.1080/10999922.2016.1248881.
- Zivin, K., Kim, M., McCarthy, J., Austin, K., Hoggatt, J., Walters, H., & Valenstein, M. (2007). Suicide mortality among individuals receiving treatment for depression in the Veterans Affairs health system: Associations with patient and treatment setting characteristics. *American Journal of Public Health*, 97(12), 2193–2198. DOI:10.2105/ajph.2007.115477
- Sulejman Abazi, *Hapësira Psiko-Sociale Brenda Forcave të Armatosura*, (Shtëpia e Botimeve Ushtarake: 2000).

- Daniel David, “Post-traumatic stress disorder and the causal link to crime: A looming national tragedy” Leavenworth, KS: School of Advanced Military Studies, U.S. Army Command and General Staff College, 2008.
- Brandt A. Smith, “Posttraumatic stress disorder (PTSD) in the criminal justice system: Veterans' Treatment Courts are based on ‘drug treatment courts’ and follow an agenda of addressing the problems that led to the criminal behavior”, *The Military Psychologist*, April 2014, aksesuar më 15 maj 2017, <http://www.apadivisions.org/division-19/publications/newsletters/military/2014/04/ptsd.aspx>
- Orth, Ulrich, & Wieland, E., “Anger, Hostility, and Posttraumatic Stress Disorder in Trauma-Exposed Adults: a Meta-Analysis”, *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 74, 2006, 698–706. DOI:10.1037/0022-006X.74.4.698.
- Jakupcak, M., Conybeare, D., Phelps, L., Hunt, S., Holmes, H. A., Felker, B., et al., “Anger, Hostility, and Aggression among Iraq and Afghanistan War Veterans Reporting PTSD and Subthreshold PTSD”, *Journal of Traumatic Stress*, 20, 2007, 945–954.
- Hafemeister, Thomas L., Stockey, Nicole A. “Last Stand? The Criminal Responsibility of Ęar Veterans Returning from Iraq and Afghanistan Ęith Posttraumatic Stress Disorder,” *Indiana Law Journal: Vol. 85: Iss. 1, Article 3*, 2010, gjendet në adresën: <http://www.repository.law.indiana.edu/ilj/vol85/iss1/3>
- Wainwright, Verity, Sharon McDonnell, Charlotte Lennox, Jenny Shaw and Jane Senior. “Soldier, Civilian, Criminal: Identifying Pathways to Offending of Ex-Armed Forces Personnel in Prison.” *Psychology, Crime & Law*, 22:8, 741-757, 2016. DOI:10.1080/1068316X.2016.1181175.
- Enri Hide, “Raport: Opinioni publik mbi Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura”, në *Kontrolli Demokratik dhe MarrĘdhĘniet Civilo-Ushtarake – një punë e papĘrfunduar, Instituti pĘr Demokraci dhe NdĘrmjetĘsim*, dhjetor 2009, 95-97, aksesuar më 28 prill 2017, http://idmalbania.org/ĕp-content/uploads/2014/12/KONTROLLI-DEMOKRATIK-DHE-MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-CIVILO-USHTARAKE_dhjetor-2009.pdf.
- Veliska J. Thomas PhD, LCSW & Stan L. Bowie PhD, MSW, “Sense of Community: Is it a Protective Factor for Military Veterans?” *Journal of Social Service Research*, 42:3, 313-331, 2016, DOI: 10.1080/01488376.2015.1109575.

Intervista dhe korrespondenca

IntervistĘ me Albana Telhain, ish kreu i Sektorit Psiko-Social tĘ FA, në Ministrinë e Mbrojtjes

Intervistë me Thoma Kondurin, kreu i Shoqatës Kombëtare e Ushtarakë në Rezervë të Shqipërisë
Intervistë me Aleksandra Pucin, ish kreu i Shërbimeve Psiko-Sociale në Ministrinë e Mbrojtjes
Intervistë me Kujtim Boriçin, ushtarak në rezervë, aktualisht gazetar që mbulon aktivitetin e FA.
Intervistë me Sulejman Abazin, Kolonel në rezervë, autor i librit “*Hapësira Psiko-Sociale Brenda Forcave të Armatosura*”
Intervistë me kapiten/e të FA (anonim) – momentalisht psikolog në FA. Emri është hequr me kërkesë të të intervistuarit.
Intervistë e strukturuar me ushtarakë të FA
Korrespondencë me Albana Telhai

Dokumente zyrtare

Aleksandra Puci, Raport “Shërbimi Psiko-Social dhe Mbështetja Psikologjike në FA: Analizë e Boshllëqeve”, përgatitur nga Aleksandra Puci, *Drejtoria e Edukimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve*, Tetor 2015.
Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes, “Për Hartimin e Politikave të Personelit të Sektorit Psiko-Social dhe Shanseve të Barabarta në FA”, *Udhëzim Nr. 10*, 01, Tetor 2012.
Xhemal Gjunksi, Shef i Shtabit të Përgjithshëm, “Për Procedurat e Vlerësimit Psikologjik të Personelit të FA”, *Urdhër Nr. 3970*, datë 05.04.2013
Raport nga Prokuroria e Shqipërisë në vitin 2016; cituar në “Balkan Jihadist: The Radicalization and Recruitment of Fighters in Syria and Iraq”, *Balkan Investigative Reporting Network*, Mars 2016, fq. 8, aksesuar 10 prill 2017, <http://www.balkaninsight.com/en/file/shoë/Balkan-Jihadists.pdf>.

Artikuj gazetash

Neritan Gjergo, Intervistë me Thoma Kondurin, “Diskriminim për Ushtarakët, Kërkohe Pensioni i Merituar”, 6 qershor 2015, aksesuar më 3 prill 2017, [https://www.pressreader.com/albania/shekulli/20150606/281874412020058/ TextView..](https://www.pressreader.com/albania/shekulli/20150606/281874412020058/TextView..)
Deklaratë nga Gjovalin Loka, Shef Transporti në Policinë e Shtetit, nga Arbi Fortuzi, “Rritja e sigurisë së transportit të parave nga bankat e domosdoshme, masat e kërkuara nga Ministria e Brendshme”, Agjencia Telegrafike Shqiptare, 15 shkurt 2017, aksesuar më 15 prill 2017, <https://www.ata.gov.al/rritja-e-sigurise-se-transportit-te-parave-nga-bankat-e-domosdoshme-masat-e-kerkuara-nga-ministria-e-brendshme/>.
BalkanWeb, “Krimet e ish-Komandove. Kodheli: Problem i Gjithë Ushtrove, Jo Vetëm në Shqipëri”, 6 mars 2017, aksesuar më 24 prill 2017

<http://www.lapsi.al/lajme/2017/03/06/komenti-i-mimi-kodhelit-p-r-ish-komandon-q-i-preu-kok-n-fqinjit-sh-rbeu-para-2013#.WRj51uuGPDc>
Koha Jonë, “Profecia e Gjeneralit të Huaj: ‘Po s’i Trajtuat mirë, do të kthehen në Kriminelë”, 6 mars, 2017, aksesuar më 2 prill 2017,
<http://www.kohajone.com/2017/03/06/profecia-e-gjeneralit-te-huaj-per-komandot-shqiptare-nese-nuk-i-mbani-do-kthehen-ne-kriminele/>.

SHTETET E VOGLA TË NATO-S: SHQIPËRIA SI NJË RAST STUDIMOR

Brandon Rush Burden, Kapiten, USAF

ABSTRAKT

Ky studim analizon Shqipërinë, një nga anëtarët e Aleancës, si një rast studimor në debatin nëse shtetet e vogla shërbejnë si importuese apo gjeneruese të sigurisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Studimi hulumton hipotezën se në tërësi përfitimet e NATO-s lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë i tejkalojnë kostot. Për të shqyrtuar avantazhet dhe kostot e anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancë do të analizohet procesi i anëtarësimit dhe zhvillimi i rolit dhe potencialit të saj për një kontribut më të madh.

Ky hulumtim analizon gjithashtu kontributin e Shqipërisë në NATO përgjatë anëtarësimit të saj në Partneritetin për Paqe (PpP) në 1994-2009 dhe si anëtare të Aleancës që nga viti 2009. Ky studim arrin në përfundimin se, pavarësisht ekonomisë së dobët, çështjeve të brendshme dhe numrit të vogël të forcave ushtarake, Shqipëria vlerësohet si një anëtare e çmuar e Aleancës që ofron kapacitete të rëndësishme në mbështetje të detyrave kryesore të NATO-s.

1. Konteksti

Shqipëria është një nga anëtarët më të reja të NATO-s dhe anëtarësimi i saj në Partneritetin për Paqe (PpP) (1994-2009) së bashku me shtatë vitet e veprimtarisë së saj si anëtare në Aleancë, shërbejnë si një rast i vetëm studimor për të treguar sesi një shtet i vogël mund të sillt si një ofrues sigurie në Aleancë. Që nga marrja e anëtarësimit në NATO në vitin 2009, Shqipëria ka vijuar me reformat dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e Aleancës që i filloi si anëtare e PpP.

Ky hulumtim përshkruan se si Shqipëria ka performuar në Aleancë nëpërmjet politikave të saj ekonomike, modernizimit ushtarak, dhe pjesëmarrjes në detyrat kryesore të NATO-s për mbrojtjen kolektive, bashkëpunimin për siguri dhe menaxhimin e krizave. Rezultatet e këtyre veprimeve ilustrojnë avantazhet dhe kostot e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ndikimi që Shqipëria ka pasur në NATO shërben si një shembull për të treguar se si

shtetet e vogla ndikojnë në Aleancë, duke vepruar kështu si një pikë referimi për zgjerimin e ardhshëm të Aleancës. Sigurisht që aleatët nuk mund të përgjithësojnë për të gjithë anëtarët e vegjël të Aleancës nisur nga një rast i vetëm. Megjithatë, performanca e Shqipërisë si një shtet aleat shtrun pyetje dhe i përgjigjet ështëjeve me rëndësi thelbësore për të ardhmen e NATO-s. Rasti i Shqipërisë demonstroi se një aleat i vogël mund të japë kontribute të rëndësishme.

2. Ekonomia

Ekonomia është faktor nxitës ose kufizues në pothuajse të gjitha funksionet e një qeverie. Ky seksion shqyrton ekonominë e Shqipërisë në dy nivele të ndryshme - makro dhe mikro. Në nivelin makro, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i vendit shqyrtohet përgjatë disa viteve, dhe në nivelin mikro, identifikohen pagat e punëtorëve dhe personelit ushtarak shqiptarë. Norma e PBB-së nuk do të thotë domosdoshmërisht një ekonomi e varfër, por një pasqyrim i PBB-së përgjatë disa viteve mund të japë të dhëna për ecurinë e një ekonomie. Në të njëjtin kontekst, niveli i pagave në një vend nuk tregon performancën e ekonomisë, por një vështrim krahasues jep një pasqyrë të problematikave të mundshme vendase.⁶¹

Aktualisht në Shqipëri ka një hendek të madh pagash midis të pasurve dhe të varfërve, që në përgjithësi rezulton në shpenzime individuale të kufizuara. Rrogat mujore në të gjithë vendin janë midis 160 dhe 9,000 euro, me një pagë mesatare prej 406 euro-sh. Paga për orë pune është rreth 1.8 euro në orë përkundrajt 6 deri në 8 euro në orë në vendet e tjera evropiane.⁶² Ky boshllëk në nivelet e fitimit ndërmjet punëtorëve demonstroi një sistem polarizues që përbëhet nga një klasë e mesme e dobët. Pagat e ulëta të një punëtori mesatar e përforcojnë më tej këtë çështje, veçanërisht kur bëhet krahasimi me vendet e tjera evropiane.⁶³

Paga e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FASH) është gjithashtu shumë e ulët, ku paga e një ushtari është gati sa gjysma e pagës mesatare të një

⁶¹ "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)" Njoftim për shtyp. Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior, 4 korrik, 2016, http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2016_07/20160704_160704-pr2016-116.pdf.


⁶² Edison Kurani, "Salaries in Albania, Drastic Gap between the Minimum and Maximum Pay," *Independent Balkan News Agency*, May 4, 2015, <http://www.balkaneu.com/salaries-albania-drastic-gap-minimum-maximum-pay/>.

⁶³ "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)."

punëtori në Shqipëri. Disa nga pagat mujore sipas gradave të ndryshme janë: 222 euro për gradën më të ulët, 425 euro për oficerët e të lartë me 26 vite shërbim, dhe 1,114 euro për gradën gjeneral i përgjithshëm me tre vje dhe me 26 vite shërbim.⁶⁴ Gjendja e dobët e klasës së mesme tregon se ka pak para që qarkullojnë brenda vendit. Madhësia e vogël e Shqipërisë tregon gjithashtu se është e nevojshme marrëdhënia me tregjet ndërkombëtare për të përmbushur nevojat e brendshme, duke rritur kështu koston e artikujve të zakonshëm.

Lajmi pozitiv në lidhje me pagat në vend është se që kur Shqipëria iu bashkua Aleancës, ka pasur një rritje të vazhdueshme të pagës mesatare mujore të punëtorëve të saj, siç shihet në Tabelën 2. Shifrat në të majtë janë në Lekë dhe përfaqësojnë pagën mujore sipas vitit. Linja blu pasqyron ndryshimet e pagave në rritje. Sipas Tabelës 2, në vitin 2009 paga mesatare ishte e rreth 265 euro në muaj. Tremujori i parë i 2016-ës pësoi një rritje të vazhduar të pagës mesatare dhe regjistroi nivelin më të lartë të të gjitha kohërave me rreth 400 euro në muaj.⁶⁵ Në bazë të përqindjes, kjo është një rritje e ndjeshme, gjë që nënkupton se mund të ketë paga më të mira në të ardhmen. Përkundër ndryshimit të pagave gjatë disa viteve, përgjithësisht Shqipëria është ende prapa shumë vendeve evropiane.

Figura 1. Pagat shqiptare nga 2006 në 2016⁶⁶



⁶⁴ "Fletorja Zyrtare E Republikës Së Shqipërisë" (Tiranë, 16 korrik, 2015), www.qbz.gov.al. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare,


⁶⁵ "Albania Average Monthly Wages," Trading Economics, e aksesuar në 8 gusht, 2016, <http://www.tradingeconomics.com/albania/ëages>.

⁶⁶ Burimi: Ibid.

Në nivelin makro, Shqipëria është prapa në krahasim me çdo anëtar të Aleancës po të nisemi nga PBB-ja reale. Në vitin 2015, PBB-ja e raportuar e Shqipërisë ishte 13 miliardë dollarë. Islanda dhe Estonia, kombet më të afërta me Shqipërinë, patën përkatësisht PBB prej 15 dhe 23 miliardë dollarë. Për sa i përket PBB-së për frymë, Shqipëria ka shifrat më të ulëta të raportuara me 4.500 dollarë të PPB-së për frymë.

Islanda dhe Estonia kanë raportuar përkatësisht 47,300 dollarë dhe 18,100 dollarë për frymë. Shqipëria është në thelb vendi më i varfër në nivel kombëtar dhe individual në Aleancë. Ky kufizim në qarkullimin e parave redukton atë që vendi mund të bëjë. Lajm i mirë për Shqipërinë është se PBB-ja e saj vjetore ka vijuar të rritet që nga pranimi i saj në NATO në vitin 2009, ashtu si paga mesatare e punëtorëve, siç përshkruhet në Tabelën 3.⁶⁷

Figura 2. PBB real i Shqipërisë nga 2009 në 2016.⁶⁸



3. Shpenzimi në mbrojtje dhe planifikimi afatgjatë


Ekonomikisht, Shqipëria është qartazi mbrapa pjesës tjetër të aleatëve lidhur me aftësinë e saj për të gjeneruar të ardhura dhe për të paguar punëtorët e saj. Pavarësisht kësaj pozite të dobët ekonomike, Shqipëria arrin t'ia kalojë rreth

⁶⁷ "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)."

⁶⁸ Përshtatur nga Ibid.

gjysmës së anëtarëve të Aleancës në aspektin e shpenzimeve ushtarake si përqindje e PBB-së së saj. Për shembull, Kanadaja, Gjermania, Italia dhe Holanda kanë shpenzuar të gjitha më pak se Shqipëria si një përqindje e PBB-së së tyre që nga korriku i 2016-ës. Që nga viti 2009, shpenzimet e Shqipërisë si përqindje e PBB-së kanë rënë, siç është paraqitur në Tabelën 4, por ritmi i shpenzimeve është ende konkurrues midis aleatëve.⁶⁹ Për më tepër, shumta e shpenzimeve për mbrojtjen për frymë në Shqipëri është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2009 deri në vitin 2016, nga 3,900 në 4,700 dollarë.⁷⁰

Figura 3. Shpenzimi i Shqipërisë në Mbrojtje nga 2009 në 2016⁷¹



Shqipëria demonstroi se një shtet i vogël dhe ekonomikisht i dobët mund të tejkalojë shumë anëtarë më të fortë dhe më të pasur të Aleancës në aspektin e shpenzimeve të mbrojtjes. Çdo vit, të gjithë anëtarët e NATO-s raportojnë PBB-të e tyre kombëtare së bashku me sasinë e parave që kanë shpenzuar për mbrojtjen. Shpenzimet e qëndrueshme të mbrojtjes nga vendet e vogla me ekonomi më të dobëta si Shqipëria, në përputhje me PBB-të e tyre, janë të dukshme duke marrë parasysh rëndësinë e çdo dollari për ekonominë e tyre. Për shembull, PBB-ja e Shqipërisë është më pak se 1 përqind e PBB-së së

⁶⁹ Ibid.


⁷⁰ Ibid., 6.

⁷¹ "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)."

SHBA-ve.⁷² Shqipëria nuk kontribuon një shumë të madhe parash në terma absolutë, por po bën një përpjekje të konsiderueshme nëpërmjet përqindjes së PBB-së së saj. Shqipëria synon të rrisë shpenzimet e saj në 2 përqind të PBB-së deri në vitin 2025 me qëllim që të përmbushë qëllimin e modernizimit, si dhe normën e shpenzimeve të mbrojtjes të Aleancës për anëtarët.⁷³ Kjo përpjekje e fuqishme për alokimin e të ardhurave për mbrojtje ka qenë e vazhdueshme për Shqipërinë që nga kohët e PpP deri tek pranimi i saj në NATO në vitin 2009, dhe deri më tani.

Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) i shpenzojnë paratë e tyre në masë të madhe për paga personeli, gjë që kufizon kapacitetin e tyre për të modernizuar strukturat dhe pajisjet. Shqipëria ka në plan ta ndryshojë këtë bilanc në mënyrë të konsiderueshme deri në vitin 2025, duke bërë që shpenzimet për paga personeli të ulen deri në 35 përqind nga 66 përqind në 2016, siç pasqyrohet në Tabelën 5. Kjo do të bëhet që të krijohen mundësi për përmirësimin e infrastrukturës dhe prokurimin e pajisjeve sipas standardeve të NATO-s. Shqipëria synon gjithashtu të përdorë një pjesë të buxhetit të rikonfiguruar të mbrojtjes për të investuar në kërkimin shkencor të mbrojtjes me fonde që priten pas vitit 2020.⁷⁴ Ky është një plan ambicioz që varet nga ekzekutimi i duhur i buxhetit.

Figura 4. Shpenzimet e Ushtrisë Shqiptare në vitin 2016⁷⁵



⁷² Ibid.

⁷³ "The Armed Forces Long-Term Development Plan 2016-2025," Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, 38, e aksesuar në 12 shtator, 2016, www.mod.gov.al.

⁷⁴ Ibid.

⁷⁵ Përshtatur nga "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)."

Pjesa tjetër e shpenzimeve të mbrojtjes së Shqipërisë është përshkruar në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025 (PAZHFA 2016-2025). Plani fokusohet në përmbushjen e nevojave dhe në ndërtimin e kapaciteteve bazuar në objektivat e Strategjisë Ushtarake të Shqipërisë dhe Strategjisë Kombëtare të Sigurisë. Këto strategji parashikojnë nevojat e Shqipërisë si dhe detyrimet e saj ndaj Aleancës.⁷⁶ Qëllimet specifike janë të ndara në PAZHFA 2016-2025 sipas kategorive të ndryshme në vite.

Nën kategorinë e stërvitjes, për shembull, gjatë tre viteve të para, plani parashikon përmirësime të infrastrukturës për tre vendet e saj të qitjes dhe për objektet e trajnimit. Në tre vitet e ardhshme, Shqipëria planifikon të hapë një qendër të re trajnimit në Zall-Her. Më pas, në katër vitet e fundit të afatit të planit, Shqipëria synon të përmirësojë një tjetër strukturë trajnimit. Të gjitha këto struktura do të ndjekin udhëzimet e standardizimit të NATO-s dhe marrëveshjet për të përmirësuar kapacitetet integruese të FASH në operacionet e NATO-s.

Forcat tokësore janë një fushë tjetër e planifikuar për shpenzimet e ardhshme të mbrojtjes. Në tre vitet e para pritet të krijohet një forcë e madhe me një batalion prej 1,000 ushtarësh të aftë për shërbim ushtarak gjatë një periudhe gjashtë mujore me mbështetjen e shërbimit ushtarak të NATO-s. Gjithashtu, Shqipëria parashikon të krijojë një Njësi/Grup të Posaçëm të Operacioneve Speciale që vepron sipas standardeve të NATO-s. Në tre vitet e ardhshme parashikohet një batalion i këmbësoresë, me aftësinë për të përmbushur detyrat e NATO-s për një periudhë gjashtëmujore. Së fundi, midis viteve 2022 dhe 2025, forcat tokësore pritet të operojnë me automjete ajrore dhe tokësore pa pilot. Gjithashtu parashikohet të krijohet edhe një njësi taktike funksionale për kontrollin e ajrit që do t'u mundësojë forcave tokësore të kërkojnë në mënyrë efektive mbështetje ajrore për të ulur njësitë sipas nevojës.⁷⁷

Këto objektiva, së bashku me objektivat e tjera të listuara në PAZHFA 2016-2025, ofrojnë një plan që çon drejt një force ushtarake të modernizuar dhe të aftë. Disa nga këto objektiva janë shumë ambicioze, ndërsa të tjerat mund të arrihen më me lehtësi. Çelësi për realizimin e tyre në tërësi është financimi dhe alokimi i duhur i burimeve. Shpenzimet për mbrojtjen nga viti 2016 nuk janë në nivelin e pritshëm nga NATO, por me këtë plan Shqipëria parashikohet të shpenzojë 2 për qind të PBB-së së saj për mbrojtjen deri në

⁷⁶ Ibid., 1–3.

⁷⁷ Ibid., 17–19.

vitin 2025. Përbushja e planit nuk garantohet vetëm nga financat, megjithëse ato përbëjnë një faktor të rëndësishëm.

4. Kontributet dhe angazhimet në NATO

Vendet e vogla brenda Aleancës janë të gatshme dhe të afta të kontribuojnë në mënyrë thelbësore. Angazhimi i Shqipërisë si një gjenerues i sigurisë në Aleancë nuk reflektohet vetëm nga mënyra se si vendi shpenzon paratë e veta, por edhe nga mënyra se si vepron në kuadër të detyrave kryesore të NATO-s për mbrojtjen kolektive, bashkëpunimin për sigurinë dhe menaxhimin e krizave. Ky seksion shqyrton Objektivat e Forcës (OF) për të cilat Shqipëria ka dakordësuar që t'i ndjekë në kuadër të NATO-s, dhe pastaj shqyrton në detaje se si Shqipëria ka përbushur detyrimet kryesore ndaj NATO-s, duke përdorur shembuj nga anëtarësimi i Shqipërisë në PpP dhe në NATO përgjatë 2016-ës, siç është Direktiva e Mbrojtjes për vitin 2016. Kjo pasqyrë e kontributeve dhe angazhimeve të Shqipërisë demonstroi nivelin e përfshirjes së vendit në Aleancë.

5. Qëllimet e Forcës

Në vitin 2008, ndërsa Shqipëria përgatitej të anëtarësohej në Aleancë nëpërmjet një protokollit pranimit, filloi rishikimi i Objektiveve të Partneritetit (OP), që do të krijonte bazat për Objektivat e Forcës. Dallimi midis OP-ve dhe OF-ve është se OP-të janë specifikisht për partnerët e NATO-s. “Objektivat e Forcës [së Shqipërisë] janë një status i avancuar i Objektiveve të Partneritetit në kuptimin e llogaridhënies së zhvillimit të kapaciteteve ushtarake për mbrojtjen kolektive të Aleancës.”⁷⁸ Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të 2007 (PPR) i Shqipërisë shërbeu si burim për të ndihmuar në përgatitjen e objektiveve, të cilat u përqendruan në ndarjen e roleve, përgjegjësi dhe barrës së Shqipërisë brenda Aleancës për një periudhë 10-vjeçare 2008-2018. Paketat e mëparshme të OP u zhvilluan në vitet 1999, 2002, 2004 dhe 2006.⁷⁹ “Shtabi Ndërkombëtar i NATO-s propozoi paketën e synuar OF në vitin 2008 për Shqipërinë, e cila mori miratimin përfundimtar më 22 korrik 2008, me procedura të heshtura [dmth. në heshtje] me Aleancën.”⁸⁰ OF-të janë momente të rëndësishme historike që i Shqipëria

⁷⁸ “NATO Force Goals,” Këshilli Atlantik i Shqipërisë, aksesuar në 6 korrik, 2016, http://atlantic-council-al.com/ACA/NATO_Force_Goals.html.

⁷⁹ Ibid.

⁸⁰ Ibid.

pranoi të ndjekë për përputhshmëri dhe performancë më të madhe si anëtare e Aleancës të parashikuara edhe në Nenin 5.

Në vitin 2008, Shqipërisë iu caktuan duhet të përmbushte 49 Objektiva gjatë 10 vjetëve. Objektivat ndahen si vijon: “26 prej tyre janë të përgjithshme dhe zbatohen për të gjitha Forcat e Armatosura; 14 të tjerë janë vetëm për njësitë tokësore; 4 për ato detare dhe 5 aplikohen për njësitë ajrore.”⁸¹ Vlen të theksohet se këto objektive përfshijnë një grup batalioni motorik prej 1,000 personash, një transportues ajror taktik për të mbështetur grupin e betejës, kapacitete për të mbështetur operacionet e NATO-s, inteligjencë njerëzore dhe kapacitete operuese psikologjike për të mbështetur Aleancën, uniforma të ndryshme për mot ekstrem, kapacitet për të vepruar në vendet e ndotura me ASHM, dhe kapacitete kibernetike strategjike dhe taktike. Shumica e objektive mbivendosen ose plotësojnë objektivat e përcaktuara në PAZHFA 2016-2025 që u përmend më sipër.

Objektivat e modernizimit janë ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen forcat ushtarake shqiptare. Programi OF u krijua me shpresën se të paktën 2% e PBB-së së vendit do të alokohej për mbrojtjen dhe 20 përqind e kësaj shume do të shkonte për pajisje dhe sisteme.⁸² Që nga fillimi i këtij plani, Shqipëria nuk ka përmbushur as 2 përqind të PBB-së për buxhetin, as 20 përqind të shpenzimeve të mbrojtjes për pajisjet.⁸³ Shqipëria i vendosi këto objektiva në nivele realiste, pasi ato janë proporcionale me OF-të e vendeve të tjera. Kroacia, për shembull, është një vend më i madh dhe për këtë arsye është angazhuar me një grup ushtarak prej 4.000 personash kundrejt grupit ushtarak prej 1.000 personash të Shqipërisë.⁸⁴ Financimi i duhur në përputhje me paketën e OF është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të këtij plani, edhe pse OF-të e Shqipërisë janë përshtatur me madhësinë dhe potencialin e saj.

6. Mbrojtja Kolektive

Neni 5 parashtron se “parimi i mbrojtjes kolektive është në thelb të traktatit themelues të NATO-s. Ai mbetet një parim unik dhe i qëndrueshëm që i lidh anëtarët e saj së bashku, duke i angazhuar ata në mbrojtjen e njëri-tjetrit dhe

⁸¹ Ibid.

⁸² Ibid.

⁸³ “Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016).”

⁸⁴ Këshilli Atlantik i Shqipërisë, “Albania’s Force Goals.”

vendosjen e një fryme solidariteti brenda Aleancës”.⁸⁵ Për të cituar një studim të kohëve të fundit, “mbrojtja kolektive është arsyeja kryesore pse anëtarët themelues e formuan Aleancën në vitin 1949 dhe ky mbetet guri themeltar i NATO-s, edhe pse Aleanca ka marrë role dhe përgjegjësi shtesë”.⁸⁶ Mbrojtja kolektive është më e rëndësishmja dhe themeloria e tre detyrave kryesore, por secila prej tyre ka një funksion të domosdoshëm. Së bashku me premtimin për të mbështetur aleatët e tjerë, duhet të ndërmerren veprime konkrete për ta treguar këtë mbështetje. Parimi i mbrojtjes kolektive të NATO-s u ngrit kundër Paktit të Varshavës nga viti 1955 deri në 1991 dhe vazhdon të jetë edhe sot. Ndërsa perdja e hekurit u shemb në Evropën Lindore, mbrojtja kolektive siguroi mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme për shtetet satelite dhe ish-sovjetike për të kaluar dhe për t'u hapur me Evropën Perëndimore, si edhe për vende si Shqipëria për të vendosur një kurs të ri drejt demokracisë.

Mbas rënies së komunizmit, Shqipëria u përfshi në mbrojtjen kolektive si një tregues i gatishmërisë së qeverisë për të alternuar përfitimet që po merrte nëpërmjet pjesëmarrjes në këto përpjekje. Shembulli më i mirë i kësaj pjesëmarrjeje është dërgimi i trupave shqiptare në Afganistan, në 11 shtator 2001.

Ishte hera e parë në historinë e Aleancës që u kërkua zbatimi i Neni 5. Kësaj thirrjeje iu përgjigjën shumë anëtarë, përfshirë Shqipërinë, mbas anëtarësimit në Aleancë. Shqipëria vendosi 3.041 trupa në Forcën Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF), e cila përfundoi misionin e saj në vitin 2014. Megjithëse ISAF u krijua dhe u ruajt nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe jo nga Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut - ajo u pranua gjerësisht si në përputhje me misionin e mbrojtjes kolektive të NATO-s. Shqipëria ka lejuar gjithashtu avionët luftarakë të fluturojnë nëpër hapësirën e saj ajrore në mbështetje të Operacionit Liria e Qëndrueshme. Me përjashtim të misionit të trajnimit të NATO-s në Irak, Iraku nuk ishte një operacion i NATO-s, por një operacion i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara. Kontributi i Shqipërisë në trupat Operacionit të Lirisë Irakiane arriti në 1,342 persona midis viteve 2003 dhe 2008.⁸⁷ Këto numra të forcave në Afganistan dhe Irak janë të vogla në krahasim me dhjetëra mijëra trupa të vendosur në ato vende nga Shtetet e Bashkuara, por ato përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm për

⁸⁵ “Collective Defence—Article 5,” 31.

⁸⁶ Yost, *NATO's Balancing Act*, 31.

⁸⁷ USCENTCOM, “U.S. Central Command: Albania,” USCENTCOM, aksesuar më 12 mars 2016, <http://www.centcom.mil/en/about-centcom-en/coalition-countries-en/albania-en>.

një vend me madhësinë e Shqipërisë, që ka vetëm rreth 14,000 trupa aktive dhe 5,000 forca rezervë.⁸⁸

Madhësia e ushtrisë së saj ka sjellë edhe specializimin e saj dhe batalioni i forcave speciale të Shqipërisë ka operuar në Afganistan, Bosnje-Hercegovinë, Çad dhe Irak.⁸⁹ Në Afganistan dhe Irak, Shqipëria tregoi vullnetin e saj për të kontribuar me një prani të qëndrueshme, si dhe për të ofruar mbështetje në operacionet luftarake. Në përgjithësi, në krahasim me anëtarët më të mëdhenj të Aleancës, kontributet për mbrojtjen kolektive nga Shqipëria janë relativisht të vogla, por është treguar qartazi interesi i shtetit për zgjerimin e burimeve dhe kapaciteteve të kufizuara për të mbështetur objektivat e NATO-s. Për më tepër, Shqipëria po kontribuon në misionin e NATO-s pas-ISAF në kuadër të Rezolutës Mbështetëse në Afganistan.

7. Siguria Bashkëpunuese

Shqipëria është më mirë e aftë për të kontribuar në misionin e bashkëpunimit në sferën e sigurisë sesa në atë të mbrojtjes kolektive. Gadishulli i Ballkanit, ku ndodhet Shqipëria, është i njohur gjerësisht për historinë e gjatë të luftës dhe trazirave. Stabiliteti në këtë rajon është i rëndësishëm për NATO-n, siç tregohet nga ndërhyrjet e saj në Kosovë dhe Bosnje. NATO punon me partnerët e saj dhe shtetet anëtare për të nxitur sigurinë rajonale dhe përpjekjet kolektive për t'u përballur me sfidat e reja të sigurisë kur ato shafqen.⁹⁰ Shqipëria u përball me sfidat rajonale të sigurisë në konfliktet e Bosnjës dhe Kosovës në vitet 1990 dhe sot përballet me një sërë sfidash të ndryshme në luftën kundër terrorizmit.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në PpP ndihmoi dukshëm bashkëpunimin për sigurinë. Në vitin 1994, politika e Këshillit të Atlantikut të Veriut lidhur me bashkëpunimin për sigurinë kishte të bënte me atë që partnerët që ndiheshin të kërcënuar për sigurinë e tyre mund të kërkonin ndihmë.⁹¹ David Yost vëren se “rëndësia e angazhimit të NATO-s u bë e dukshme më 11 mars 1998, kur

⁸⁸ “Albania Military Strength,” Global Fire Power, aksesuar më 12 mars, 2016, http://www.globalfirepower.com/country-military-strength-detail.asp?country_id=albania.

⁸⁹ “Peacekeeping Contributor Profile: Albania,” Providing for Peacekeeping, 30 mars, 2015, <http://www.providingforpeacekeeping.org/2015/03/30/peacekeeping-contributor-profile-albania/>.

⁹⁰ Copani, “Partnership for Peace and New Dimensions of Albania’s Security Posture.”

⁹¹ Yost, *NATO’s Balancing Act*, 202.

Shqipëria u bë partneri i parë që ushtronte të drejtat e konsultimit emergjent të PpP-së”.⁹² Partneriteti për Paqe është ndër mjetet më të dukshme me anë të së cilës NATO ka lehtësuar bashkëpunimin për sigurinë, sepse partneritetet janë të rëndësishme për objektivat strategjike të Aleancës. Gjatë fundit të viteve 1990, Shqipëria përfitoi nga ky objektivi i sigurisë së NATO-s, kur vendi ishte ende në tranzicion nga dekadat e mbylljes me Perëndimin.

Që nga ditët e saj në PpP, Shqipëria është bërë më aktive në bashkëpunimin për sigurinë dhe aktualisht është e përfshirë kundër kërcënimeve terroriste islamike. Ajo ka qenë një mbështetëse aktive e fushatës kundër terrorizmit që nga viti 2001 dhe vazhdon pjesëmarrjen e saj përballë kërcënimeve të reja dhe ato t reja si Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL), i njohur gjithashtu si Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS).⁹³ Kërcënimet e pranishme brenda kufijve të Shqipërisë përfshijnë luftëtarët e huaj të ISIS, furnizimet me armë, mbështetja financiare për terrorizmin; dhe lehtësia e kalimit të terroristëve që lëvizin nëpër Ballkan. Shqipëria po punon në bashkëpunim me aleatët e tjerë për të luftuar këto aktivitete dhe për të rritur mbështetjen për aleatët në rajon. Kjo përpjekje është në përputhje me rritjen e sigurisë ndërkombëtare, një element kyç për bashkëpunimin për sigurinë.⁹⁴

Sulmi që ndodhi në Paris në nëntor 2015 nxiti shtetet anembanë Europës të shqyrtonin protokollat e tyre të sigurisë dhe Shqipëria ishte midis atyre që kishin shqetësime serioze lidhur me aktivitetet që lidhen me terrorizmin. Duke marrë parasysh masat e rrepta të kontrollit të armëve në shumë shtete evropiane, burimi i armëve të përdorura nga terroristët është ende një diskutim i nxehtë. Një burim i madh i atribuohet bastisjes së objekteve të magazinimit të armëve në të gjithë Shqipërinë në përgjigje të krizës së brendshme të vitit 1997, gjë që çoi në vjedhjen e rreth 100,000 armëve.⁹⁵

⁹² Ibid, 202.

⁹³ Ebi Spahiu, “Ethnic Albanian Foreign Fighters and the Islamic State,” *Jamestown Foundation*, 15 Maj, 2015, http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnews%5Bsword%5D=8fd5893941d69d0be3f378576261ae3e&tx_ttnews%5Bany_of_the_words%5D=albania&tx_ttnews%5Btt_news%5D=43917&tx_ttnews%5BbackPid%5D=7&cHash=dec23b809c0ae81f9212cbe0c28e3092#.VuWiDRTPJy.

⁹⁴ “NATO’s Strategic Concept.”

⁹⁵ Ebi Spahiu, “Militant Islamists, Organized Crime and the Balkan Diaspora in Europe,” *The Jamestown Foundation*, 2 dhjetor, 2015, http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnews%5Bsword%5D=8fd5893941d69d0be3f378576261ae3e&tx_ttnews%5Bany_of_the_words%5D=albania&tx_ttnews%5Btt_news%5D=44849&tx_ttnews%5BbackPid%5D=7&cHash=4eddb6d360009358d56457f127aa9a14.

Flemish Peace Institute nxori një studim që tregonte se shumica e armëve të zjarrit përdoshin në sulme të dhunshme të tilla si vrasjet e Parisit. Ato arrijnë në Evropë nëpërmjet grupeve në Ballkanin Perëndimor dhe përdoren të njëjtat rrugë si në trafikimin e drogës dhe aktiviteteteve të tjera kriminale.⁹⁶ Shqipëria ka bashkuar forcat me zyrtarët italianë për të ndaluar një veprimtari të tillë në interes të sigurisë rajonale,⁹⁷ dhe qeveria shqiptare ngriti nivelin e mbrojtjes kombëtare dhe vendosi mbi 1.500 forca të sigurisë në vend pas sulmeve të Parisit të nëntorit 2015.⁹⁸ Reagime të tilla janë një shembull kryesor i zbatimit të bashkëpunimit për sigurinë, pasi disponueshmëria dhe transportimi i armëve jashtë Shqipërisë janë një shqetësim i madh si në vend ashtu edhe në kuadrin ndërkombëtar.

Së bashku me armët që vijnë nga territori shqiptar, është edhe problemi i financimit terrorist dhe i kontigjentëve të luftëtarëve të huaj, duke numëruar rreth 500 shqiptarë etnikë dhe duke përfshirë 150 shtetas shqiptarë, të cilët u larguan nga Ballkani për t'u bashkuar dhe luftuar së bashku me ekstremistët islamikë në Irak dhe Siri.⁹⁹ Ideologjia që nxit këta luftëtarë besohet t'i ketë rrënjët në Luftërat Ballkanike, të cilat u perceptuan gjerësisht si anti-myslimane. Sipas Ebi Spahiu, lufta në Bosnjë rezultoi në lëvizjen e disa qindra individëve nga Algjeria, Egjipti, Pakistani, Arabia Saudite dhe vendeve të tjera, përfshirë veteranët e xhihadit afgan, në Ballkanin perëndimor.¹⁰⁰ Shumëllojshmëria e gjerë e besimeve ideologjike të përkrahura nga këta luftëtarë të huaj të ndryshëm vazhdon të ndikojë në politikën e Shqipërisë dhe shteteve fqinjë dhe për t'i luftuar këta luftëtarë të huaj, autoritetet italiane dhe shqiptare kanë kryer operacione për t'i kapur dhe arrestuar ata.¹⁰¹ Në një operacion të brendshëm, zyrtarët shqiptarë arrestuan 13 vetë nga dy xhami të dyshuara për rekrutimin e deri në 70 luftëtarëve të huaj pranë kryeqytetit të Tiranës.¹⁰² Kjo qasje bashkëpunuese dhe proaktive ndihmon në forcimin e sigurisë rajonale.

Së bashku me furnizimin e luftëtarëve për ISIS, mbështetja financiare e ekstremistëve gjendet gjithashtu në Ballkan. Vetëm heroina nga Ballkani

⁹⁶ Ibid.

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ Ibid.

⁹⁹ Spahiu, "Ethnic Albanian Foreign Fighters and the Islamic State."

¹⁰⁰ Ibid.

¹⁰¹ Spahiu, "Militant Islamists, Organized Crime and the Balkan Diaspora in Europe."

¹⁰² Spahiu, "Ethnic Albanian Foreign Fighters and the Islamic State."

është burimi i mbi 20 miliardë dollarëve në vit, dhe të ardhurat nga shitjet e drogës janë gjerësisht të njohura për të furnizuar organizata terroriste si Hezbollahu dhe al-Kaeda.¹⁰³ Një shembull i njohur i aktivitetit ilegal të drogës në Shqipërinë jugore është fshati i Lazaratit, dikur i njohur për agrikulturën e ligjshme, e cila tani llogaritet të prodhojë mbi 6.1 miliardë dollarë marihuanë në vit,¹⁰⁴ dhe ku, në një operacion të vetëm, policia dogji mbi 11,000 bimë të kanabisit në një përpjekje për të ngadalësuar prodhimin e drogës.¹⁰⁵ Rritja e operacioneve kundër drogës jo vetëm që e ngadalëson financimin ndaj terroristëve, por përforcon sundimin e ligjit në Shqipëri, që është jetike për statusin e saj si një vend anëtar i NATO-s.

8. Menaxhimi i Krizave

E fundit nga tre detyrat kryesore dhe parimet e NATO-s të diskutuara në këtë seksion është menaxhimi i krizave. Kjo detyrë kryesore është një forcë e madhe e NATO-s, siç ilustron nga aftësia e saj për të përdorur kombinimin e mjeteve politike dhe ushtarake para, gjatë dhe pas një konflikti apo krize tjetër. Aktivitetet shoqëruese përfshijnë parandalimin e konfliktit, paqeruajtjen, ndërtimin e paqes, zbatimin e paqes dhe operacionet humanitare.¹⁰⁶ Pika e kthesës në përfshirjen e Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave erdhi pas krizës së brendshme në vitin 1997, ku Shqipëria kërkoi menjëherë të tregonte angazhimin e saj ndaj objektivave të NATO-s.¹⁰⁷

Kriza e parë humanitare në shkallë të gjerë me të cilën përballet Shqipëria gjatë anëtarësimit të saj në PpP-në e NATO-s erdhi nga fqinji i saj, Kosova. Lufta e Kosovës e viteve 1998-1999 çoi në një situatë të tmerrshme të refugjatëve që përfshinte mbi 600,000 njerëz, nga të cilët rreth 375,000 udhëtuan për ndihmë në Shqipëri. Në atë kohë, popullsia e përgjithshme e Shqipërisë ishte vetëm 3.2 milion, por pavarësisht kësaj vendi ndihmoi në

¹⁰³ Spahiu, "Militant Islamists, Organized Crime and the Balkan Diaspora in Europe."

¹⁰⁴ Jill Reilly, "The Day Europe's 'Marijuana Mecca' Went up in Smoke," *Mail*, 16 qershor, 2014, <http://www.dailymail.co.uk/news/article-2658903/Albanian-police-storm-lawless-marijuana-village.html>.

¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ "NATO—Topic: Crisis Management," North Atlantic Treaty Organization, 29 janar, 2015, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49192.htm#.

¹⁰⁷ "Peacekeeping Contributor Profile."

ngritjen e kampeve për t'u kujdesur për numrin masiv të refugjatëve.¹⁰⁸ Gatishmëria e Shqipërisë për të ndihmuar gjatë krizës ishte e nxitur nga partneriteti i saj me NATO-n, si dhe lidhjet e saj etnike me kosovarët dhe përpjekjet e vendit ndihmuan dukshëm në krizën humanitare, duke kontribuar shumë në përpjekjet për stabilizimin rajonal.

Një operacion tjetër i madh i menaxhimit të krizave në të cilin Shqipëria ka ofruar mbështetje është Afganistani, duke kontribuar në operacionet në vend edhe pas zvogëlimit të forcave të ISAF. Në mbështetje të misionit ISAF, Shqipëria dërgoi 330 forca në Kabul, Herat dhe Kandahar.¹⁰⁹ Pas dekadash lufte dhe konfliktesh të brendshme, Afganistani është një vend i shkatërruar nga lufta, në të cilin përpjekjet e NATO-s për arritjen e stabilitetit janë jetike.

Edhe një herë, numri i trupave të siguruara nga Shqipëria në këtë mision të NATO-s është i vogël në terma absolutë në krahasim me aleatët më të mëdhenj, por përpjekja në baza proporcionale ka qenë e sinqertë, konstante dhe e rëndësishme. Një studim i kohëve të fundit zbuloi se 89 përqind e shqiptarëve mbështesin besnikërinë e vendit të tyre ndaj NATO-s dhe operacioneve të saj.¹¹⁰ Kjo shumë e mbështetjes publike për NATO-n është në përputhje me interesat e qeverisë. Prioriteti numër dy i Direktivës së Mbrojtjes së vitit 2016 i Shqipërisë, i dyti vetëm pas rritjes së ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit është përmbyshja e angazhimeve të vendit në kuadër të Aleancës.¹¹¹ Menaxhimi i krizave është sigurisht një nga fushat e mbështetjes në të cilën Shqipëria ka treguar gatishmërinë dhe kapacitetet për të zotëruar burimet e saj.

9. Përfundime

Thelbi i shumë prej faktorëve shterues të performancës së Shqipërisë është ekonomia. Shqipëria vuan nga një ekonomi e dobët, gjë e cila e ka lënë shumë pas vendeve të Evropës Perëndimore. Që prej vitit 2011, progresi i saj është ngadalësuar. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) raporton se faktorë të tjerë

¹⁰⁸ "Kosovar Refugees," *Migration News* 6, nr. 5 (Maj 1999), <https://migration.ucdavis.edu/mn/more.php?id=1801>.

¹⁰⁹ "History of NATO-Albania Relations."

¹¹⁰ Ibid.

¹¹¹ "Direktiva E Mbrojtjes," (National Defense Strategy) Republic of Albania, Ministry of Defence, 2016, <http://www.mod.gov.al/index.php/aktivitete-analize/51-direktiva-e-mbrojtjes-2014>.

që e kanë lënë Shqipërinë mbrapa përfshijnë mangësitë në infrastrukturë, furnizimet e pasigurta të energjisë, nivelet e ulëta të kapitalit fizik dhe njerëzor, institucionet e dobëta, zbatimi i dobët i shtetit ligjor dhe korrupsioni. Tre faktorët e fundit kontribuojnë në analizën e mbrojtjes të së drejtave pronësore.¹¹² Kushtet makro dhe mikro ekonomike gjithashtu paraqesin pengesa të mëdha në aftësinë afatgjate të Shqipërisë për të rritur kontributin në përpjekjet dhe detyrat kryesore të NATO-s. Të gjitha këto fusha duhet të adresohen në mënyrë që Shqipëria të përmbushë angazhimin e saj në programin dhe detyrimet ndaj Aleancës.

Një implikim indirekt i kushteve ekonomike të tvështira të Shqipërisë është kompensimi i ulët i anëtarëve të ushtrisë. Pagat për ushtarët janë të ulëta në krahasim me mesataren e punëtorëve në vend, për të mos thënë se nuk kanë të krahasuar me ushtritë e anëtarëve të tjerë të Aleancës. Kjo kufizon aftësinë e qeverisë për të rekrutuar dhe mbajtur personel me cilësi të lartë. Ushtarët shqiptarë luftojnë krah për krah homologëve të Aleancës, por përballen me një mangësi të dukshme në kompensim. Kjo është një nga shumë mangësitë që ndikon në performancën e ulët, pavarësisht rritjes së vazhdueshme ekonomike në Shqipëri.

Paga për ushtarakët së bashku me të gjitha fushat e diskutuara në fillim të këtij kapitulli duhet të adresohen me qëllim që Shqipëria të përmbushë programin e saj dhe detyrimet e saj ndaj Aleancës. Përpjekjet e vazhdueshme ndihmojnë për t'i treguar Aleancës që Shqipëria është e aftë të jetë gjeneruese sigurie dhe jo vetëm një konsumatore e sigurisë. Në vitin 2016, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë udhëhoqi zbatimin e disa nismave strategjike për të përsheptuar transformimin ushtarak të vendit si dhe programet e ndryshme të modernizimit. Shqipëria është në një kurs ambicioz por që mund ta përmbushë rritjen dhe përmirësimin e aftësive të saj brenda Aleancës për dekadat e ardhshme.¹¹³

Siç u theksua edhe më lart, Ivo Daalder argumentoi në vitin 1999 se përfshirja e më shumë anëtarëve mund ta dobësonte aftësinë e Aleancës për të përmbushur rolin e saj themelor të mbrojtjes kolektive.¹¹⁴ Në fjalët e Daalder, “një zgjerim i qëllimit apo anëtarësisë së NATO-s rrezikon jo vetëm rritjen e përçarjes mes aleatëve, por edhe shpërndarjen e aftësisë së Aleancës Atlantike

¹¹² International Monetary Fund “Albania Selected Issues,” International Monetary Fund, 20 Qershor 2016.

¹¹³ “Direktiva E Mbrojtjes.”

¹¹⁴ Daalder, “NATO in the 21st Century,” 11.

për të përmbushur detyrat themelore të mbrojtjes kolektive.”¹¹⁵ Kjo tezë, përmes studimit të Shqipërisë, tregon se një vend i vogël dhe ekonomikisht i dobët, ende mund të arrijë të bëhet një anëtar produktiv i NATO-s.

Kontributi më i rëndësishëm i Shqipërisë për Aleancën është roli i saj kryesor në sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Ekspertët dhe politikëbërësit theksojnë gjerësisht se Shqipëria ka luajtur një rol vendimtar në ruajtjen e paqes në Ballkan, siç është ilustruar nga përfshirja e saj në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës (pa irredentizëm apo ndërhyrje në politikën lokale) dhe në ndërtimin dhe konsolidimin e shteteve multietnike në Maqedoni dhe Mal të Zi.¹¹⁶ Ndërsa Shqipëria vazhdon të forcohet politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht, vendi do të zgjerohet në mënyrë progresive fushën e pjesëmarrjes së saj në aktivitetet dhe operacionet e NATO-s. Ky rast studimor ofron dëshmi që justifikojnë besimin e anëtarëve më të mëdhenj të Aleancës se aleatët e vegjël janë pasuri e mirëfilltë mbi të cilën Aleanca mund të kërkojë mbështetje dhe të varet kur është nevoja. Shtimi i anëtarëve dhe partnerëve të rinj ndryshon vazhdimisht territorin dhe përgjegjësitë e Aleancës, duke rritur në të njëjtën kohë kapacitetet e veta. Anëtarët e vegjël kanë dëshmuar se janë në gjendje dhe të gatshëm të angazhohen sipas nevojës për të përmbushur objektivat e Aleancës.

10. Mendimet Përfundimtare

Kontributi i Shqipërisë në NATO po forcohet edhe më shumë përballë kërcënimeve të reja. Vendndodhja e vendit në rajonin e Mesdheut ofron një pozicion strategjik për të adresuar aktivitetet terroriste aty. Në një takim të vitit 2015 me Sekretarin e Shtetit të SHBA John Kerry, Ditmir Bushati - Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë - “përsëriti angazhimin e qeverisë shqiptare për të vazhduar të jetë një partner i fuqishëm i SHBA, në aspektin e stabilitetit, paqes dhe prosperitetit në rajonin tonë dhe më gjerë, si dhe në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.”¹¹⁷ Shqipëria e mbështet mesazhin e saj me veprim, siç shihet në veprimtaritë anti-terrorizëm si përgjimi i luftëtarëve të huaj dhe

¹¹⁵ Ibid.

¹¹⁶ Bushati quoted in “Albania–U.S. Strategic Partnership.” NOA, aksesuar më 20 janar, 2016, <http://www.noa.al/artikull/albania-u-s-strategic-partnership/487738.html>.

¹¹⁷ Ibid., Shiko edhe Mirela Metushaj. “Geopolitics of Albania in the Balkans after NATO Membership.” *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* vëll. 4, nr. 3 S1 (Dhjetor 2015, Special Issue). <http://www.mcser.org/journal/index.php/ajis/article/view/8407/8069>.

mbyllja e rrugëve të furnizimit të armëve dhe financimit të terrorizmit brenda vendit.

11. Faktorët Kufizues

Për të përmbushur plotësisht objektivat e përcaktuara dhe premtimet që i ka bërë Aleancës, Shqipëria do të duhet të trajtojë disa çështje që lidhen kryesisht me kontributin financiar. Shqipëria ka deri më tani ekonominë më të dobët midis aleatëve. Shuma e kufizuar e parave që shkojnë drejt shpenzimeve për mbrojtjen është rezultat i disa faktorëve kufizues që pengojnë ecurinë ekonomike të Shqipërisë. Ekonomia e Shqipërisë po rritet në mënyrë të vazhdueshme, por ka një rrugë të gjatë për të arritur deri te pjesa tjetër e Aleancës. Fushat kyçe që duhet të adresohen për të ndihmuar në përmirësimin e performancës përfshijnë mungesën e infrastrukturës, furnizimi i kufizuar me energjisë, niveli i ulët i kapitalit material dhe njerëzor, institucionet e dobëta, zbatimi i pabarabartë i shtetit ligjor dhe korrupsioni.¹¹⁸ Pasi të përmirësohen disa nga këto çështje dhe ekonomia të përparojë, do ketë më shumë para në dispozicion për të kontribuar në Aleancë.

Gjithashtu, autoritetet shqiptare synojnë të adresojnë disbalancën e shpërndarjes së fondet e alokuara për shpenzimet e mbrojtjes. Që prej vitit 2016, pjesa më e madhe e buxhetit shkon për personelin dhe jo në pajisje, trajnime, kërkime dhe zhvillim, apo infrastrukturë. Për të rregulluar këtë disbalancë, duhet të ketë më shumë fonde për ushtrinë.

Ndonëse përqindja më e madhe e fondeve shkon për personelit, që përfshin pagat dhe pensionet, sërish ajo është shumë e ulët, duke rezultuar në paga të ulëta për anëtarët e ushtrisë. Siç është cekur më parë, paga e një ushtari është më e ulët në krahasim me pagën mesatare të një punonjësi në vend. Paga e një ushtari shqiptar nuk krahasohet me atë të shumë ushtarakëve të tjerë të Aleancës. Kjo mangësi bëhet më e qartë kur sa më shumë forca shqiptare marrin pjesë në operacionet e Aleancës dhe përmbushin të njëjatat role si homologët e tyre por që janë më të paguar. Kjo barrierë kufizon aftësinë e qeverisë për të rekrutuar dhe mbajtur personel me cilësi të lartë. Shqipëria është në rrezik të rekrutimit të njerëzve më pak të kualifikuar, ndërsa qytetarët më të kualifikuar kërkojnë punë civile brenda dhe jashtë vendit. Ky është një nga shumë mangësitë e performancës së dobët ekonomike të Shqipërisë, pavarësisht rritjes së qëndrueshme të saj.

¹¹⁸ "Albania Selected Issues," 20.

Adresimi i këtyre çështjeve ekonomike është thelbësor që Shqipëria të përmbushë objektivat e saj të forcës dhe detyrimet ndaj Aleancës. Mungesa e përmirësimeve do të krijojë hapësirë për argumentin se shtetet e vogla janë konsumatore të sigurisë më shumë se gjeneruese të saj. Për të përmbushur objektivat e saj, shpenzimet për mbrojtjen duhet të arrijnë një minimum prej 2% të PBB-së së Shqipërisë. Gjithashtu, nevojiten përmirësime për të rritur PBB-në e vendit.

Shqipëria ka një plan solid për të përmirësuar pozicionin e saj përmes strategjive dhe nismave të ndryshme. Nëse Shqipëria vazhdon progresin në vend dhe i përmbahet financimit dhe përmbushjes së planeve të saj, siç është Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2015-2016, ajo do të vazhdojë të jetë kontribuese me vlerë në Aleancë.

Bibliografia

- Abrahams, Fred. *Modern Albania: From Dictatorship to Democracy in Europe*. New York: New York University Press, 2015.
- Asmus, Ronald D. *Opening NATO's Door: How the Alliance Remade Itself for a New Era*. New York: Columbia University Press, 2002.
- Atlantic Council of Albania. "NATO Force Goals." Accessed July 6, 2016. http://atlantic-council-al.com/ACA/NATO_Force_Goals.html.
- Botim i Qendres se Botimeve Zyrtare. "Fletorja Zyrtare E Republikes Se Shqiperise." July 16, 2015. www.qbz.gov.al.
- Bowers, Stephen R. "Stalinism in Albania: Domestic Affairs under Enver Hoxha." Faculty Publications and Presentations. Accessed October 27, 2016. http://digitalcommons.liberty.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1086&context=gov_fac_pubs.
- Brunkard, Joan, Gonza Namulanda, and Raoult Ratard. "Hurricane Katrina Deaths, Louisiana, 2005." *Disaster Medicine and Public Health Preparedness* 2, no. 04 (December 2008): 215–23, doi:10.1097/DMP.0b013e31818aaf55.
- Callanan, James D. "The Evolution of the CIA's Covert Action Mission, 1947–1963." Master's thesis, Durham University, 1999. http://etheses.dur.ac.uk/4481/1/4481_1945.PDF?UkUDh:CyT.
- Central Intelligence Agency. "Project BGFRIEND." Accessed January 20, 2016. http://www.foia.cia.gov/sites/default/files/document_conversions/1705143/OBOPUS%20BG%20FIEND%20%20%20VOL.%20%20%28PROJE%20OUTLINED%20REVIEWS%20TERMINATION%29_0034.pdf.

- Congressional Budget Office, *NATO Burdensharing After Enlargement*. Washington, DC: Congressional Budget Office, August 2001.
- Copani, Adem. "Partnership for Peace and New Dimensions of Albania's Security Posture." Foreign Military Studies Office, July 1996. <http://fmso.leavenworth.army.mil/documents/albania2.htm>.
- Country Data. "Albania—Albania and China." Accessed July 29, 2016. <http://www.country-data.com/cgi-bin/query/r-169.html>.
- Daalder, Ivo H. "NATO in the 21st Century: What Purpose? What Missions?" Brookings Institution, April 1999. <http://www.brookings.edu/research/reports/1999/04/nato-daalder>.
- Davis, Michael W. "Storming Fortress Albania: American Covert Operations in Microcosm, 1949–1954." *Intelligence and National Security* 7, no. 4 (1992). doi:10.1080/02684529208432178.
- Gheciu, Alexandra, *NATO in the "New Europe": The Politics of International Socialization After the Cold War*. Palo Alto, CA: Stanford University Press, 2005.
- Global Fire Power. "Albania Military Strength." Accessed March 12, 2016. http://www.globalfirepower.com/country-military-strength-detail.asp?country_id=albania.
- Hillison, Joel R., *New NATO Members: Security Consumers or Producers?* Carlisle Barracks, PA: U.S. Army War College, Strategic Studies Institute, April 2009.
- International Monetary Fund "Albania Selected Issues." International Monetary Fund, June 2016. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16143.pdf>.
- Kaplan, Lawrence S. *NATO Divided, NATO United: The Evolution of an Alliance*. Westport, CT: Praeger, 2004.
- Kurani, Edison "Salaries in Albania, Drastic Gap between the Minimum and Maximum Pay." *Independent Balkan News Agency*, May 4, 2015. <http://www.balkaneu.com/salaries-albania-drastic-gap-minimum-maximum-pay/>.
- Lalaj, Ana, Christian F. Osterman, and Ryan Gage. "'Albania Is Not Cuba.' Sino-Albanian Summits and the Sino-Soviet Splits." *Cold War International History Project Bulletin* 16 (n.d.).
- Mastny, Vojtech, and Malcolm Byrne, eds., *A Cardboard Castle?: An Inside History of the Warsaw Pact, 1955–1991*, National Security Archive Cold War Readers. New York: Central European University Press, 2005.
- Metushaj, Mirela. "Geopolitics of Albania in the Balkans after NATO Membership." *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* vol. 4, no. 3 S1 (December 2015, Special Issue). <http://www.mcser.org/journal/index.php/ajis/article/view/8407/8069>.

- Meyer, Steven E. "Carcass of Dead Policies: The Irrelevance of NATO." *Parameters*, Winter 2003/2004, 33, no. 4 (2004).
- Migration News*. "Kosovar Refugees." 6, no. 5 (May 1999).
<https://migration.ucdavis.edu/mn/more.php?id=1801>.
- Moore, Rebecca R. *NATO's New Mission: Projecting Stability in a Post-Cold War World*. Westport, CT: Praeger Security International, 2007.
- Morelli, Vincent. *NATO Enlargement: Albania, Croatia, and Possible Future Candidates* (CRS Report No. RL34701). Washington, DC: Congressional Research Service, October 6, 2008.
<http://oai.dtic.mil/oai/oai?verb=getRecord&metadataPrefix=html&identifier=ADA488773>.
- Albanian National News Agency. "Albania–U.S. Strategic Partnership." Accessed January 20, 2016. <http://www.noa.al/artikull/albania-u-s-strategic-partnership/487738.html>.
- North Atlantic Treaty Organization. "Collective Defence—Article 5." Accessed March 12, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_110496.htm.
- "Cooperative Security as NATO's Core Task." Accessed August 26, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_77718.htm.
- "Defence Expenditures of NATO Countries (2008-2015)." January 28, 2016.
http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2016_01/20160129_160128-pr-2016-11-eng.pdf#page=2.
- "Defence Expenditures of NATO Countries (2009-2016)." North Atlantic Treaty Organization, July 4, 2016.
http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2016_07/20160704_160704-pr2016-116.pdf.
- "Enlargement." Accessed August 26, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49212.htm.
- "Membership Action Plan (MAP)." Accessed August 28, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_37356.htm.
- "NATO Foreign Ministers Sign Accession Protocol with Montenegro." Accessed August 26, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_131132.htm.
- "NATO History." Accessed March 10, 2016.
<http://www.nato.int/history/nato-history.html>.
- "NATO's Relations with Albania." Accessed January 20, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_48891.htm.
- "NATO—Topic: Crisis Management." North Atlantic Treaty Organization, January 29, 2015.
http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49192.htm#.
- "North Atlantic Council (NAC)." Accessed August 22, 2016.
http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49763.htm.

- “The North Atlantic Treaty Preamble.” March 21, 2016. http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm.
- “Operations and Missions: Past and Present,,” November 9, 2015. http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_52060.htm.
- “Partnership for Peace Programme.” Accessed August 22, 2016. http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_50349.htm.
- “Relations with Montenegro.” Accessed August 20, 2016. http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49736.htm.
- “What Is NATO?.” Accessed January 30, 2016. <http://www.nato.int/nato-welcome/index.html>.
- Providing for Peacekeeping. “Peacekeeping Contributor Profile: Albania.” March 30, 2015. <http://www.providingforpeacekeeping.org/2015/03/30/peacekeeping-contributor-profile-albania/>.
- Reilly, Jim. “The Day Europe’s ‘Marijuana Mecca’ Went up in Smoke.” *Mail*, June 16, 2014. <http://www.dailymail.co.uk/news/article-2658903/Albanian-police-storm-lawless-marijuana-village.html>.
- Reiter, Dan. “Why NATO Enlargement Does Not Spread Democracy.” *International Security* 25, no. 4 (2001).
- Republic of Albania, Ministry of Defence. Albanian Ministry of Defence. “The Armed Forces Long-Term Development Plan 2016–2025.” Accessed September 12, 2016. www.mod.gov.al.
- “Direktiva E Mbrojtjes.” (National Defense Strategy) 2016. <http://www.mod.gov.al/index.php/aktivitete-analize/51-direktiva-e-mbrojtjes-2014>.
- “History of NATO-Albania Relations.” Accessed February 23, 2016. <http://www.mod.gov.al/eng/index.php/security-policies/relations-with/nato/88-history-of-nato-albania-relations>.
- “NATO’s Strategic Concept.” Accessed February 23, 2016. <http://www.mod.gov.al/eng/index.php/security-policies/relations-with/nato/85-nato-s-strategic-concept>.
- Schulte, Gregory L. “Former Yugoslavia and the New NATO.” *Survival* 39, no. 1 (March 1997): 19–42, doi:10.1080/00396339708442895.
- Spahlu, Ebi. “Ethnic Albanian Foreign Fighters and the Islamic State.” Jamestown Foundation. May 15, 2015. http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnews%5Bsword%5D=8fd5893941d69d0be3f378576261ae3e&tx_ttnews%5Bany_of_the_words%5D=albania&tx_ttnews%5Btt_news%5D=43917&tx_ttnews%5BbackPid%5D=7&cHash=dec23b809c0ae81f9212cbe0c28e3092#.VuWiDRhTPJy.
- “Militant Islamists, Organized Crime and the Balkan Diaspora in Europe.” The Jamestown Foundation. December 2, 2015. http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnews%5Bsword%5D=8fd58939

41d69d0be3f378576261ae3e&tx_ttnews%5Bany_of_the_words%5D=albania&tx_ttnews%5Btt_news%5D=44849&tx_ttnews%5BbackPid%5D=7&cHash=4eddb6d360009358d56457f127aa9a14.

- Tomiuc, Eugen. "NATO: What Does It Take To Join?." RadioFreeEurope/RadioLiberty, March 7, 2002, sec. Archive. <http://www.rferl.org/content/article/1099020.html>.
- Trading Economics. "Albania Average Monthly Wages." Accessed August 8, 2016. <http://www.tradingeconomics.com/albania/wages>.
- USCENTCOM. "U.S. Central Command: Albania." USCENTCOM. Accessed March 12, 2016. <http://www.centcom.mil/en/about-centcom-en/coalition-countries-en/albania-en>.
- Vickers, Miranda, *The Albanians: A Modern History*, Rev. paperback ed. London: Tauris, 2014.
- Vilpisauskas, Ramunas. "Lithuania's Accession to NATO: Can a Small State Play the Role of a Security Provider?" NATO's Nations and Partners for Peace, 2002.
- Yost, David S. *NATO Transformed: The Alliance's New Roles in International Security*. Washington, DC: United States Institute of Peace Press, 1998.
- NATO's Balancing Act*. Washington, DC: United States Institute of Peace, 2014.
- Zagorcheva, Dessie. "NATO Enlargement and Security in the Balkans." *Journal of Regional Security* 7, no. 1 (2012).

ANËTARËSIMI I MAQEDONISË NË NATO SI NJË FAKTOR I STABILITETIT RAJONAL

Vesna Poposka

Abstrakt

Pas Samitit të NATO-s në Rumani në vitin 2008, zhgënjimi i qytetarëve Maqedonas ndaj proceseve integruese ishte i dukshëm. Situata në politikën e jashtme u përdor për politikën e brendshme të ditës dhe shkaktoi dëme brenda dhe jashtë vendit, veçanërisht kundrejt marrëdhënieve ndëretnike.

Ndonëse pjesa më e madhe e “detyrave të shtëpisë” është bërë, çështja e emrit dhe kriza e gjatë politike solli vonesa në anëtarësimin e shumëpritur e të merituar në NATO. Megjithatë, qeveria Maqedonase e zgjedhur kohët e fundit ka treguar përkushtim të veçante ndaj kësaj çështjeje. Me shpresë, do t’ia dalë mbanë, pasi në çështjet e sigurisë, është koha e “*Hanibal ante portas*”.

Ky shkrim adreson çështje që lidhen me shtrirjen gjeopolitike, historinë, krizën ekonomike dhe sfidat të tanishme të sigurisë. Në këtë kontekst, anëtarësimi në NATO për Maqedoninë mund të përmirësojë situatën, jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për rajonin në tërësi.

Fjalë kyçe: NATO, Maqedoni, siguri, integrim, krizë

1. Sfidat globale të NATO-s, ndryshimi i dinamikave dhe prezenca në rajon

“Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg ftoi Kryeministrin Zoran Zaev, në zyrat qendrore të NATO-s më 12 qershor 2017, për të biseduar në lidhje me partneritetin (“Sekretari i Përgjithshëm Mirëpret Kryeministrin Zoran Zaev në zyrat qendrore të NATO-s”) – ky është kryetitulli që entuziazmoi qytetarët Maqedonas, pas formimit të koalicionit të ri qeveritar. Kjo ishte një shenjë inkurajimi dhe një fllad i freskët pas një periudhe të gjatë amullie në marrëdhëniet mes Aleancës dhe Maqedonisë. Stoltenberg ishte një prej autoriteteve të para të larta, që përgëzoi zgjedhjen e një presidenti të ri në Parlamentin e Maqedonisë, i cili u zgjodh pas rreth gjysëm viti pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në 11 dhjetor të 2016-ës.

Kjo ishte hera e parë që një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s u përfshi drejtpërdrejt në jetën politike të autoriteteve Maqedonase dhe që komentoi e përgëzoi në mënyrë direkte qeverinë e re të majtë. Kjo erë ndryshimi pas 11 vitesh premtonte një drejtim të ri në horizont për një shtet që kishte ngelur në vend.

Prej rreth dy vitesh, komuniteti ndërkombëtar në Maqedoni ishte tepër i përfshirë në zgjidhjen e krizës së vazhdueshme politike dhe të bojkotimit të opozitarëve të atëhershëm SDSM përkundrejt konservatorëve VMRO DPMNE. Agjenda Euro Atlantike ishte guri i themelit të platformës që fitoi zgjedhjet.

2. Çfarë ka ndryshuar deri tani?

Shtimi i interesit të NATO-s për Maqedoninë dhe rajonin, vjen pas ndryshimit të mjedisit të sigurisë: efekti i përhapjes së krizës së emigrimit dhe rritjes së radikalizmit dhe faktit që Maqedonia ka një pozicion qëndror në Ballkan. Pozicioni gjeografik nuk mund të zgjidhet, por është më tepër një rastësi, dhe në rastin e Maqedonisë ka qenë për shumë vite më tepër një mallkim sesa një bekim. Gjithashtu, qeveria e mëparshme maqedonase, pas zhgënjimit të përgjithshëm pas Samitit të 2008-ës ka filluar të tregojë më tepër simpati për Lindjen (Rusi, Turqi) sesa për Perëndimin, ndonëse nuk e ka deklaruar qartësisht.

Rritja e fuqisë së ISIS-it në Lindje tensionoi të gjithë rajonin, për shkak të luftëtarëve të huaj nga kjo zonë që u janë bashkuar dhe gjithashtu për shkak të faktit se tranzitojnë nga ky rajon.

Asnjë nga qeveritë e rajonit në atë periudhë nuk ishte premtuese: as ajo maqedonase, serbe, kosovare, boshnjake apo shqiptare. Rritja e nacionalizmit dhe populizmit po rrezikonin zgjimin e e tensioneve ndëretnike.

Nga ana tjetër, Maqedonia ishte kontribuese e operacioneve të drejtuara nga NATO, dhe partner i rëndësishëm për zona të ndryshme. Për një periudhë kohore të caktuar, Maqedonia ishte vendi i pestë në kontributin e trupave për frymë në Afganistan.

Momentalisht Akademia Ushtarake Maqedonase konsiderohet si një qendër rajonale për shtetet e EJT (Europës Jug-Lindore), në çështjet e sigurisë/mbrojtjes kibernetike. Ky institucion ka firmosur gjithashtu Memorandume Mirëkuptimi për sigurinë kibernetike me Institutin e Studimeve Ndërkombëtare të Monterey, në Universitetin e Norwich-it dhe me shumë

institucione të tjera, ku përfshihen Qendra për Bashkëpunim në Siguri RACVIAC, NATO CoE-DAT (Qendra e Ekselencës – Mbrojtja Kundër Terrorizmit) dhe të tjerë, që i mbështet ata në përpjekjet për të përmirësuar aftësitë e sigurisë/mbrojtjes kibernetike në rajon (“Македонија Влегува Во Сојуз Со САД Во Битка Против Сајбер Тероризмот” 2017).

Akademia ka organizuar shumë veprimtari brenda vendit dhe në rajonin e EJJ, të mbështetura kryesisht nga programi SPS i NATO-s dhe nga qeveria Maqedonase. Gjithashtu janë zhvilluar shumë trajnime dhe stërvitje të tjera në rajon me NATO-n dhe shtetet partnere dhe ka marrë pjesë në kampet ndërkombëtare verore në Krivolak që është tashmë një traditë për aleatët.

3. Kuadri rajonal dhe sfondi i krizës politike

Shtetet post-socialiste në rajonin Ballkanik kanë ritëm dhe shtrirje të zhvillimit të ndryshëm pas tranzicionit në demokraci. Disa prej tyre janë anëtarë të BE-së dhe/ose NATO-s, disa aspirojnë të integrohen, disa janë në fillim të rrugëtimit, por kanë pasur zhvillim në periudha të shkurtra. Gjeopolitika e rajonit të Ballkanit është specifike dhe e bën atë gjithmonë një shënjestër të mundshme, veçanërisht me zhvillimet e fundit të radikalizmit Islamik, krizës së emigracionit dhe të gjitha çështjeve të sipërpërmendura në kontekstin e mjediseve post-konfliktuale.

Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia kanë kaluar të gjitha një rrugë të vështirë drejt stabilizimit. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor ndajnë të njëjtat probleme, sfida e synime në të shumtën e rasteve. Për shkak të këtij fakti, ata ndajnë edhe të njëjtat rreziqe e të njëjtat nevoja: së brendshmi e së jashtmi.

Së brendshmi, rajoni ka një histori të gjatë të konflikteve të brendshme dhe të prezencës e ndëhyrjes ndërkombëtare. Periudha e gjatë e tranzicionit demokratik ishte e lodhshme për lirinë e tregut dhe për njerëzit, gjë e cila çoi në etnicizimin e konflikteve sociale. Prezenca e Islamit radikal fundamental në Ballkan është një tjetër çështje e ngritur gjatë dekadës së fundit.

Ndërkohë që situata në Lindjen e Mesme përshkallëzohet çdo ditë, gjithnjë e më tepër Muslimanë nga rajoni angazhohen dhe vendosin të lënë shtëpitë e tyre e t’u bashkohen forcave të ISIS. Gazetat në Maqedoni e kanë risjellë këtë çështje shpesh kohët e fundit.

Një nga gazetat e përditshme më të spikatura në vend ka publikuar një analizë për këtë çështje, ku një pjesë thekson: “Mund të dalim në përfundimin që nuk ka vetëm vullnetarë që synojnë të mbrojnë rajonin Islamik, por edhe njerëz, të cilët paguhen dhe kujdesen për familjet e tyre, pas vdekjes së tyre eventuale. Vdekja e Rasim Zeqirit nga Gostivari hap çështjet në vijim: pse ka vullnetarë në rajon që marrin pjesë; cilat janë arsytet për pjesëmarrjen e tyre në konflikte të tilla të armatosura dhe cila është mënyra me anë të së cilës ata rekrutojnë. Rasim Zeqiri jetoi në Austri për një kohë të gjatë dhe më pas shkoi në Siri dhe luftoi për tetë muaj. Në Siri, ai iu bashkua grupit të famshëm islamik al Džhabat Nusra, i cili ka rreth gjashtë mijë ushtarë dhe përfaqëson një degë të al-Qaeda-s në Irak. Islami fundamentalist u shpërngul nga Gostivari tek Bosnja dhe Hercegovina nga banorët e Gostivarit, të cilët jetonin aty.” (“Уште Еден Албанец Од Македонија Загина Во Сирија” 2017)

Në një situatë ku Shqipëria, Greqia dhe Bullgaria janë anëtare të NATO-s, mosmarrja në konsideratë e kwtij “kryqëzimi”, nuk është një opsion i duhur, duke patur parasysh faktorët e sipërpërmendur.

4. Në vendin e Maqedonisë

Nocioni i përgjithshëm i anëtarësimit të Maqedonisë në NATO është që, në një situatë ku rajoni i Ballkanit dhe anëtarët e NATO-s po merren me krizën e emigrantëve, rritjen e radikalizmit dhe rritjen e numrit të luftëtarëve të huaj nga rajoni në ISIS, sulmet terroriste përgjatë Europës dhe katastrofën e mundshme humanitare, Maqedonia ka ngecur në mes të asgjësë, pa asnjë arsye. Kufiri maqedonas është aktualisht nën presion të madh – megjithëse e rrethuar nga shtete që janë anëtare të NATO-s, Maqedonia është vënë në një situatë të tillë që të jetë mburoja e Aleancës dhe Europës, ndërkohë që Europa është ende duke hulumtuar zgjidhje, ndonëse Maqedonia nuk ka qenë kurrë një faktor imponues i krizës në Lindjen e Mesme.

Anëtarësimi në NATO dhe BE nënkupton për qytetarët jo vetëm një premtim për një jetë më të mirë e më të sigurtë, por gjithashtu një njohje e peshës së rëndë të tranzicionit që ata e kanë mbajtur për më shumë se dy dekada. Duke marrë në konsideratë edhe mentalitetin vendas, kjo njohje do të vlerësohej së tepërmi.

Përfitimi më i madh nga anëtarësimi në NATO do të ishte me shumë gjasa njohja e kufijve dhe nocioni që Aleanca është konsideruar si një mbrojtëse e sovranitetit. Marrëdhëniet ndëretnike janë përdorur gjithmonë për t’u dhënë më shumë kredite politikanëve. Në Maqedoni, ndonëse ka një presion të lartë

për parti jo-etnike, forcat politike ende referohen veçmas në bllokun Maqedonas (VMRO DPMNE si konservatorët dhe SDSM si social-demokratët) dhe në bllokun politik të qytetarëve me origjinë etnike shqiptare (DUI, DPA dhe së fundmi BESA), dhe forcat e etiketuara si federaliste e kështu me rradhë, përdoren shpesh për t'i frikësuar qytetarët, për të bërë presion dhe për të fituar më shumë pikë. Marrëveshja Kuadër e Ohrit shihet nga pikëpamje të ndryshme, në varësi të nevojave të përditshme, dhe frika e një konflikti të mundshëm është përdorur gjithashtu aq shumë, saqë skandali i përgjimit nxorri një nga ministrat kyç të qeverisë së mëparshme duke thënë diçka të tillë si: le të bëjmë luftë (“АУДИО) Протугер: А Војна Да Имаме? За Еден Саат Ќе Ги Смачкаме | Бриф” 2017).

5. Rruga e Maqedonisë drejt ëndrrës Euro-Atlantike: Një retrospektivë

Pas tërheqjes paqësore nga federata Jugosllave, shteti u përball me shumë pengesa, por ia doli të vendoste demokracinë dhe ndërtonte kapacitetet institucionale, duke marrë statusin si kandidat për në BE në 2005-ën si një vlerësim për përpjekjet në këtë drejtim.

Shumë analistë do të thonin se shteti i vogël që gjendet në zemër të Ballkanit kishte fat që u drejtua nga politikanë tepër të mençur, të cilët do të bënin çdo gjë për të ruajtur paqen dhe për të parandaluar gjakderdhje në periudhën e marrjes së pavarësisë nga Jugosllavia. Megjithatë, kjo nuk ishte një rrugë pa pengesa.

Shumë gjëra që u vështirësuan gjatë periudhës së fitimit të pavarësisë, janë duke shfaqur efektet edhe në ditët e sotme. E para ishte sigurisht, përfshirja e shtetit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe problemi unik në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare – çështja e emrit. Pavarësia e shtetit u mbështet nga ndwrhyrja e forcave parandaluese të OKB-së, për të parandaluar përshtetimin e luftërave kombëtare në territorin e federatës së ish-Jugosllavisë. Shteti u përball gjithashtu me embargo ekonomike nga të dyja anët: embargo tregtare nga Greqia (1994-1995) (“Press Online” 2017), dhe embargo ndërkombëtare vendosur ndaj Serbisë dhe regjimit të Millosheviç, mbështetur nga Maqedonia, megjithëse për shkak të marrëdhënive të mëparshme, shumica e eksport-impoteve u bë në atë vazhde.

Kjo nënkuptonte shanse të dobëta për zhvillim ekonomik në fillimet e pavarësisë së shtetit, dhe liberalizim të zhvilluar në masë të gjerë. Megjithatë, udhëheqësit u përpoqën të përfitonin nga situata. Kështu, shteti hyri në OKB

në mënyrë të përkohshme dhe vendimi i OKB-së i çoi negociatat në mosmarrëveshje. Përveç kësaj, marrëveshja e përkohshme u firmos me Greqinë në mënyrë që marrëdhëniet ekonomike të normalizoheshin. Paralelisht kësaj, shteti fitoi anëtarësim në shumë organizata rajonale dhe internacionale dhe krijoi marrëdhënie bilaterale duke përdorur emrin e tij konstitucional me shumicën e shteteve që ishin anëtare të BE-së. Institucionet dhe procedurat demokratike u themeluan dhe u pranuan, ndonëse trauma e tranzicionit mbeti. (Për më tepër në lidhje me këtë shiko “Dokumente për Republikën e Maqedonisë 1990-2005” publikuar nga Fakulteti i Juridikut “Iustinianus Primus” në Shkup 2008).

Influencat rajonale në periudhën e zhvillimeve demokratike të Maqedonisë nuk ishin të favorshme. Ndikimet më të rëndësishme vinin nga veriu: Shteti u përball me 300-350 000 refugjatë nga Kosova (Përfundimi i Studimit “Nato Facing New Challenges And Perspectives Of Republic Of Macedonia” 2005). Kriza kryesore me të cilën shteti u përball ishte në vitin 2001, kur u ballafaqua me dhunë të armatosur – më së shumti e ardhur nga ngjarjet në Kosovë (“Oh No, Not War In Macedonia As Well” 2017). Debati mbi natyrën dhe klasifikimin e qeverisë së armatosur është sfidues edhe në ditët e sotme, ku fjalori që varion nga “çlirim kombëtar” tek “terrorizëm” dëgjohet midis njerëzve të thjeshtë dhe medias. Zhvillimi i krizës çoi në formimin e gjerë të koalicioneve qeveritare të unitetit kombëtar (“НЕЗАВИСНА МАКЕДОНИЈА - МАКЕДОНИЈА ПОСЛЕ 1990” 2017). Kriza u mbyll me ndërhyrjen e komunitetit ndërkombëtar dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër të Ohrit, ndjekur nga ndryshimi i qeverisë.

Zgjedhjet parlamentare u mbajtën në 15 Shtator 2002, kur koalicioni i majtë opozitar i drejtuar nga social-demokratët, fitoi rreth gjysëm million vota, duke e bërë atë fitoren më bindëse elektorale.

Si çdo shoqëri që rikthehet nga dhuna dhe urrejtja, shoqëria Maqedonase u përball gjithashtu me shumë vështirësi. Mungesa financiare, grumbullimi i armëve të jashtëligjshme, kthimi në shtëpi i qytetarëve të zhvendosur, ishin thjesht një pjesë e sfidave të rënda. Megjithatë, u zhvilluan reforma intensive dhe pati pwrpjekje për rikthimin e besimit, paqes dhe demokracisë. Vlerësimi më i madh për këtë mund ishte marrja e statusit kandidat për në BE në dhjetor të 2005-ës. Ndërkohë, e njëjta parti qëndroi në fuqi dhe zgjedhjet parlamentare nuk u zhvilluan.

Fillimi i 2006-ës, një vit që supozohej të ishte elektoral, u shënuar me lajmin që kompania e energjisë elektrike do të transformohej dhe privatizohej, në përputhje me idenë për veçimin dhe anëtarësimin në Komunitetin Energjistik të

Europës Jug-Lindore. Me shumë gjasa, kjo është periudha kur lëvizja e parë populiste (së paku e konsideruar nga forma e saj kështu) u shfaq në skenë me emrin “Glas za svetlina” (Zë për dritë) duke protestuar kundër shitjes së kompanisë kombëtare të energjisë elektrike. Shfaqja e të ashtëquajturës lëvizje u konsideua si e debatueshme, sidomos më vonë (“Избори 2006” 2017), pas zgjedhjeve parlamentare dhe ndryshimit të qeverisë.

Zgjedhjet parlamentare, të mbajtura më 5 korrik 2006 sollën ndryshim të qeverisë dhe politikave, si dhe premtime për një jetë më të mirë dhe prosperitet ekonomik. Partia më e rëndësishme konservatore në Maqedoni, VMRO DPMNE doli nga kriza, dhe kështu me një markë të re dhe e drejtuar nga një grup i ri drejtues, fitoi simpatinë e publikut, i cili ndjeu se më në fund pati një ndryshim të gjeneratave në arenën politike. Megjithatë, këto pritshmëri nuk zgjatën gjatë. Justifikimi që “Rilindja”, ashtu sikurse u emërtua edhe platforma politike fituese, nuk solli rezultatet e pritshme iu adresua krizës globale ekonomike.

Në 2008-ën, pasi vendi nuk e mori ftesën për t’ju bashkuar NATO-s, ndonëse kërkesat formale të anëtarësimit ishin përmbushur, me iniciativën e koalicionit qeveritar, u zhvilluan zgjedhjet e parakohshme parlamentare (“Министерство За Надворешни Работи” 2017).

6. Udhërrëfyesi i Maqedonisë për në NATO

Në 1993, parlamenti maqedonas shpalli aspiratën për anëtarësim në NATO. Maqedonia iu bashkua Partneritetit për Paqe të NATO-s në 1995 dhe Planit të Veprimit për Anëtarësim në 1999. Ftesa e NATO-s u bllokua *de facto* nga Greqia në Samitin e Bukureshtit në 2008-ën, megjithëse formulimi zyrtar ishte për marrjen e vendimeve me konsensus. Shtetet anëtare të NATO-s ranë dakord se shteti do të merrte një ftesë pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes me fqinjët.

Qeveria maqedonase paditi Greqinë përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për shkelje të Marrëveshjes së Përkohshme dhe bllokim *de facto* të anëtarësimit në NATO dhe fitoi, ndonëse gjykimi nuk solli asnjë ndryshim në terren.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Maqedonia kishte kontribuar ndaj operacioneve të drejtuara nga NATO, dhe NATO ishte gjithashtu e përfshirë në rajon gjatë krizës në Kosovë dhe konfliktit në Maqedoni. E famshmja New York Times raportoi se: “Për frymë, Maqedonia është kontribuesja e pestë më e madhe e

forcave për misionin e NATO-s në Afganistan, duke siguruar rreth 175 individë përgjegjës për mundësimin e sigurisë në zyrat qendrore të NATO-s në Kabul dhe përgjatë zonës diplomatike në kryeqytetin e Afganistanit, ku përfshihet dhe Ambasada Amerikane. Trupat maqedonase po trajnojnë edhe forcat e sigurisë Afgane. Ky mund të rreth 10% të buxhetit të mbrojtjes së Republikës. (Më parë Maqedonia kontribuoi rreth 500 trupa në përpjekjen e Amerikanëve në Irak)” (Shanker 2017).

Që nga pavarësia, anëtarësimi në NATO mbeti një prioritet kryesor për çdo qeveri dhe elitë politike në vend – kjo është me shumë gjasa një nga çështjet e pakta me të cilat çdo lider politik bie dakord. NATO konsiderohet garantuese e integritetit dhe sigurisë në aspektin e brendshëm e të jashtëm, për shkak të turbulencave të paradigmave historike dhe të mjedisit konkret kombëtar. Konsiderohej të ishte një ide, një mundësi, dhe pragmatizëm në të njëjtën kohë.

Vlen të theksohet që kjo gatishmëri është përkthyer gjithmonë në veprime konkrete. Është i rëndësishëm fakti që Maqedonia ishte një nga kontribuesit më të mëdhenj për frymë në Afganistan për një periudhë kohe. Pas Samitit të NATO-s në Bukuresht, zhgënjimi ishte i qartë, në të dyja palët, për hir të së vërtetës. Çmimi për këtë situatë të pakëndshme u pagua nga Maqedonia në shumë nivele dhe efektet janë ende të dukshme duke qenë se ndikuan në ndarjen e pushtetit politik.

7. Samiti i NATO-s në 2008-ën

Stabiliteti i Ballkanit Perëndimor ishte një nga pikat kryesore në Samitin e Bukureshtit, bashkë me zgjerimin e NATO-s, partneritetet, prezencën në Afganistan, sigurinë energjitike dhe sigurinë kibernetike. Megjithatë, ndonëse e merituar, nuk u dorëzua ftesa për Maqedoninë për t’ju bashkuar Aleancës, ndryshe nga Shqipëria dhe Kroacia.

“Një delegacion i brengosur maqedonas u largua nga Samiti i NATO-s në Bukuresht pasi Greqia pati sukses në veton kundër anëtarësimit të Maqedonisë të enjten” – është vetëm një nga titujt bombastikë (SPIEGEL ONLINE 2017). Përpara se të drejtohej për në shtëpi, Presidenti maqedonas Branko Crvenkovski tha: “Unë dua t’i dërgoj Greqisë një mesazh. Ne do të mbijetojmë dhe shtetasit maqedonas do ta kapërcëjnë këtë fatkeqësi.” Zyrtarët maqedonas paralajmëruan se dështimi mund të dëmtonte stabilitetin në Ballkan. Ministri i Punëve të Jashtme (MPJ) Nikola Dimitrov tha për

Associated Press se ishte një “zhgënjim i madh,” duke shtuar se “çon mesazhin e gabuar në aspektin e politikave dhe forcave të moderuara.”

Zhgënjimi ishte i qartë për shumë zyrtarë të tjerë të shtetit jashtë vendit, ekspertë dhe gazetarë. UK Telegraph shkroi si më poshtë: “Samiti i NATO-s në Bukuresht po mbulohet nga hija e asaj çka zyrtarët amerikanë e quajnë “çeshtja madhore më e kotë në botë”. Diskutimi i hidhur mes Greqisë dhe fqinjit të saj verior mbi pretendimet e emrit të Maqedonisë kërcënon të prishë planet e zgjerimit të anëtarësimit në NATO në Ballkan – një nga qëllimet kryesore të Samitit.” (Berlin 2017)

Çfarë ndodhi në Samit u trajtua më tepër emocionalisht në vend. Rezultatet e Samitit u përdorën nga kryeministri në atë periudhë, për ta rikujtuar për zgjedhje të parakohshme parlamentare, dhe për një suport më të madh për të mbrojtur “vijat e kuqe të shtetit”. Zgjedhjet e organizuara i dhanë Gruevskit fitoren e tij më të madhe. Ishte një mësim politik për (keq)përdorjen e politikave të jashtme për fitore të brendshme. Kriza politike më në fund përfundoi, por e ardhmja Euro-Atlantike ishte premtimi kyç i qeverisë së re.

NATO vazhdon ta mbajë fokusin në prioritetet e saj, por kur vjen puna tek çështja e zgjerimit, Samiti i Varshavës në 2016 riafirmoi qartazi se: “Vendimmarrja me konsensus është një parim themelor, i cili është pranuar si baza e vetme për vendimmarrje në NATO që nga Krijimi i Aleancës në 1949. Vendimmarrja me konsensus nënkupton se nuk ka votim tek NATO. Këshillimet ndodhin derisa arrihet një vendim që është i pranueshëm nga të gjithë.” (NATO Summit Guide 2016).

Kjo do të thotë se megjithëse GJND mori një vendim në favor të Maqedonisë, ana e Greqisë mund të vazhdojë të mos e respektojë, pavarësisht se pohimi i përgjithshëm se “Vetëm çështja e emrit të shtetit e ndaloi NATO-n të ftonte Shkupin t’i bashkohej Samitit të 2008-ës në Bukuresht” vazhdon të jetë i vlefshëm (Allen and Stefanini 2017).

8. Kriza politike solli prioritete të ndryshme në perspektivën më të gjerë

Pas anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, Maqedonia mbeti vetëm, e rrethuar nga shtete anëtare të NATO-s (përveç Kosovës dhe Serbisë, por kjo është një histori tjetër), për të siguruar kufirin e Europës gjatë rrugës Egnatia. Kjo shkon paralelisht me agjendën e zgjerimit të BE-së në rajon, që pas Brex-it u konsiderua të ishte pak me vonësë.

Prezenca e Rusisë si dhe e Turqisë në rajon u shtua, ndonëse në një mënyrë krejt të veçantë. Ashtu sikurse NATO Review pohon: "... boshllëku i krijuar nga politikat e dështuara ka krijuar mundësi shfrytëzimi përgjatë rajonit për një Rusi agresive. Pa harxhuar shumë kapital financiar ose politik, Moska ka kërkuar të forcojë ndjenjat anti-perëndimore, në veçanti përmes Serbëve; për të përforcuar regjime të ngjashme; dhe për të dëmtuar më tej perspektivat e integritimit Euro-Atlantik..." (Review 2017).

Një tjetër nxitës që ishte duke përshpejtuar tensionet ndëretnike dhe shqetësimet për statusin aktual ishte e ashtuquajtura "Tirana Platform", që në fund u tërhoq nga të gjithë përveç VMRO-DPMNE, por që ishte gjithsesi benzinë e shtuar për zjarrin për disa javë.

9. NATO sot

Periudha pas Luftës së Ftohtë solli ndryshime të aktorëve. Qeveritë humbën monopolin e fuqisë dhe pati një rritje të qartë të sektorit privat dhe të korporatave ekonomike. Përveç kësaj, rritja e kërcënimeve asimetrike dhe hibride i komplikon edhe më shumë gjërat. Politikat e rishikuara të NATO-s ndaj mbrojtjes kibernetike në 8 qershor 2011 dhe Deklarata e Samitit të Çikagos në maj të 2012-ës theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me shtetet partnere për të arritur një siguri më të madhe kibernetike. Në të njëjtin aktivitetet, Rasmussen theksoi se siguria kibernetike – mbrojtja e sistemeve të informacionit elektronik që janë në zemër të luftës moderne – mbetet përgjegjësia e 28 shteteve anëtare.

Në ditët e sotme, Aleanca përfaqëson një konstante të ndryshueshme: përshtatja ndaj sfidave të reja të sigurisë paralelisht me promovimin e vlerave demokratike. Rreth 18,000 ushtarakë janë të përfshirë në misionet e NATO-s përreth botës, duke menaxhuar shpesh terrene komplekse, operacione detare e ajrore në të gjitha llojet e mjediseve, momentalisht duke operuar në Afganistan, në Kosovë dhe në Mesdhe. ("Operations And Missions: Past And Present" 2017)

Interesi i Aleancës zgjerohet, së bashku me fushën e operacioneve. Kundërterrorizmi, zgjerimi, siguria energjitike dhe kibernetike janë thjesht një pjesë e agjendës në vazhdim.

Pas vendimeve të Samitit të Lisbonës, Ministrat e Jashtëm Aleatë që u takuan në Berlin miratuan një politikë të re partneriteti, më efikase dhe fleksibël (NATO Encyclopedia 2016).

Më vonë, në Samitin e Uellsit në 2014, nisi Nisma për Ndërveprueshmëri brenda Partneritetit (NNP) për të ruajtur dhe thelluar ndërveprueshmërinë që është zhvilluar brenda partnerëve gjatë operacioneve dhe misioneve të drejtuara nga NATO. Themelet kryesore të kësaj nisme ritheksojnë rëndësinë e zhvillimit të ndërveprueshmërisë dhe sigurojnë që të gjitha programet ekzistuese për ndërveprueshmëri brenda partneritetit të përdoren në potencialin e tyre të plotë; të rrisin mbështetjen; të ofrojnë mundësi të gjera për bashkëpunim; të theksojnë se ndërveprueshmëria duhet të mbetet prioritet në marrëdhëniet e NATO-s me organizata të tjera ndërkombëtare që administrojnë kriza ndërkombëtare. Kjo shkon paralelisht me të ashtëquajturën “dimensioni i tretë i NATO-s”.

Megjithatë, rezultati i zgjedhjeve Presidenciale në SHBA dhe vendosja e administratës së Trump-it do të ndikojë me shumë gjasa në agjendë, në një mënyrë tjetër, që mbetet për t’u parë. (“Trump Claims Defense Money Is Pouring Into NATO After Speech” 2017)

Një NATO gjithpërfshirëse duhet të mbështetet në një perspektivë globale të sigurisë, ndonëse kjo nuk do të thotë të qenurit një “polic botëror”. Por, duke u angazhuar me pjesën tjetër të botës, NATO do të maksimizonte burimet e disponueshme dhe të ndante barrën e sigurisë në një botë në ndryshim.

10. Marrëveshja e Përkohshme dhe vendosja e Greqisë përballë GJND (Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë)

Maqedonia kërkoi një deklaratë që Greqia kishte shkelur detyrimin e saj sipas Nenit 11 të Marrëveshjes së Përkohshme, ku ndalohet kundërshtimi i anëtarësimit në NATO. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë deklaroi se kishte një shkelje të marrëveshjes së përkohshme lidhur me kërkesën e Maqedonisë për t’u anëtarësuar në NATO në vitin 2008. Megjithatë kjo nuk solli ndonjë ndryshim në praktikë, gjë që e bëri trupin gjykues të Kombeve të Bashkuara të mos merrej seriozisht. Vetë Traktati i Washington-it vjen nga e njëjta Kartë e Kombeve të Bashkuara - e njëjta kartë që vendos sistemin e mbrojtjes së

përgjithshme dhe barazisë sovrane të shteteve dhe njëh principin e mosndërhyrjes.

Identiteti nuk është një çështje njohjeje, por një çështje intimiteti dhe ndjenje personale përkatësie. Pavarësisht përfundimit të këtij procesi, të dy vendet do të ndiheshin njëlloj- do të tregëtonin dhe bashkëpunonin. Qeveritë do të ndryshohen një ditë, pavarësisht sa përpiqen të bëjnë politikë në çështjet e identitetit.

Për këtë arsye, ky proces duhet përshpejtuar, përpara se paqartësia e mosmarrëveshjeve bilaterale rreth zotërimit imagjinar të kulturës dhe historisë të kapërcejë problemet e jetës reale me të cilat të gjithë përballemi, aq më tepër kur bëhet fjala për një situatë sigurie që është gati të shpërthejë dhe të ketë efekte të gjera, pas së cilës asgjë tjetër nuk do të ketë rëndësi.

Anëtarësimi i mundshëm në NATO do të nënkuptonte që kufijtë dhe identitetet ruhen si një e tërë. Për të qenë më specifik: do të nënkuptonte respekt për marrëdhënie të mira me fqinjët, sovranitet dhe integritet tokësor për të dy shtet e përfshira. Proceset e negociimit me Aleancën mund të vazhdojnë ende, nëse kjo vazhdon të konsiderohet një çështje me rëndësi. Ky ishte rasti kur Turqia dhe Greqia iu bashkuan Aleancës së bashku.

11. Drejt një Ballkani më të sigurt

Shqipëria është një anëtare e plotë e NATO-s, Maqedonia është një kontribuese e trupave të ushtrisë ndërkombëtare në Afganistan. Kjo gjë e bën rajonin një shënjestër të mundshme. Dhe vetëm kohët e fundit, ISIS publikoi një video (duke iu drejtuar qytetarëve të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe shteteve të tjera në Ballkan) ku thuhej: “Do të ketë disa ditë të zeza për të gjithë ju. Ne nuk harrojmë çfarë u keni bërë Muslimanëve; do të keni frikë të ecni në rrugë; do të keni frikë të punoni në zyrat tuaja. Ne do të sillemi me ju ashtu siç bëtë dhe ju në Irak. Ne do t’u bashkohemi njerëzve që duan vdekjen më shumë se jetën. Ne do të luftojmë derisa ta ngremë fjalën e Allah-ut në shtet dhe do të ndodhë së shpejti” (“ISIS Threatens The Albanians: Dark Days Are Coming For You” 2017).

Numri i qytetarëve maqedonas, me origjinë etnike shqiptare, që kanë shkuar të luftojnë për ISIS mbetet i panjohur, por është padyshim në rritje (“He Ce Знае Бројот На Македонските Државјани Кои Војуваат Во Ирак И Сирија” 2017).

Gazeta ditore “Vecer” deklaroi në janar 2015 se një tjetër qytetar Maqedonas, i 14-ti vdiq në një betejë në Siri, ndërkohë që 200 po luftojnë. Megjithatë, ky informacion as nuk u konfirmua, as u mohua.

12. Lëkundje e opinionit publik

Anëtarësimi në NATO u mbështet shumë nga qytetarët Maqedonas. Megjithatë, kur u pyetën nëse do ta pranonin anëtarësimin në NATO me koston e ndryshimit të emrit të shtetit, mbështetja u ul për çerekun. Ulje e vogël u vu re në anketimet e bëra menjëherë pas Samitit në 2008.

Rezultatet e sondazheve të publikuara në pranverë të 2016-ës treguan se vetëm ¼ e qytetarëve do të votonte kundër hyrjes në NATO, dhe tregonte mbështetje të fortë për Aleancën. Të pyetur nëse do ta pranonin ndryshimin e emrit në mënyrë që të hynin në NATO, vetëm 67% ranë dakord. Kjo nuk ndikoi ata qytetarë me origjinë etnike shqiptare (“Анкета: Опаѓа Поддршката За Членство Во НАТО И ЕУ” 2017).

Këta shifra mbështetjeje janë më të vegjël se ato të sondazhit të 2014-ës (ndonëse ajo anketë u bë nga një subjekt i ndryshëm nga i fundit), publikuar nga Fakulteti i Sigurisë në Shkup, që ka treguar mbështetje për NATO-n më tepër se 81% të popullsisë. (“Истражување: 81 Насто Од Граѓаните Се За Членство Во НАТО, 63 За Членство Во ЕУ” 2017).

Të dhënat e fundit nga Janari i 2017-ës tregojnë një mbështetje prej 61% në total, por ky numër ulet nëse çështja e emrit merret në konsideratë (“Македонските Граѓани Сакаат Членство Во НАТО, Но Не Под Референцата ПЈРМ Или Со Промена На Името” 2017).

Ndonëse përqindjet e larta janë ulur, ndryshimi i fundit i qeverisë dhe forcimi i marrëdhënieve me Aleancën dhe rritja e presionit diplomatik duhet të sjellë rritje të mbështetjes dhe shpresë.

Ekspertët ndërkombëtarë të fushës bien dakord se në çdo rast, anëtarësimi në NATO është një domosdoshmëri (“Macedonia Should Resolve Name Dispute To Join EU, NATO — Sarajevo Times” 2017).

13. Skenarë të mundshëm: Jo rrugë tjetër - NATO ose “blato”¹

¹ Fjalë vendase për kënetë: një zonë e ulët tokësore që përmytet në sezone të lagështa ose në baticë të lartë, dhe zakonisht mbetet e mbytur gjatë gjithë kohës.

Teorikisht, ka tre skenare:

- a) **Skenari i anëtarësimit në NATO:** Maqedonia i bashkohet përkohësisht NATO-s, (ose një situatë e ngjashme e pranuar bashkarisht) gjë që do të sillte pakënaqësi në vend dhe mundësisht zgjimin e fantazmave nacionaliste dhe kërcënim ndaj shumicës parlamentare, duke rritur kështu probabilitetin e zgjedhjeve të reja dhe krizave të reja politike;
- b) **Skenari phi²,** bazuar në gjykimin e GJND-së, që do të thotë se Maqedonia do të mund të anëtarësohet në NATO me emrin e saj kushtetues, gjë që ngjan me një përrallë (Volteri ka thënë se mendimi praktik nuk është edhe aq praktik dhe fatkeqsisht, ai kishte të drejtë), sepse Syriza është tashmë duke humbur mbështetje. Fatkeqësisht, diskutimi i çështjes së emrit është problemi i fundit që ata kanë dhe nuk do t'i ndihmonte në afatgjatë. Ky skenar do të sillte një Maqedoni më të fortë, qëndrueshmëri ndëretnike e politike, dhe rajon të qëndrueshëm;
- c) **Skenari i hedhjes në tokë** do të nënkuptonte bllokimin e anëtarësimit të Maqedonisë në NATO në çdo rast, gjë që do të sillte destabilitet, rritje të nacionalizmit dhe populizmit, tensione ndëretnike dhe krizë të re politike në Maqedoni, ashtu sikurse tërheqje nga agjenda euro Atlantike dhe efekte në nxitjen e një konflikti të mundshëm;

Pse është skenari phi versioni më i mirë edhe për Greqinë? Sepse, argumentet kryesore nga ana e Greqisë për çështjen e emrit, siç janë pretendimet territoriale do të zhduken, meqënëse dy shtete anëtare të NATO-s garantojnë pavarësinë territoriale të njëri-tjetrit. Qeveria greke ka një shans historik që të lërë pas retorikën populiste dhe të fitojë mbështetje për problemet e saj, pavarësisht nga fqinjët të saj në veri.

Bibliografi

Allen, John R, and Stefano Stefanini. 2017. *Comprehensive NATO*. Ebook. GLOBSEC Policy Institute.
<https://www.globsec.org/upload/documents/nato-adaptation/gnai-comprehensive-nato.pdf>.

Berlin, Harry. 2017. "Macedonia Row Overshadows NATO Summit". *Telegraph.Co.Uk*.
<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/1583685/Macedonia-row-overshadows-NATO-summit.html>.

² Phi është shkronja greke që simbolizon "të pjesshmen e artë" në matematikë

- Conclusion On The Study "Nato Facing New Challenges And Perspectives Of Republic Of Macedonia"*. 2005. Ebook. Skopje: Fridrich Ebert Stiftung.
<http://www.fes.org.mk/pdf/nato.pdf>.
- "ISIS Threatens The Albanians: Dark Days Are Coming For You". 2017. *Albanian Daily News*.
<http://www.albaniannews.com/index.php?idm=1695&mod=2>.
- NATO Encyclopedia*. 2016. Ebook. Bruselles.
http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_publications/2017_0213_2016-nato-encyclopedia-eng.pdf.
- NATO Summit Guide*. 2016. Ebook. Brusells: NATO.
http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2016_07/20160715_1607-Warsaw-
- "Oh No, Not War In Macedonia As Well". 2017. *The Economist*.
<http://www.economist.com/node/530291>.
- "Operations And Missions: Past And Present". 2017. *NATO*.
http://www.nato.int/cps/bu/natohq/topics_52060.htm.
- "Press Online". 2017. *Pressonline.Com.Mk*.
<http://www.pressonline.com.mk/?ItemID=A0C6BC8EE5C5D749A4EE0B0FB0C402D4>.
- Review, NATO. 2017. "Backsliding In The Western Balkans". *NATO Review*.
<http://www.nato.int/docu/review/2017/Also-in-2017/backsliding-western-balkans-kosovo-servia-bosnia/EN/index.htm>.
- "Secretary General Welcomes Prime Minister Zaev To NATO Headquarters". 2017. *NATO*. http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_144881.htm.
- Shanker, Thom. 2017. "Macedonia's Plea For A Seat In NATO Falls On Busy Ears". *At War Blog*.
<https://atwar.blogs.nytimes.com/2012/04/26/macedonias-plea-for-a-seat-in-nato-falls-on-busy-ears/>.
- "Macedonia Should Resolve Name Dispute To Join EU, NATO — Sarajevo Times". 2017. *Sarajevotimes.Com*.
<http://www.sarajevotimes.com/?p=121600>.
- SPIEGEL ONLINE, Germany. 2017. "Dejection In Bucharest: Jilted Macedonia Walks Out Of NATO Summit - SPIEGEL ONLINE - International". *SPIEGEL ONLINE*.
<http://www.spiegel.de/international/world/dejection-in-bucharest-jilted-macedonia-walks-out-of-nato-summit-a-545214.html>.
- "Trump Claims Defense Money Is Pouring Into NATO After Speech". 2017. *Thehill*. <http://thehill.com/blogs/blog-briefing-room/news/335396-trump-claims-defense-money-is-pouring-into-nato-after-speech>.
- "(АУДИО) Протугер: А Војна Да Имаме? За Еден Саат Ке Ги Смачкаме | Бриф". 2017. *Brif.Mk*.
<http://www.brif.mk/%D0%B0%D1%83%D0%B4%D0%B8%D0%BE->

%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D1%83%D1%93%D0%B5%D1%80-%D0%B0-%D0%B2%D0%BE%D1%98%D0%BD%D0%B0-%D0%B4%D0%B0-%D0%B8%D0%BC%D0%B0%D0%BC%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%B5%D0%B4%D0%B5/.

“Избори 2006”. 2017. *Sobranie.Mk*. <http://www.sobranie.mk/izbori-2006.nspх>.

“Македонија Влегува Во Сојуз Со САД Во Битка Против Сајбер Тероризмот”. 2017. *МКД.МК*.

<http://www.mkd.mk/makedonija/politika/makedonija-vleguva-vo-sojuz-so-sad-vo-bitka-protiv-sajber-terorizmot>.

“Министерство За Надворешни Работи”. 2017. *Mfa.Gov.Mk*.

<http://www.mfa.gov.mk/?q=nadvoresna-politika/makedonija-i-nato>.

“НЕЗАВИСНА МАКЕДОНИЈА - МАКЕДОНИЈА ПОСЛЕ 1990”.

2017. *Makedonijaese.Com*. <http://www.makedonijaese.com/storia12.htm>.

“Уште Еден Албанец Од Македонија Загина Во Сирија”. 2017. *Time.Mk*.

<http://www.time.mk/c/5e9b4e2d21/kumanovec-zagina-vo-sirija.html>.

“Анкета: Опаѓа Поддршката За Членство Во НАТО И ЕУ”. 2017. *Сител Телевизија*. <http://sitel.com.mk/anketa-opagja-poddrshkata-za-chlenstvo-vo-nato-i-eu>.

“Истражување: 81 Насто Од Граѓаните Се За Членство Во НАТО, 63 За Членство Во ЕУ”. 2017. *24Vesti.Mk*. http://24vesti.mk/istranzhuvanje-81-nasto-od-gragjanite-se-za-chlenstvo-vo-nato-63-za-chlenstvo-vo-eu?quicktabs_popularna_sodrzina=1.

“Македонските Граѓани Сакаат Членство Во НАТО, Но Не Под Референцата ПЈРМ Или Со Промена На Името”. 2017. *Press24.Mk*. <http://press24.mk/makedonskite-gragjani-sakaat-chlenstvo-vo-nato-no-ne-pod-referencata-pjrm-ili-so-promena-na-imeto>.

“Не Се Знае Бројот На Македонските Државјани Кои Војуваат Во Ирак И Сирија”. 2017. *Kanal5.Com.Mk*.

http://www.kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=42543.

“Уште Еден Македонски Муџахедин Загина Во Сирија За Идеалите На ИД”. 2017. *Вечер*. <http://vecер.mk/makedonija/ushte-eden-makedonski-mudzhahedin-zagina-vo-sirija-za-idealite-na-id>.

KOMPLEKSITETI I SIGURISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR: PROCESET DHE ÇËSHTJET

Nina SKOČAJIČ JUVAN, Anton GRIZOLD¹

Abstrakt

Pas përfundimit të luftërave që erdhën si pasojë e shpërbërjes së Jugosllavisë, Ballkani Perëndimor (BP) hyri në rrugën e tranzicionit dhe reformave të cilat për arsye të ndryshme politike, sigurie apo ekonomike vazhdojnë edhe sot.

Bazuar në një analizë më të gjerë të kuadrit të sigurisë në rajon, ky studim identifikon proceset kryesore transformuese dhe analizon elementët dhe implikimet e tyre, të cilat përbëjnë kompleksitetin e sigurisë në BP. Vlerësimi i situatës bëhet në nivelin e vendeve individuale dhe gjetjet ekstrapolohen për të gjithë rajonin dhe Evropën. Synimi i këtij punimi është vlerësimi i dinamikave të rajonit dhe çështjeve themelore që kanë lidhje dhe ndikojnë tek njëra-tjetra. Më tej periudha e transformimit ndahet në tre procese: stabilizimi me shtetndërtimin, demokratizimi me ndërtimin institucional dhe integrimi euroatlantik.

Siguria e Ballkanit Perëndimor është bërë edhe më komplekse gjatë 25 vjetëve të fundit për shkak të këtyre proceseve të papërfunduara, bashkë me çështjet e pazgjidhura të së shkuarës të cilat vijnë si pasojë e elementëve të ndërlidhur dhe të përforcuar politik, socio-ekonomik dhe etno-nacionalë. Gjithashtu ka sfida të reja dhe të vjetra të sigurisë të cilat e ndërlikojnë edhe më shumë situatën e sigurisë. Në vend që të bëhet progres me tranzicionin demokratik dhe rrugën e integrit, ndërveprimi me elementë të ndryshëm duket se e vendos rajonin në rrezik destabilizimi dhe ngadalëson progresin, kjo shoqërohet me faktin se nuk janë përmbytur të gjitha kushtet për stabilitet. Analiza nxjerr përfundimin se kuadri i sigurisë sa vjen e bëhet më kompleks dhe i përkeqësuar, dhe si pasojë, ndikon në funksionimin dhe zhvillimin e të gjithë rajonit, si dhe prosperitetin dhe stabilitetin e të gjithë kontinentit.

¹ Nina Skočajič Juvan, M.Sc., Kandidat PhD në degën e Sigurisë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Lubjanës, Slloveni; Anton Grizold, PhD, Profesor i Sigurisë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Lubjanës, Slloveni.

Fjalë kyçe: Ballkani Perëndimor, siguria, kompleksiteti, stabilizimi, transformimi, tranzicioni, integrimi euroatlantik.

1. Hyrje

Vizioni i një Evrope “të bashkuar, të lirë dhe në paqe ka qenë një ide thelbësore e axhendave evropiane dhe transatlantike të cilat përfshijnë rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP) si një pjesë integrale të Evropës dhe të procesit të zgjerimit evropian. Në dritën e ndryshimit të mjedisit gjeopolitik dhe të sigurisë, veçanërisht në Evropë dhe vendet rreth saj, janë shfaqur sfida të reja dhe janë krijuar marrëdhënie të reja. Më shumë se 100 vjet nga fillimi i Luftës së Parë Botërore, e cila filloi në qendrën e BP, mbi 70 vjet që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, më shumë se 25 vjet që nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe më shumë se 20 vjet pas masakrës së Srebrenicës dhe Marrëveshjes së Dejtonit, që sollën fundin e gjakderdhjes, ka ardhur koha për të hedhur një vështrim të ri në BP si një rajon i rëndësishëm në Evropë, si dhe për të vlerësuar situatën e sigurisë në rajon.

Shpërbërja e Jugosllavisë e pasuar me luftërat në Ballkan të viteve 1990 krijoi nevojën për transformime në mënyrë që të qetësohej rajoni i njohur historikisht si një “fuçi baruti”. Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Dejtonit nënkuptonte që BP mund të fillonte procese të tilla transformuese, shumica e të cilave janë të ndërlidhura dhe paralele, pa asnjë fillim apo fund të qartë (Jano, 2008). Vendet e BP kaluan sfidën e krijimit të identitetit dhe shtetësisë së tyre, shpesh bazuar në shoqëri multietnike. Pas 25 vjet ndërhyrjeje ndërkombëtare e fokusuar në stabilizimin, liberalizimin politik dhe ekonomik si dhe transformimin për pjesën më të madhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor, kjo enigmë ndërlikohet edhe më shumë nga vetë natyra komplekse e proceseve që ndikojnë njëra-tjetrën dhe nga shfaqja e fenomeneve të reja. BP po kalon ende reforma të shumta themelore, të cilat kryesisht për arsye politike, sigurie, historike dhe kulturore (etnike) janë vonuar.

Qëllimi i integritit euroatlantik ngelet për t'u përmbushur, megjithëse bashkësia ndërkombëtare besonte shumë se fuqia tërheqëse e BE-së dhe NATO-s do të ishte e mjaftueshme për të nxitur tranzicionin politik dhe reformën ekonomike në BP. Megjithatë, proceset e ndërthurura dhe të papërfunduara, sfidat (e reja) dhe dinamika rajonale, së bashku me të kuptuarit e pamjaftueshëm nga aktorët ndërkombëtarë të shkaqeve të tyre si dhe mungesa e vullnetit të elitave politike të BP për zgjidhjen e tyre, e bëjnë

edhe më komplekse situatën e sigurisë, duke penguar përparimin e Ballkanit Perëndimor në përmbushjen e kapitullit evropian. Kjo rrezikon destabilizimin, konfrontimin e ripërtërirë, një vonesë të mëtejshme në reformat dhe zhvillimin ekonomik, duke sfiduar kështu proceset transformuese.

Këto shoqërohen me sfida të reja (p.sh. rimëkëmbja nga kriza financiare dhe ekonomike, emigracioni masiv, terrorizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi (këto të fundit janë të importuara edhe nga luftëtarët e huaj nga vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë rikthimit të tyre nga Siria dhe Ukraina ku luftuan në krah të opozitës), shfaqjet nacionaliste në përkujtim të ngjarjeve të kaluara, edhe sportive), të cilat jo vetëm që paraqesin kërcënime të sigurisë, por edhe rrezikojnë legjitimitetin e shtet-kombeve.

Ky studim rreket t'i përgjigjet pyetjes kërkimore që bazohet në hipotezën se sfidat e shumta të vjetra apo të reja të sigurisë kanë pasoja për stabilitetin dhe vështirësojnë sigurinë e BP. Studimi argumenton se kompleksiteti i sigurisë në BP kërcënon sigurinë rajonale dhe atë evropiane.

Qëllimi është i dyfishtë. Së pari, identifikimi se cilat elementë në kuadër të proceseve transformuese e bëjnë sigurinë kaq komplekse, dhe shqyrtimi se pse ato përbëjnë një problem për vendet të vecanta të BP, rajonin dhe Evropën në tërësi. Këto elementë do të klasifikohen në indikatorë (politikë, socio-ekonomikë, etno-nacionalë) për të lehtësuar vlerësimin e situatës në fushat kyçe të vendeve të BP dhe zbulimin e korrelacionit midis tyre. Kjo do të shërbejë si bazë për ekstrapolimën e një vlerësimi gjithëpërfshirës të sigurisë së gjithë rajonit të BP. Qëllimi i dytë është të nxirren përfundime bazuar në një analizë më të gjerë të kuadrit të sigurisë në rajonin e BP dhe të përpiqet të përcaktohet se si kompleksiteti i sigurisë mund të zbutet dhe të transformohet në një komponent funksional për përparimin e rajonit.

Hipoteza është se siguria në rajon është shumë komplekse dhe i nënshtrohet zhvillimeve në kuadër të proceseve transformuese. Përderisa vendet e BP dhe i gjithë rajoni njihen për sigurinë e tyre komplekse, përkeqësimi i sigurisë përmes paqëndrueshmërisë së vazhdueshme të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhen ngushtë me mjedisin e pasigurt e të ndërlikuar të sigurisë rajonale dhe kjo shërben për të kujtuar se siguria dhe zhvillimi janë parakusht për tranzicionin e pakthyesëm, reformat politike dhe zhvillimin ekonomik (cf. Stern dhe Öjendal, 2010). Qëllimi është të përcaktohet se si elementë specifikë në kuadër të proceseve në vazhdim në BP i shtohen kompleksitetit në rritje të sigurisë së rajonit dhe destabilizimit të mundshëm të tij.

Kuadri metodologjik bazohet në dy metoda plotësuese: një analizë e detajuar e burimeve primare dhe dytësore, literatura dhe analiza e të dhënave empirike² e treguesve kryesorë për të vlerësuar gjendjen e vendeve dhe të gjithë rajonit gjatë 25 viteve të fundit në kuadër të proceseve kryesore transformuese. Duke shqyrtuar proceset dhe problematikat, gjithashtu shikojmë sfondin historik të rajonit për një pasqyrim rreth lidhjeve të kaluara shkakësore dhe trashëgiminë e aspekteve historike, politike, ekonomike, kulturore (etnike) apo të sigurisë. Modeli heuristik përdoret për të vlerësuar gjendjen e përgjithshme të sigurisë në BP. Në analizën e fenomeneve (treguesve) në kuadër të mjedisit global të paqartë dhe proceseve komplekse, ky model ndihmon në kryerjen e hulumtimeve të bazuara në analizën e çështjeve me shumë kriterë të të dhënave statistikore, interpretimin si dhe vlerësimin e përdorimit e algoritmeve.³

Rëndësia e këtij studimi qëndron në analizën që synon t'i përgjigjet pyetjes kërkimore nëse vendet e BP janë shtete funksionale dhe efikase, të qëndrueshme dhe të reformuara sa duhet, të sigurta dhe gati për integrimin euroatlantik, apo nëse ato janë të brishta, të paqëndrueshme dhe jo-funksionale. Eksplorimi dhe vlerësimi i kompleksitetit të proceseve dhe problematikave që ndodhin sipas një ko incidence dhe mbivendosje bie shpesh në kurriz të një kuptimi tepër të thjeshtëzuar të rajonit (Jano, 2008). Kompleksiteti rrallë herë është trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe analitike, duke marrë parasysh zhvillimet dhe çështjet e shumta të lidhura në mënyrë të pazgjidshme, së bashku me implikimet e tyre për fusha të ndryshme të shkencave politike. Kjo përpjekje për t'i përmbushur të gjitha këto më sipër, ofron potencialisht një vlerë shtesë hulumtimi për këtë studim.

Në aspektin teorik, teoritë kryesore të marrëdhënieve dhe studimeve ndërkombëtare të sigurisë do të aplikohen për të shpjeguar parimet e përgjithshme që bazohen në konceptet dhe proceset përkatëse, duke lehtësuar kuptimshmërinë e dinamikës dhe marrëdhënieve midis tyre. Kjo do të ofrojë një pamje të plotë të elementëve që kontribuojnë në kompleksitetin e sigurisë të BP dhe hidhet dritë mbi arsyet e shumta të gjendjes aktuale të rajonit.

² Për këtë arsye, përdoren dokumente ligjore, publikime dhe raportet vjetore të BE & NATO, përfshirë vlerësime të zbatimit të reformave së bashku me çështjet e diskutueshme të integriteteve euro-atlantike. Për rishikimin e performancës në indikatorët kyçë, përdoren analiza, figura statistikore, indekse dhe të dhëna.

³ Shiko Kremljak, Z. (2007): A heuristic model of development of capabilities. AARMS LOGISTICS Vol. 6, No. 4 (2007) 705 720. In the method of uncertainty estimation, each problem involving uncertainty and consecutive appearing risk is divided into identified categories and factors of uncertainty.

Është vërejtur se siguria dhe bashkëpunimi rajonal janë dy nga parakushtet më të rëndësishme për paqen dhe prosperitetin e BP.⁴ Duke qenë se siguria e secilit shtet ndërvepron me sigurinë e të tjerëve, siguria është shumë e ndërvarur brenda rajonit (Buzan dhe Ëæver, 2003), duke treguar rëndësinë e dimensionit rajonal në kuptimin e sigurisë në një aspekt më të gjerë. Shteti mbetet aktori kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe një subjekt i analizës së sigurisë.⁵

Pavarësisht dështimit në njohjen e natyrës gjithëpërfshirëse të sigurisë me dimensionet e saj ekonomike, sociale apo të tjera, neorealizmi siguron një pasqyrë logjike duke shpjeguar konceptet dhe marrëdhëniet e qenësishme midis shteteve dhe subjekteve relevante për të kuptuar sfondin historik, proceset dhe çështjet në BP.⁶ Ndërkohë që *realizmi strukturor* është i zbatueshëm për shpjegimin e vazhdimësisë.

Teoria sistemike nuk mund të parashikojë ndryshimin, pasi çdo ndryshim i strukturës duhet të ndodhë në nivel nën-sistemik (brenda vetë njësive, duke parë dinamikën e brendshme të shteteve). Për rrjedhojë, do të përdoret një kombinim i teorive dhe njohurive të nivelit të brendshëm dhe të nivelit të sistemit për të shpjeguar shkaqet e dinamikës së brendshme të njësive, siç janë tendencat etnonacionaliste. Megjithatë, në këtë aspekt ne shkojmë përtej perceptimit të ngushtë neorealist të sigurisë në kuptimin që nuk përfshin dimensionet e tjera të tij dhe largohet nga një qasje më holistike.⁷

⁴ Shiko Ejodus, F. (2011): *Towards the Western Balkans Security Community 2.0. Analysis*. Belgrade: Faculty of Political Science.

⁵ Sipas neorealistëve, bashkëpunimi midis shteteve shoqërohet nga përfitime relative dhe shqetësime nga mashtrimet, kështu "Institucionet ndërkombëtare kanë influencë minimale në sjelljen e shtetit, dhe kështu kanë të bëjnë vetëm pak në promovimin e stabilitetit në botën mbas Luftës së Ftohtë" (Mearsheimer, 1994–5). Shiko gjithashtu Mearsheimer, J. J. (2003): *The Tragedy of Great Power Politics*. New York: W. W. Norton.

⁶ Duke qenë se Shkolla e Kopenhagenit i kushton rëndësi të veçantë aspekteve sociale të sigurisë, ne e plotësojmë kuadrin teorik duke zgjeruar konceptet e sigurisë në sektorë të tjerë të lidhur me sigurinë. Zgjerimi i teorisë nga studimet materialiste e tradicionale të sigurisë, duke përfshirë sektorë jokonvencionalë për të nxjerrë aspekte të tjera, marrëdhënie dhe dinamika me qasjen Eurocentrike në një kontekst të caktuar, konsiderohet si avantazh më shumë se kufizim.

⁷ Ne kemi përdorur qasjen neorealiste të shtetit si një objekt reference të sigurisë si një faktor shtetëror që aplikohet në të dyja proceset, si ato transformuese në vazhdim, edhe integrimet euro-atlantike me aspekte të marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe politikat e jashtme e të sigurisë, ku ai i referohet sferës shtetërore (kombëtare). Shiko Grizold, A. (2001): *Varnostna paradigma v mednarodnih odnosih*, In: Luard, E., *Človek, država in vojna*. Ljubljana: FDV.

Sipas McFaul (2002:2015), dinamikat e një transformimi kompleks nuk mund të kuptohen plotësisht pa përdorur qasje ose paradigma të shumta, pasi nuk ekziston “asnjë teori e vetme e tranzicionit e cila është pranuar në mënyrë universale”. Për Buzan (1991), siguria nuk është vetëm mbijetesa, por ajo gjithashtu përfshin një gamë të konsiderueshme shqetësimesh rreth kushteve të bashkëjetesës. Ndërkohë që koncepti u bë më shumë i larmishëm dhe kompleks, ai ofron një kuadër më të gjerë sigurie që është më holistik dhe i bazuar në nivelet (individuale, shtetërore dhe ndërkombëtare) dhe sektorët (politikë, ushtarakë, ekonomikë, shoqërorë dhe mjedisorë). Ndarazi, këto nuk mund të trajtojnë në mënyrë adekuate çështjet e sigurisë, pasi secila është e lidhur ngushtë dhe në mënyrë komplekse me tjetrën, duke formuar një rrjetë e cila duhet ndryshuar për të kuptuar çdo koncept në mënyrë individuale dhe për të parë se si ndikon mbi të tjerët (*ibid.*).

Kjo qasje gjithëpërfshirëse dhe të kuptuarit e sigurisë kombëtare bashkëkohore nëpërmjet një sigurie më të gjerë, duke mbuluar të gjitha dimensionet e sigurisë brenda të cilave secili sektor ka dimensionin e tij të sigurisë, do të shërbejë si një mjet qendror në dekonstruktimin e elementeve individuale të sigurisë komplekse në BP (cf Stone, 2009).⁸

Në ditët e sotme “siguria” si vlerë politike nuk ka kuptim e pavarur dhe mund të lidhet me sistemet e vlerave individuale ose shoqërore (Brauch, 2011:63). Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, proceset e globalizimit dhe tranzicionit gradual patën nevojë për një rikonceptualizim të sigurisë. Sipas *konstruktivistëve socialë* në marrëdhëniet ndërkombëtare, “siguria” konceptohet si rezultat i procesit të ndërveprimit socio-politik ku vlerat dhe normat shoqërore, identitetet kolektive dhe traditat kulturore janë thelbësore (Adler, 1997, Fearon / Wendt, 2002, Risse, 2003; Wendt, 1992, 1999, cituar në Brauch, 2011: 61). Nga një pikëpamje realiste, siguria objektive arrihet kur rreziqet e paraqitura nga kërcënimet e shumta, sfidat, dobësitë dhe rreziqet shmangen, pengohen, menaxhohen, përballohen, zbuten dhe përshtaten nga individët, grupet shoqërore, organizatat ndërkombëtare, shtetërore, rajonale ose globale. Nga një qasje konstruktiviste shoqërore, siguria arrihet kur perceptimi dhe frika nga 'kërcënimet', 'sfidat', 'dobësitë' dhe 'rreziqet' e sigurisë janë zbutur dhe kapërcyer (*ibid.*). Që nga viti 1990, janë zhvilluar debate të reja midis qasjeve tradicionale, studimeve kritike të sigurisë dhe qasjeve konstruktiviste, të cilat kanë kontribuar në zgjerimin, thellimin dhe sektorializimin e sigurisë.

⁸ Shiko dhe Buzan, B. (1991): *New Patterns of Global Security in the Twenty-first Century*, *International Affairs*, 67 (3), pp. 432–433.

Termi 'Evropa Juglindore' (EJL) përdoret përgjithësisht për të theksuar gjendjen tradicionale të vendeve në rajonin e Evropës Juglindore, duke u fokusuar në Ballkan dhe vendet fqinje. Në këtë studim përdoret termi "Ballkani Perëndimor (BP)", të cilin BE e shpiku për arsye praktike në Konkluzionet e Presidencës të miratuara në Këshillin Evropian të Vjenës (Këshilli Evropian, 1998). Ky term përdoret për ato vende të Ballkanit të cilat ende nuk janë pjesë e BE, por janë në faza të ndryshme të integrimit në BE. Aktualisht, ai përfshin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë, Kosovën⁹, Malin e Zi¹⁰, Serbinë edhe Kroacinë.¹¹

Pas luftës, vendet e reja të Ballkanit Perëndimor fillimisht duhej të trajtonin pasojat e luftës dhe të përfshiheshin në procesin e paqes dhe pajtimit, në vend që të hynin direkt në rrugën e zhvillimit demokratik dhe ekonomik. Shpejt, ndërvarësitë në rritje ekonomike, politike, të sigurisë dhe kulturore ndikuan në autonominë dhe kapacitetet funksionale të shteteve, dhe në këtë mënyrë në proceset në vazhdim të transformimit.

2. Analiza: proceset, treguesit dhe implikimet e tyre të sigurisë

Për qëllime kërkimore, periudha pas Dejtonit do të ndahet në tri procese kryesore transformuese¹²: stabilizimi dhe shtetndërtimi; demokratizimi dhe ndërtimi institucional, dhe integrimet Euro-Atlantike.

⁹ Kosova nuk është anëtar i OKB, prandaj përdorim shtesën 'Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit'.

¹⁰ Në atë kohë, Mali i Zi ishte pjesë e Serbisë, por më vonë, në 2006, fitoi pavarësinë.

¹¹ Edhe pse mbas integrimit të BE në vitin 2013 Kroacia nuk konsiderohet politikisht pjesë e Ballkanit Perëndimor, ajo do adresohet në këtë studim për shkak të rolit të saj në të kaluarën dhe në të tashmen, çështjeve të pazgjidhura dhe efektet në situatën e rajonit.

¹² Të tre proceset kyçe të identifikuara janë pjesë e procesit gjithëpërfshirës transformues të tranzicionit, i cili duhet të sigurohet për të lejuar përparimin në pranimin në BE si një objekt i përfundimtar. Linz dhe Stepan (1996) argumentojnë se ky është rasti kur është arritur marrëveshje e mjaftueshme për procedurat politike për të prodhuar një qeveri të zgjedhur si rezultat i drejtpërdrejtë i votimit të lirë popullor. Që nga fundi i luftës, ka indikacione për një evolucion pozitiv që ka ndryshuar imazhin e rajonit të BP dhe ka zvogëluar disa nga kontradiktat e saj të mëparshme. Nismat rajonale gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në procesin e krijimit të një rajoni më të sigurt dhe më dashamirës evropian. Në BP, aktorët ndërkombëtarë janë angazhuar në të tri proceset: stabilizimi dhe ndërtimi i shtetit, asistencë në tranzicionin demokratik dhe ndërtimin institucional, si dhe përkrahja në pranimin në integrimet euro-atlantike, megjithëse në nivele të ndryshme dhe në mënyra të

Këto procese janë jetike për të kuptuar dhe shpjeguar funksionimin e një shteti të qëndrueshëm demokratik në rrugën e tij të tranzicionit (Jano, 2008) dhe për të vërtetuar kompleksitetin e sigurisë në BP me çështjet dhe dinamikën e tij që reflekton gjendjen aktuale. Bërthama e Ballkanit karakterizohet nga një natyrë tranzitore. Tranzicioni si interval midis shpërbërjes së një regjimi të vjetër dhe instalimit të një regjimi të ri (Kopecky dhe Mudde, 2000) konceptohet si transformim drejt një demokracie pluraliste dhe një ekonomie tregu. Në kuptimin politik, kjo do të thotë një kalim nga sundimi autoritar në një sistem demokratik parlamentar plotësisht pluralist.¹³

Reformat themelore dhe praktikrat e reja juridiko-administrative duhej të zbatoheshin në mënyrë që të kapërcehej trashëgimia institucionale e socializmit. Edhe pse disa nivele të demokracisë dhe reformave ekonomike kishin filluar në fillim të viteve 1990 me dobësimin e sundimit autoritar, është argumentuar se BP ka përjetuar tranzicion më vonë se disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL).¹⁴

Në vlerësimin e ecurisë së tranzicionit politik, theksi vihet në aspektet formale të demokracisë me futjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Në sferën ekonomike, fokusi është në liberalizimin, stabilizimin dhe privatizimin. Në fillim të tranzicionit, politikisht, vendet e Ballkanit Perëndimor konsideroheshin si 'pjesërisht të lira' në krahasim me vendet e EQL, ndërsa nga aspekti i tranzicionit ekonomik, hendeku ishte edhe më i thellë. Zhvillime të tilla shpjegojnë tranzicionin e vonuar të BP (Gligorov, Holzner dhe Landesmann, 2003).

ndryshme. Aktivitetet, fazat dhe sektorët e përfshirjes së tyre varen nga misioni, aftësitë dhe interesat e tyre. Megjithë madhësinë e detyrës që sugjeron nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë, kryesisht prioritetet afatshkurtra kanë formuar përfshirjen ndërkombëtare.

¹³ Transformime të tilla së pari kërkojnë krijimin e institucioneve të reja për të ndarë shtetin nga kontrolli i partisë dhe për të braktisur një model ekonomik (socialist) të planifikuar nga qendra për një ekonomi tregu kapitaliste duke krijuar një hapësirë të vetme ekonomike, duke nxitur rritjen dhe punësimin. Nga aspekti social, kjo ka të bëjë me reformën sociale drejt një shteti të mirëqenies, kohezionit social, një sistemi gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale, një sistemi të qëndrueshëm të pensioneve, bazuar në promovimin e koordinimit të politikave sociale në fusha të ndryshme duke përfshirë përfshirjen sociale, punësimin dhe shëndetin.

¹⁴ Në vlerësimin e tij të tranzicionit, Rupnik ndërton "një pikturë suksesi në vendet e EQL, pengesat e BP". Shiko Rupnik, J. (2000): Eastern Europe: The International Context. *Journal of Democracy*, 11 (2), fq. 115–129.

Identiteti kombëtar si një kusht i domosdoshëm i një shteti liberal demokratik ka munguar në teorinë politike (Canovan, 1996, Kuzio, 2001). Prandaj, sekuenca e duhur e një tranzicioni duhet së pari të jetë shteti dhe krijimi i kombit, së dyti krijimi i një ekonomie tregu dhe së fundmi i një demokracie.¹⁵

Në shtete të pazhvilluara ku vende të reja dalin nga rrënojat e një shteti shumëkombësh, nacionalizmi shpesh bëhet etnik. Në disa vende të Ballkanit Perëndimor, demokratizimi në fazat e hershme shpesh i ka inkurajuar elitat që ndiheshin të kërcënuara të shfrytëzonin nacionalizmin etnik dhe të mbanin shtetet e tyre institucionalisht të dobëta dhe manipuluese (Snyder, 2000). Roeder (1999), tregon se një demokraci e qëndrueshme është arritur vetëm në ato vende post-komuniste që kanë e zgjidhur problemin e nacionalizmit.

Në mungesë të një ideologjie legjitimuese për reforma politike dhe socio-ekonomike, procesi i tranzicionit dështon në mobilizimin e shoqërisë dhe mund të përmbysset nga nacionalizmi etnik. Identiteti kombëtar, uniteti, faktorët politikë dhe socio-ekonomikë janë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme në procesin e tranzicionit dhe prandaj duhet të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, të vlerësuara veçmas, në mënyrë të katërfishtë.¹⁶

Stabilizimi dhe shtetndërtimi, kryesisht i nxitur nga jashtë, u zhvillua më herët, paralelisht, si dhe në të njëjtën kohë me demokratizimin¹⁷. Ky është

¹⁵ Ashtu si shumë vende postkomuniste trashëguan shtete dhe institucione të dobëta, një element i tretë vuri në dukje supozimin se tranzicioni është një tranzicion i dyfishtë i bazuar te regjimi i shtetit të demokratizimit dhe marketizimit. Tranzicioni i trefishtë shihet si i mjaftueshëm për të kuptuar tranzicionet postkomuniste dhe mund të përfshijë edhe çështjet e nacionalitetit. Përshtatshmëria dhe kombësia deri vonë janë neglizhuar si jo-faktorë në tranzicionet e hershme. Ndarja e mëtejshme e çështjeve kombëtare dhe shtetërore, një kornizë e katërfishtë e tranzicionit, është më e përshtatshme për shtetet postkomuniste pasi ndan veçmas gjendjen dhe kombësinë, sepse ato ndikojnë në suksesin e konsolidimit demokratik (Linz dhe Stepan, 1996). Gjithashtu shih Offe, C. (1991): Kapitalizmi me skicim demokratik? Teoria Demokratike përballë tranzicionit të trefishtë në Evropën Qendrore Lindore. *Kërkimi Social*, 58 (4), f. 865-881.

¹⁶ Edhe pse ato dukshëm kontribuojnë në konflikte dhe luajnë një rol vendimtar në funksionimin e shtetit, elementët etno-nacionalë nuk janë siç duhet. Coleman dhe Lawson-Remer (2013) sugjerojnë përjashtimin / përfshirjen socio-ekonomike, politikat ekonomike, shoqërinë civile dhe mediat, sistemin ligjor dhe sundimin e ligjit, strukturën e qeverisë dhe ndarjen e pushtetit, arsimin dhe demografinë.

¹⁷ Stabilizimi nënkupton përpjekjet afatshkurtra të aktorëve ndërkombëtarë për t'i dhënë fund armiqësive dhe për të konsoliduar paqen. Banka Botërore gjithashtu përshkruan rindërtimin si veprime të ndërmarra nga aktorët ndërkombëtarë ose vendorë për të mbështetur dimensionet ekonomike dhe sociale. Stabilizimi dhe rindërtimi përfshijnë aktivitete komplekse në adresimin e kërkesave të shumta dhe të ndryshme, ndërkohë që natyra komplekse e detyrave dhe koordinimit e vë në pikëpyetje efikasitetin e saj dhe ndikimin pozitiv afat-gjatë

problematik dhe shpesh i konceptuar ngushtësisht pasi kompleksiteti i procesit rrjedh nga natyra sektoriale, duke dalluar dimensionet politike, sociale dhe ekonomike, dhe aktorët dhe aktivitetet e shumta në nivele të shumëfishta (Kumar, 1997) që përfshijnë faza të ndryshme me efekte afatshkurtra dhe me përpjekje afatgjata të cilat kërkojnë koordinim dhe kohezion. Suksesi i stabilizimit të shoqërive të shkatërruara nga lufta varet nga mjetet e vlerësimit dhe masa të besueshme pa anashkaluar nxitësit e konfliktit dhe paqëndrueshmërinë. Barriera kryesore për matjen e progresit është politike, ndërsa pretendimet për sukses mund të jenë thjesht artificë politike.

Rezultatet kryesore të stabilizimit përfshijnë qeverisjen dhe pjesëmarrjen, sigurinë, drejtësinë dhe sundimin e ligjit, mirëqenien sociale dhe ekonomike (Cohen, 2006). Rrënjësia e nacionalizmit, mungesa e angazhimit ndëretnik pengoi rindërtimin e rajonit i cili u përkeqësua nga lidhja midis praktikave joformale dhe korrupsionit¹⁸, që manifestohet në shumë fusha me ndikime në kulturën kombëtare, historinë, sistemin politik dhe tranzicionin. Shfaqja e vendeve të reja të Ballkanit Perëndimor koincidon me daljen e një klase të re politike, pa përvojë për të drejtuar dhe miratuar reformat e nevojshme, për të zhvilluar struktura shtetërore, për të menaxhuar pasojat e konfliktit dhe për të siguruar zhvillim demokratik. Megjithatë, është arritur shumë në 25 vitet e fundit, me mbështetjen dhe nxitjen e organizatave ndërkombëtare (BE, OKB, NATO etj.) dhe vendeve të vecanta (Shtetet e Bashkuara dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian).

Tranzicioni nga autoritarizmi në demokraci është i vështirë dhe bën që shumë vende me premtime demokratike të mbahen peng i luftës politike dhe kapjes së pushtetit nga elitat, ose të bllokohen në spiralet e varfërisë dhe papunësisë (Coleman dhe Laëson-Remer, 2013). Demokratizimi¹⁹ ndikohet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, historinë dhe shoqërinë civile. Megjithatë, demokracitë e qëndrueshme jo vetëm kërkojnë ekonomi të shëndoshë dhe të ardhura të larta, por edhe konsensus mbi vlerat dhe besimet kryesore nëpërmjet të cilave komuniteti është i bashkuar. Marrëdhënia

në paqe, stabilitet dhe zhvillim. Shih Colletta, N. J., Samuelsson Schjørlie, J. dhe Berts, H. (2008): Stabilizimi i Përkohshëm Balancimi i Sigurisë dhe Zhvillimit në Ndërtimin e Paqes pas Konfliktit. Sandöverken: Akademia Folke Bernadotte.

¹⁸ Proceset e tranzicionit përfshijnë aspektin kushtetues të tranzicionit demokratik dhe lidhjet ndërmjet demokratizimit, sundimit të ligjit dhe drejtësisë tranzicionale.

¹⁹ Demokratizimi kuptohet këtu si proces i tranzicionit demokratik. Ne bëjmë dallimin midis demokratizimit dhe liberalizimit: ndërsa i pari nënkupton të fundin, është një koncept më i gjerë dhe më politik. Shih Linz, J. J. (1993): Ndërtimi i Shtetit dhe Ndërtimi i Kombit. *European Review*, 1, f. 355-69.

ndërmjet shoqërisë civile dhe identitetit kombëtar qëndron në zemër të procesit të tranzicionit në shtetet post-komuniste.²⁰ Sa më e madhe shkalla e pluralizmit kulturor, gjuhësor dhe fetar në shtetin e pazhvilluar, aq më kompleks do të jetë tranzicioni demokratik (Dahl , Cituar nga Kuzio, 2001). Prandaj, në një mjedis kompleks që përfshin njëherazi ndërmarrjen e reformave politike dhe socio-ekonomike, shpesh brenda një shteti shumëkombësh, ku ndërtimi i institucioneve presupozon një shtet të përbërë nga faktorë socialë dhe etnokulturorë.

Afërsia gjeografike, identiteti kulturor dhe lidhjet ekonomike e bëjnë sigurinë dhe stabilitetin në BP tejet të rëndësishëm për integrimin evropian dhe euroatlantik. Vendet e BP janë zotuar për rrugën e tyre euroatlantike, e cila bazohet në kushte, vlera dhe standarde të përbashkëta që duhen përmbushur përmes reformave politike dhe ekonomike në përputhje me *acquis-in* e BE-së. Zhvendosja e fokusit nga stabilizimi në integrim i ka dhënë përparësi të madhe mbi politikat e mëparshme të menaxhimit të konfliktit. Kushtëzimi i reformave bazuar në llogaritjet afatshkurtra kosto/përfitim, në të cilat shtetet që aspirojnë BE-në i përgjigjen stimujve të saj dhe ripërcaktimit afatgjatë të interesave dhe identiteteve të aktorëve vendas janë dy elementët më të rëndësishëm të ndikimit të BE në BP (Coppiters et al., 2004). Ky ishte një model i suksesshëm në anëtarësimet e fundit në BE dhe NATO, duke theksuar sigurinë si parakusht për një integrim të suksesshëm.

Zbatimi i kuadrit të politikave kërkon përpjekje të mëtejshme në përmbushjen e kërkesave politike, ekonomike dhe ligjore të kriterëve të Kopenhagenit të cilat, pasi të përmbushen, tregojnë gjendjen përfundimtare të tranzicionit demokratik. Në rastin e BP, mund të flitet për integrimin ose procesin e para-anëtarësimi, pasi transformimet aktuale janë efektet e përgatitjes për anëtarësim. Në këtë proces ndërtimi të vendit anëtar, vendet e Ballkanit Perëndimor po pësojnë ndryshime.

Çështja e pikëpyetjes së kapacitetit evropian të rajonit bëhet gjithnjë e më komplekse kur kushtëzimi i BE-së rritet. Kjo tregon mungesën e përpjekjeve të brendshme për reformat, të cilat kanë nevojë për pronësi lokale për t'u bërë të qëndrueshme dhe efikase, në vend që të konsiderohen si të gatshme për anëtarësim. Përkundër të gjitha paqartësive dhe sfidave, është thelbësore që

²⁰ Kjo përfshin një ndjenjë të identitetit kombëtar, besimit të ndërsjellë dhe solidaritetit si një parakusht për arritjen e qëllimeve të përbashkëta politike, siç është drejtësia sociale dhe demokracia. Shpërbërja e shteteve shumëkombëshe çon në përhapjen e identiteteve të shumëfishta të cilat nuk janë të favorshme për integrimin kombëtar dhe shoqërinë civile, veçanërisht në një krizë socio-ekonomike. Shih Miller, cituar nga Kuzio, 2001.

këto procese të bëhen të pakthyeshme.²¹ BP duhet të lërë prapa epokën e “Ballkanizimit” dhe të ndjekë fazën përfundimtare të tranzicionit në një demokraci dhe ekonomi tregu paralelisht me perspektivat e qarta të integritimit në BE.

Brenda këtyre tri proceseve themelore, u identifikuan indikatorët kryesorë për të lehtësuar vlerësimin e situatës politike dhe socio-ekonomike dhe për vlerësimin e vendeve të vencanta të BP dhe implikimet rajonale të sigurisë kundrejt tyre. Në spektrin gjithëpërfshirës, indikatorët e identifikuar në kuadër të proceseve janë këto: a) shteti ligjor (sistemi gjyqësorë, korrupsioni, krimi i organizuar, terrorizmi dhe radikalizmi); b) të drejtat themelore (respektimi i të drejtave të njeriut (shkeljet, diskriminimi), liria e shprehjes dhe media); c) migracioni; d) funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike; e) gjendja ekonomike dhe sociale (PBB-ja, barazia sociale, shkalla e papunësisë); dhe f) bashkëpunimi rajonal (marrëdhëniet fqinjësore, çështjet dypalëshe).

Analiza u përqendrua në matjen e proceseve për të treguar se ku qëndrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e reformave kyçe politike dhe ekonomike dhe çfarë duhet bërë për të adresuar çështjet e mbetura. Metodologjikisht, këto tre procese u analizuan për periudhën e 25 viteve të fundit, që nga shpërbërja e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ). Gjetjet për vendet individuale u përdorën më pas për të bërë një përgjithësim duke ekstrapoluar në mënyrë që të vlerësohej gjendja e të gjithë rajonit të BP: çfarë është arritur dhe ku po shkohet.

Kufizimet e hasura përfshijnë vështirësinë për të vendosur se ku apo kur përfundon një proces dhe kur fillon një tjetër. Për shkak të natyrës së tyre komplekse, është e vështirë t’i dallosh proceset në mënyrë strikte. Prandaj, për arsye analitike, ne i shqyrtuam ato në një afat të vetëm duke vlerësuar të njëjtin grup treguesish në të gjitha proceset. Mbi këtë bazë, është matur ecuria

²¹ Po ashtu, Plani i Veprimit të Anëtarësimit të NATO-s (MAP), i nisur në vitin 1999, ndihmon vendet që aspirojnë për anëtarësimin në NATO në përgatitjet e përshtatura për nevojat e tyre. Pjesëmarrësit në MAP bazuar në progresin e reformave janë Maqedonia, BiH dhe Mali i Zi. Ky i fundit së shpejti do të bëhet anëtar i plotë. Vendet e MAP-it janë të nevojshme për të përbushur kriteret që mbulojnë aspektet politike, ekonomike, të mbrojtjes, burimet, sigurinë dhe aspektet ligjore nëpërmjet një mekanizmi të fokusuar për reagimet mbi progresin e reformave të vendeve, duke përfshirë këshilla dhe vlerësime në bazë të raporteve të progresit. Drejtuesit kryesorë të anëtarësimit në NATO janë konsolidimi i sigurisë, solidariteti dhe mbrojtja kolektive e anëtarëve në bazë të nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut. Shikoni faqen zyrtare të NATO-s. E disponueshme në: http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_37356.htm [Aksesuar më 24 mars 2014].

e këtyre proceseve duke analizuar grupet përkatëse të treguesve dhe duke marrë parasysh gjithashtu që jo të gjitha të dhënat janë në dispozicion, për shkak të pavarësimit të mëvonshëm të disa vendeve, si Mali i Zi që fitoi sovranitetin në vitin 2006 ose Kosova në vitin 2008. Një tjetër kufizim potencial qëndron në procesin e mbledhjes së të dhënave statistikore mbi treguesit specifikë dhe vlerat e tyre nga burime të ndryshme, të cilat bazohen në metodologji të ndryshme - arsyeja është se nuk ekziston një studimi gjithëpërfshirës që shqyrton të gjithë treguesit përkatës që identifikua si të rëndësishëm për analizën tonë.

Ne u përpoqëm ta kapërcejmë këtë çështje duke përdorur metoda të standardizimit ose një model heuristik. Kjo e fundit mund të zbatohet edhe në rastin e indikatorëve të paqëndrueshëm si p.sh. kriza financiare, emigracioni, terrorizmi, Brexit etj., të cilat përshkruajnë proceset dhe fenomenet me implikime të sigurisë, por nuk mund të vëzhgohen dhe maten në analizë. Për shkak se ato kanë ndikim edhe në gjendjen e sigurisë dhe kompleksitetin e saj, variablat ndërhyrës do të përdoren për të vlerësuar ndikimin e këtij segmenti të rëndësishëm si dhe për të shpjeguar lidhjet shkakore midis treguesve ose variablave të tjerë.

Duke synuar një rishikim gjithëpërfshirës të të gjithë treguesve përkatës, jemi të vetëdijshëm se aspektet e mbrojtjes dhe ato ushtarake do të shtonin më shumë njohuri të rëndësishme në kompleksitetin më të gjerë të sigurisë në BP. Sidoqoftë, duhet të fokusohemi në ato që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me proceset dhe efektet e sigurisë në periudhën paqësore të vlerësimit. Për më tepër, të dhënat relevante klasifikohen në kuadër të integritimit euroatlantik të cilat i mbledhin ato në një mënyrë më të pranueshme metodologjike. Pra, paraqitet një pasqyrë kontekstuale e sistemeve të mbrojtjes, sigurisë dhe bashkëpunimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në këtë fushë.

Që nga viti 2003, në Këshillin Evropian të Selanikut, vendet e BP janë cilësuar si kandidatë të mundshëm për anëtarësim në BE. BE thekson se një proces i besueshëm zgjerimi është çelësi i transformimit dhe stabilitetit në BP dhe inkurajon partnerët të tregojnë pronësinë e reformave duke rikonfirmuar mbështetjen për perspektivën evropiane të BP. Politika e zgjerimit vazhdon të japë rezultate dhe reformat po ecin përpara në shumicën e vendeve, megjithëse me shpejtësi të ndryshme (Komisioni Evropian, 2016), dhe në përputhje me kushtëzimin e drejtë dhe parimin e meritës, së bashku me kapacitetin e BE-së për të integruar anëtarë të rinj.

Mali i Zi: Në dhjetor 2011, filloi procesi i anëtarësimit me qëllim hapjen e negociatave. Negociatat filluan në vitin 2012 dhe që prej asaj kohe kanë qenë

në progres. Zgjedhjet parlamentare të tetorit 2016 u zhvilluan me një kuadër ligjor të rishikuar dhe në mënyrë më pjesëmarrëse dhe transparente, u karakterizuan nga respekti i përgjithshëm për liritë themelore. Në axhendën e reformës, kuadri ligjor në fushën e shtetit ligjor është kryesisht i plotë dhe është vendosur formati institucional. Është themeluar një Agjenci e re Anti-Korrupsion dhe është mundësuar Prokuroria Speciale. Sistemi i shtetit ligjor duhet të japë më shumë rezultate. Progresi në këtë fushë, i demonstruar nga rezultate të prekshme sidomos në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe ndjekjet penale dhe dënimet, do të vazhdojë të përcaktojë ritmin e negociatave të anëtarësimit në përgjithësi.

Veprimet duhet të vazhdojnë të ndjekin reformën e administratës publike dhe të forcojnë pavarësinë e institucioneve. Duhet të sigurohet progres në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias. Sa i përket aspekteve ekonomike, pozicioni fiskal i Malit të Zi është përkeqësuar dhe rritja e nivelit të borxhit publik kërcënon qëndrueshmërinë fiskale. Si çështje prioritare, Mali i Zi duhet të kufizojë shpenzimet e tij aktuale dhe të përmirësojë mbledhjen e të ardhurave. Gjithashtu, duhet të stimulojë punësimin, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe industrinë konkurruese të orientuar nga eksporti. Ai vazhdon të luajë një rol pozitiv në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal, avancimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në çështjet e politikës së jashtme. Në dhjetor të vitit 2015, Mali i Zi u ftua për t'u bërë pjesë e NATO-s.²²

Serbia: Në mars të vitit 2012, Serbisë iu dha statusi i vendit kandidat në BE dhe hapi kapitujt e parë të negociatave në dhjetor 2015. Pas zgjedhjeve të parakohshme kombëtare në prill, programi i ri i qeverisë serbe përfshinte integrimin në BE si një qëllim parësor. Serbia ka ndërmarrë hapa të mëdhenj drejt këtij qëllimi, duke çuar në hapjen e katër kapitujve të parë. Ritmi i negociatave do të varet në veçanti nga progresi me sundimin e ligjit dhe normalizimi i marrëdhënieve të saj me Kosovën, në mënyrë që të dyja të mund të vazhdojnë në rrugët e tyre evropiane. Serbia duhet të thellojë angazhimin e saj në dialogun me Kosovën, duke përfshirë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve. Ajo duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për reforma dhe të fokusohet në zbatimin efektiv të reformës gjyqësore, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

²² Shiko Komisionin Evropian (2016): Mali i Zi Raporti i vitit 2016. E disponueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_montenegro.pdf (20. 12. 2016).

Për të garantuar ushtrimin e papenguar të lirisë së shprehjes dhe të medias, mangësitë në këtë fushë duhet të adresohen urgjentisht. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet respektimit të plotë të të drejtave themelore, duke përfshirë mbrojtjen e grupeve më vulnerabël dhe trajtimin jodiskriminues të pakicave kombëtare në të gjithë Serbinë. Nevojitet zbatimi efektiv i dokumenteve strategjike përkatëse.

Progres është arritur me reformën e administratës publike, e cila duhet të vazhdojë së bashku me përparimin e mëtejshëm në pavarësinë e institucioneve demokratike. Reformat ekonomike po prodhojnë rezultate dhe duhet të vijohem me zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale dhe të përmirësohet mjedisi i biznesit, me theks në ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore. Roli udhëheqës i Serbisë në rajon është i rëndësishëm në përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe ruajtjen e stabilitetit. Serbia është e angazhuar në mënyrë konstruktive në bashkëpunimin rajonal dhe inkurajohet të vazhdojë përpjekjet e saj të vazhdueshme për të forcuar marrëdhëniet e mira fqinjësore. Serbia është prekur nga kriza e migracionit dhe ka luajtur një rol aktiv dhe konstruktiv në bashkëpunimin me fqinjët e saj për të menaxhuar rrjedhat e migracionit. Bashkëpunimi i plotë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY) mbetet thelbësore. Serbia duhet të harmonizojë në mënyrë progresive politikat e saj me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së.²³

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Në dhjetor të vitit 2005, asaj iu dha statusi i vendit kandidat në BE dhe në tetor 2009 u rekomandua hapja e negociatave për anëtarësim. Këto kushtëzohen nga vazhdimi i zbatimit të plotë të Marrëveshjes së Përzhdos dhe nga progresi i mjaftueshëm në zbatimin e “prioriteteve urgjente të reformave”. Viti i kaluar ka pasur kriza të vazhdueshme politike. Shqetësimet rreth kapjes së shtetit që ndikojnë në funksionimin e institucioneve demokratike dhe fushave kyçe të shoqërisë vazhdojnë sërisht.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u zhvilluan në frymën e mosbesimit të gjerë publik si në institucionet ashtu edhe në establishmentin politik. Besimi duhet të rikthehet, pasi kriza politike vazhdon të pengojë formimin e qeverisë së re, sepse vendi vazhdon të vuajë nga një mjedis politik përçarës, polarizimi dhe nga mungesa e kulturës së kompromisit, duke bërë kështu hapa prapa në

²³ Shiko Komisionin Evropian (2016): Raporti i Serbisë 2016. E aksesueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_serbia.pdf (20. 12.2016).

aspekte të rëndësishme si p.sh. funksionimi i gjyqësorit, i cili duhet të lejohet të funksionojë në mënyrë të pavarur.

Duhet të mbështeten përpjekjet e Prokurorit Special për llogaridhënie ligjore dhe parlamenti duhet të vendosë përgjegjësi politike për përgjimet dhe përmbajtjen e tyre. Nevojitet progres i konsiderueshëm për zbatimin konkret të reformave për adresimin e çështjeve sistemike të sundimit të ligjit, përfshirë edhe shkeljet e të drejtave themelore, pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e medias, zgjedhjet, korrupsionin dhe politizimin e institucioneve shtetërore. Qeveria e re duhet të urdhërojë urgjentisht reformat e vonuara për ta kthyer vendin në rrugën e tij evropiane.

Shoqëria civile ka luajtur një rol konstruktiv në proceset demokratike. Stabiliteti makroekonomik duhet të ruhet dhe deficitin publik duhet të kontrollohet më rreptësisht. Transparenca dhe zbatimi i shpenzimeve publike duhet të përmirësohen. Duke u bazuar në progresin e fundit në zbatimin e masave për ndërtimin e besimit me Greqinë, kërkohen hapa vendimtarë për të zgjidhur 'çështjen e emrit'. Vendi është prekur nga kriza e migracionit dhe ka bashkëpunuar me vendet fqinje dhe BE në menaxhimin e flukseve të migracionit.

Marrëdhëniet e mira ndëretnike mbeten të rëndësishme dhe shqyrtimi i prapambetur i Marrëveshjes Kuadër të Ohrit duhet të përfundojë së shpejti. Hapat e fundit pozitivë në kontekstin e Marrëveshjes së Përzahos i japin mundësinë udhëheqësve politikë për kapërcimin e krizës së vjetër dhe adresimin e çështjeve sistemike. Në këtë kontekst, ekziston vullneti për të dhënë rekomandimin për të hapur negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë.²⁴

Shqipëria: Në qershor 2014 iu dha statusi i vendit kandidat të BE-së. Rekomandohet të merret në konsideratë hapja e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, në varësi të progresit të besueshëm dhe të prekshëm në zbatimin e reformës gjyqësore. Shqipëria ka vijuar të bëjë progres të qëndrueshëm drejt përmbushjes së të gjitha prioriteteve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Amendamentet kushtetuese kryesore u miratuan në mënyrë unanime në korrik 2016, duke nisur një proces gjithëpërfshirës reformash të sistemit gjyqësor, i cili mbetet kyç për shtetin ligjor dhe gjithashtu mund të

²⁴ Shiko Komisionin Evropian (2016): Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë Raporti i 2016. E disponueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf (20. 12. 2016).

jetë transformues për fusha të tjera. Kjo do të përfshijë një rivlerësim të thellë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Një prirje pozitive vërehet në krijimin e një regjistri të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku Shqipëria duhet të arrijë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme. Mbeten për t'u adresuar niveli i ulët i dënimeve për veprat penale të krimit të organizuar, përfshirë këtu edhe pastrimi i parave dhe rastet e trafikimit të qenieve njerëzore.

I kushtohet vëmendje progresit në luftën kundër radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit. Ekziston nevoja për masa efektive legislative dhe politike për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe politikat kundër diskriminimit, duke përfshirë trajtimin e barabartë të të gjitha pakicave dhe zbatimin efikas të të drejtave pronësore. Reforma e administratës publike po zbatohet në mënyrë të qëndrueshme. Të drejtat themelore vazhdojnë të respektohen gjerësisht në vend. Shqipëria duhet të vazhdojë me reformat që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë dhe adresimin e ekonomisë joformale, përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit dhe investimeve, si dhe të ndjekë në mënyrë rigoroz konsolidimin fiskal.

Dialogu konstruktiv midis qeverisë dhe opozitës mbi reformat mbetet thelbësor për të avancuar axhendën e reformave në dobi të qytetarëve dhe për ta afruar vendin më pranë BE-së. Gjithashtu do të jetë shumë e rëndësishme finalizimi i reformës zgjedhore. Angazhimi konstruktiv i Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal dhe sigurimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore mbeten thelbësore.²⁵

Bosnja dhe Herzegovina (BiH): Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi në qershor 2015. Në shkurt të vitit 2016, Bosnja paraqiti kërkesën për t'iu bashkuar BE-së dhe pret mendimin për këtë. Bosnja është përqendruar në prioritetet që rrjedhin nga procesi i saj i reformave, veçanërisht në axhendën e reformave. Përpjekjet e rëndësishme të reformave të orientuara drejt BE-së duhet të jenë të qëndrueshme në mënyrë që të trajtohen problemet strukturore të rrënjësura thellë që kanë penguar zhvillimin e Bosnjës, duke përfshirë edhe aspektin socio-ekonomik. Mbeten prioritet forcimi i shtetit ligjor dhe i administratës publike në përputhje me standardet e BE-së në të

²⁵ Shiko Komisionin Evropian (2016): Shqipëria Raporti i vitit 2016. E disponueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf (20.12.2016).

gjitha nivelet e qeverisjes dhe përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha niveleve.

Mekanizmi i miratuar i koordinimit mbi çështjet e BE-së duhet të zbatohet për të mundësuar që vendi të përballet me sfidat e procesit të integritit në BE, duke përfshirë edhe miratimin e strategjive të domosdoshme të vendit. Perspektiva e BE-së për Bosnjën janë për një shtet të vetëm, të bashkuar dhe sovran. Zbatimi i vendimit të Sejdić-Finci do të kontribuojë në krijimin e një shoqërie demokratike dhe mirë-funksionale ku barazia e boshnjakëve, serbëve, kroatëve dhe e gjithë qytetarëve të Bosnjës është e garantuar, në përputhje me legjislacionin kundër diskriminimit dhe *acquis-it* të BE. Të gjitha autoritetet e Bosnjës duhet të rrisin përqendrimin e tyre në reformat e qëndrueshme dhe të kapërcejnë retorikën ndarëse të rrënjosur në të kaluarën dhe në mënyrë aktive të promovojnë pajtimin. Është për të ardhur keq që u mbajt referendumi i paligjshëm në nivel entiteti në Ditën e Republikës Srpska. Bosnja duhet të vazhdojë reformat socio-ekonomike duke u përqendruar në reformat e shtetit ligjor, duke përfshirë forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, luftën kundër radikalizmit dhe terrorizmit dhe reformën në administratën publike.

Vërehet mungesa e progresit në lirinë e shprehjes dhe mediave dhe pritjet që BiH të intensifikojë përpjekjet e saj për të adresuar këto çështje. Nevojiten më shumë përpjekje në fushën e mbrojtjes së mjedisit. BE vazhdon të mbështesë me burime të konsiderueshme Bosnjën në kuadrin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe misionin EUFOR/Althea i cili vazhdon të jetë i pranishëm duke u fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin, duke ruajtur mjetet për të kontribuar në kapacitetin parandalues të vendit. BE mbetet e angazhuar në forcimin e sundimit të ligjit në Bosnjë edhe nëpërmjet Zyrës së Përfaqësuesit Special të përforcuar të BE-së dhe Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit.²⁶

Kosova: MSA hyri në fuqi në prill 2016, duke ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse për marrëdhënie më të ngushta politike dhe ekonomike midis BE-së dhe Kosovës. Kosova ka ndërmarrë hapa të mëdha në përmbushjen e kritereve të liberalizimit të vizave, për të lejuar heqjen e kërkesës për vizë, me kusht që Kosova të ratifikojë marrëveshjen kufitare me Malin e Zi dhe të

²⁶ Shiko Komisionin Evropian (2016): Bosnia and Herzegovina Raporti i vitit 2016. E disponueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_bosnia_and_herzegovina.pdf (20. 12. 2016).

forcojë më tej rezultatet e saj në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Janë ndërmarrë hapa për të rritur ndjekjen dhe hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe rasteve të krimit të organizuar. Nevojitet progres i mëtejshëm në forcimin e regjistrimit të dënimeve. Performanca parlamentare është ndikuar negativisht nga pengesa themelore nga partitë e ndryshme politike.

Aktorët politikë duhet të kapërcejnë ngërçin politik të zgjatur dhe të adresojnë sfidat e shumta të reformave në lidhje me sundimin e ligjit, duke përfshirë pavarësinë e gjyqësorit dhe reformat strukturore socio-ekonomike që trajtojnë nivelin e lartë të papunësisë. Një axhendë reformash evropiane është zhvilluar për të ndihmuar zbatimin e nevojshëm të MSA-së. Nevojiten përpjekje më të mëdha për të ndërtuar konsensus në spektrin politik për të avancuar këtë axhendë. Vlerësohet progresi në luftën kundër radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit, por përpjekjet duhet të vazhdojnë.

Kosova i ka përmbushur detyrimet e saj të mbetura ndërkombëtare duke themeluar Dhomat Speciale dhe Prokurorinë Speciale për të hetuar krimet e kryera në konfliktin e Kosovës. Sa i përket reformës në administratën publike, duhet të zbatohen rekrutimet, promovimet dhe shkarkimet bazuar në merita dhe kriteret objektive, veçanërisht në rastin e institucioneve dhe agjencive të pavarura për të siguruar funksionimin e pavarur dhe menaxhimin efektiv. Duhet ndjekur promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në të gjithë Kosovën, duke përfshirë mbrojtjen e plotë të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Duhet të adresohet përfshirja dhe mbrojtja e pakicave, duke përfshirë një mjedis të sigurt dhe të drejtat e tyre pronësore, së bashku me forcimin e kohezionit social.

Reformat ekonomike duhet të synojnë rritje dhe punësim. Në fushën e energjisë, Kosova duhet të rehabilitojë termocentralin A të Kosovës, burimi më i madh i ndotjes në BP. BE kontribuon në stabilitetin e Kosovës përmes përfaqësuesit special në Kosovë dhe misionit të sundimit të ligjit, EULEX. Kosova duhet të thellojë dialogun e saj me Serbinë, duke përfshirë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të vazhdojnë në rrugët e tyre evropiane.²⁷ Progresi në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është parimi thelbësor i MSA-së dhe mbështet zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin midis BE-së dhe Kosovës.

²⁷ Shiko Komisionin Evropian (2016): Kosova Raporti i vitit 2016. E disponueshme te: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (20.12.2016).

Kroacia: Një shtet anëtar i BE që nga viti 2013, po përballet me sfida të shumta, ndër të cilat raporti i progresit të Komisionit thekson nevojën për të përmirësuar performancën e saj ekonomike.²⁸ Kroacia po përjeton disbalanca të mëdha makroekonomike në financat publike dhe taksat; pensionet dhe shëndetësinë; tregun e punës dhe përcaktimin e pagave; administratën publike; ndërmarrjet shtetërore; shërbimet dhe sistemin e drejtësisë; si dhe falimentin dhe sektorin financiar. Është thelbësore të adresohen dobësitë që lidhen me borxhin e lartë publik, të korporatave dhe borxhin e jashtëm në kontekstin e papunësisë së lartë. Progresi i kufizuar është vërejtur në politikat e shpenzimeve dhe taksave, menaxhimin e borxhit publik, reformën e pensioneve dhe në trajtimin e rreziqeve financiare në kujdesin shëndetësor.

Progresi në reformën e sistemit të mbrojtjes sociale dhe politikat e punësimit mbetet i kufizuar, duke përfshirë reformën në administratën publike dhe qeverisjen publike, si dhe në përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Në aspektin politik, një perspektivë më e gjerë kohore tregon se problemet e vërteta me të cilat ballafaqohet Kroacia nuk janë vetëm ekonomike, por shumë më komplekse dhe lidhen me sistemin e vlerave të elitave politike dhe ekonomike. Ato duhet të heqin dorë nga modelet e vjetra të sjelljes si klientelizmi, korrupsioni, përzgjedhja negative në administratën publike, etj.

Prandaj, vlerësimi i fundit i Kroacisë në *EU Justice Scoreboard*²⁹ për efikasitetin dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe sipas studimit të *RAND Europe*³⁰, është shteti i tretë më i korruptuar në BE. Mosndjekja penale e veteranëve të luftës jugosllave tregon mungesën e vullnetit për të dënuar krimet e luftës në territorin e ish-RSFJ-së dhe kështu vë në dyshim respektimin e një gjyqësori të pavarur dhe sundimit të ligjit. Tendencat demografike të pafavorshme së bashku me emigrimin e të rinjve pasqyrojnë mungesën e perspektivës në

²⁸ Komisioni Evropian (2016): Rekomandimi përfundimtar për një Rekomandim të Këshillit në programin e reformës kombëtare të Kroacisë, dhe shpërndarja e një opinioni të Këshillit në programin e konvergencës të Kroacisë në vitin 2016. E disponueshme te:
http://ec.europa.eu/economy_finance/eu/countries/pdf/report2016/croatia_en.pdf;
http://ec.europa.eu/economy_finance/eu/countries/croatia_en.htm (19. 12. 2016).

²⁹ EU Justice Scoreboard (2016): http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/justice_scoreboard_2016_en.pdf (20. 12. 2016).

³⁰ RAND Organization Europe (2016): The Cost of Non-Europe in the Area of Organised Crime and Corruption,
http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/579319/EPRS_STU%282016%29579319_EN.pdf (20. 12. 2016).

vend, e cila po kalon në shovinizëm, intolerancë dhe ksenofobi ndaj pakicave të ndryshme.

Për sa i përket bashkëpunimit rajonal, Kroacia po i thellon në vend që t'i zgjidhë çështjet e hapura me fqinjët e saj, p.sh. çështjet e pazgjidhura kufitare me të gjitha vendet fqinje dhe ka mungesë vullneti për ta bërë këtë. Fushata zgjedhore çoi në përkeqësimin e marrëdhënieve me Serbinë, e cila po përjeton bllokada për hapjen e kapitujve të negociatave me BE. Bashkëpunimi Serbo-Kroat për emigracionin po shkon mirë meqenëse është në interesin e tyre të përbashkët. Megjithatë, Serbia ende përbën një kërcënim për sigurinë e Kroacisë, siç pasqyrohet në “garën e armëve”³¹ dhe lidhjet e ngushta të Serbisë me Rusinë, ndërsa Kroacia si një aleat i NATO-s po bashkëpunon ngushtë me SHBA në fushën ushtarake.

3. Përfundime

Në shqyrtimin e proceseve transformuese gjithëpërfshirëse duke përdorur metoda dhe qasje hulumtimi të shumëllojshme, u identifikuan çështje dhe tendenca të cilat ndikojnë në kompleksitetin e lartë të sigurisë në rajonin e BP dhe kontribuojnë në vonesën e progresit gjatë tranzicionit. Vlerësimi i indikatorëve përkatës tregon implikime të sigurisë në fusha të ndryshme. Si pasojë e identifikimit të shumë shkaqeve, faktorëve, subjekteve dhe aktiviteteve në sektorë dhe nivele të ndryshme, përfshirë bashkëveprimin e tyre, është e pamundur t'i studiosh ata veçmas ose të izoluar.

Prandaj, një shkallë përgjithësimi, jo thjeshtëzimi, është e pashmangshme në kërkimin e një argumentimi sintetik që ka të bëjë me këtë siguri komplekse. Sidoqoftë, bazuar në analizat e indikatorëve politikë, socio-ekonomikë dhe etno-nacionalë midis tre proceseve, u vunë re prirje konvergjente të cilat karakterizojnë të gjithë rajonin. Ato tregojnë se BP mbetet një pikë nevralgjike e sigurisë rajonale, por edhe asaj evropiane pasi efektet sinergjike dhe ndërveprimet e elementëve të ndryshëm midis këtyre proceseve në shtetet e vecanta me potencialin për të destabilizuar jo vetëm situatën e tyre kombëtare por kërcëjnë edhe sigurinë rajonale, të shteteve fqinje dhe të gjithë Evropës. Ndonjëherë, dinamikat simbiotike dhe shkatërruese të këtyre

³¹ Shiko Milketic, S. (2016): Defence Expert Plays Down Croatia-Serbia 'Arms Race'. E disponueshme te: <http://>

www.balkaninsight.com/en/article/croatia-serbia-arms-race-far-from-reality-12-29-2016 (23. 1. 2017).

elementeve midis shteteve të BP kanë nevojë për qasje rajonale më efektive dhe strategjike.

Në përgjithësi, efektet e transformimit afatgjatë për progres politik dhe socio-ekonomik, edhe pse të luhatshëm ose përçarë, korrespondojnë me rritjen e stabilitetit, sigurisë dhe perspektivat si për rajonin ashtu dhe për kontinentin. Pjesa kryesore e kompleksitetit të sigurisë në rajonin e BP në një kontekst më të gjerë evropian dhe global rezulton nga ndikimi i përbashkët i komponentëve individualë që sjellin këtë kompleksitet dhe mund të shkaktojnë një spirale në rënie të zhvillimeve me një efekt potencial destabilizues në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Në mënyrë që të shmanget ky trend dhe të kontribuohet në ndryshimin e tij drejt një rajoni të transformuar e funksional si pjesë e BE-së, kjo e fundit rimerr në fokusin e saj “cështjet thelbësore në fillim” pa kompromis për: respektimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, qeverisjen ekonomike dhe reformën e administratës publike.³² Ndërtimi i një gjyqësori të pavarur dhe institucione demokratike funksionale, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mbrojtja e të drejtave themelore, adresimi i të metave në qeverisjen ekonomike, si dhe konkurrueshmëria, të gjitha janë procese të vështira që marrin kohë. Prandaj Strategjia e Zgjerimit të BE-së përcakton se asnjë shtet i ri nuk do jetë gati për t’u futur në BE gjatë mandatit të Komisionit aktual. Cështjet thelbësore janë një sfidë për të gjithë shtetet në zgjerim dhe shpesh tregojnë se shtete të ndryshme hasin problematika të njëjta.

Gjatë paraqitjes së kontekstit të përgjithshëm të kuadrit kompleks të sigurisë në rajonin e BP, duhet të theksohen dy konkluzione kryesore lidhur me performancën dhe fokusin e përpjekjeve të stabilizimit në rrugën e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt integritimit euroatlantik. Së pari, disa vende të Ballkanit Perëndimor kanë kaluar përmes një rruge të gjatë menaxhimi krizash në protektoratet e evropianizuara (Bosnjë, Kosovë), ndërsa disa të tjerë përmes shtetndërtimit në anëtarësim të plotë në BE dhe / ose në NATO (Kroaci, Shqipëri). Megjithatë, as protektoratet, shtetet e papërfunduara, apo shtetet e pamjaftueshme demokratike nuk mund të integrohen në BE ose në NATO.

³² Shiko Komisionin Evropian (2016): Fjala e Komisionerit Hahn gjatë hapjes së Ditëve të Bashkëpunimit NEAR/DEVCO. E disponueshme te: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/2016/02/20160229_en.htm (11. 7. 2016). Paketa e zgjerimit u adoptua në nëntor për të ofruar një strategji për katër vitet e ardhshme, dhe ofron një metodologji të përforcuar.

Së dyti, përmbushja e kushteve të BE-së si norma të brendshme konsiderohet një arritje e madhe e procesit të tranzicionit dhe një hap drejt zhvillimit të mëtejshëm. Zhvendosja në perceptimin e rolit të BE-së, nga autoritetet suprem për zgjidhje të menjëhershme për problemet e trashëguara, në një partner të vërtetë, tregon përparim. Megjithatë, anëtarësimi në BE duhet të konsiderohet si një mjet dhe jo si një qëllim në vetvete. Sfidat kryesore në qasjen e BE-së ndaj BP dhe arritjet e saj tregojnë qartë kontraste midis qëllimeve të deklaruara dhe zbatimit të tyre. Këtu mund të përmendet 'lodhja' e BE-së nga zgjerimi që plotëson 'lodhjen e anëtarësimi' të BP, siç pasqyrohet në erozionin e mbështetjes popullore për anëtarësimin në BE.

Qasja e përtërirë e BE-së tregon se BP kërkon një rifrymëzim të zgjerimit në vend të kopjimit të strategjisë së aplikuar në EQL. Megjithatë, mospërfillja ende e vazhdueshme e nxitësve etno-nacionalë, të nxitur nga manipulimet e klasave politike për interesat e tyre, po forcohet për shkak të progresit të ngadaltë në zhvillimin ekonomik dhe integrimin euroatlantik. Nëse çështjet e fshehura ndëretnike nuk trajtohen siç duhet me mekanizmat politike dhe socio-ekonomike, apo nuk përmirësojnë bashkëpunimin rajonal, rreziqet për stabilitetin dhe sigurinë në rajon mund të rriten.

Në sintezën e këtij dokumenti, ne mund të nxjerrim disa konkluzione të bazuara në analizë. Këto nxjerrin në pah implikimet e sigurisë në procesin e papërfunduar të tranzicionit dhe ndikimin e treguesve të ndryshëm individualë ose të kombinuar të cilët janë vëzhguar. Ata lënë çështje të hapura dhe sfida të pazgjidhura, secila prej tyre kontribuon pjesërisht në kompleksitetin e sigurisë në rajon.

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të forcuar përqendrimin në reformat themelore në fillim të procesit, në veçanti për shtetin ligjor, të drejtat themelore, zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën, si dhe forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike. Një historik i qëndrueshëm i zbatimit të reformave, që çon në rezultate të prekshme, duhet të themelohet në të gjitha këto fusha.

Së pari, shteti ligjor është një vlerë themelore. Jo vetëm që është në thelbin e procesit të zgjerimit dhe të procesit të MSA, por është edhe themeli i një shteti funksional. Sfidat e rëndësishme vazhdojnë në reformën e gjyqësorit nëse kërkohet të sigurohet një gjyqësor i pavarur, i paanshëm dhe efikas. Në vendet ku ky komponent nuk është në rregull dhe i zbatuar në mënyrë efikase, kuadri i pakompletuar institucional dhe mungesa e mekanizmave të zbatimit të legjislacionit lejojnë hapësirë jo vetëm për korrupsion dhe krimin e

organizuar, por edhe për moszbatimin dhe mungesën e dënimeve. Kjo gjithashtu krijon hapësira për terrorizëm, i cili paraqet sfida të përhershme të sigurisë për të gjithë rajonin dhe BE-në. Bashkëpunimi rajonal i bazuar në masa të forta ligjore dhe operacionale dhe shkëmbimi i informacionit në dimensionin e jashtëm të luftës kundër terrorizmit është vendimtar në luftën kundër luftëtarëve të huaj terroristë, financimi i terrorizmit, lufta dhe parandalimi i radikalizimit, kontrollet kufitare të përforcuara dhe trafiku ilegal i armëve të zjarrit.

Në kontekstin e situatës, veçanërisht në Siri, fakti që luftëtarët e huaj po kthehen në BE dhe BP me shumë gjasa do të paraqesë një kërcënim për sigurinë, veçanërisht në ato vende të Ballkanit Perëndimor ku kuadri institucional i dobët ose gjysmë funksional ende nuk arrin të ofrojë masa efikase. Përpjekje të mëtejshme janë gjithashtu të nevojshme në këtë drejtim për të luftuar krimin e organizuar, veçanërisht në fusha si çmontimi i grupeve të krimit të organizuar, apo luftimi i pastrimit të parave dhe flukseve të parave të paligjshme.

Ekziston një nevojë e fortë për të vazhduar trajtimin e çështjeve të krimeve të brendshme të luftës pa diskriminim, si dhe trajtimin e mosndëshkimit dhe sigurimin e përgjegjesisë, duke përfshirë bashkëpunimin rajonal, bashkëpunimin e plotë dhe mbështetjen për punën e ICTY dhe Dhomave të Specializuara. Çështjet e pazgjidhura duhet të zgjidhen në përputhje me ligjin dhe parimet ndërkombëtare, duke përfshirë Marrëveshjen për Çështjet e Trashëgimisë.

Së dyti, liria e shprehjes dhe medias mbetet një shqetësim serioz, që duhet të trajtohet në mënyrë të vendosur dhe efektive si një çështje prioritare. Dialogu gjithëpërfshirës politik mbetet çelësi për funksionimin e duhur të institucioneve demokratike dhe nevojitet progres i mëtejshëm në reformën e administratës publike, duke përfshirë depolitizimin.

Një rol më i fuqishëm për organizatat e shoqërisë civile është vendimtar. Mbrojtja e të drejtave themelore, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave, si dhe trajtimin jodiskriminues të pakicave kombëtare dhe trajtimi i diskriminimit të grupeve vulnerabël është thelbësor në përpjekjet kundër radikalizimit. Këto duhet të shoqërohen me një situatë të shëndoshë socio-ekonomike, një nivel të lartë të përfshirjes sociale, barazisë dhe perspektivave pozitive jo vetëm për elitat, por edhe për nivelin bazë dhe rininë.

Programet e Reformës Ekonomike për të përmirësuar gradualisht kriteret ekonomike krijojnë kushte për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Reformat ekonomike dhe forcimi i sundimit të ligjit prodhojnë përfitime reciproke përforcuese. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar sfidat e mëdha strukturore dhe për të përmirësuar qeverisjen ekonomike, konkurrencën, klimën e biznesit, klimën e investimeve, rritjen dhe krijimin e vendeve të punës, për të siguruar një të ardhme më të mirë.

Së treti, fenomenet e fundit me implikime për sigurinë si p.sh. emigracioni masiv, ka kontribuar në rritjen e trafikut të paligjshëm dhe kështu bëhen burim i qëndrueshëm i të ardhurave për trafikantët. Kjo ka efekte negative të shumta për stabilitetin dhe sigurinë në rajon, duke përfshirë lidhjen me terrorizmin dhe kthimin e luftëtarëve të huaj. Prandaj, nevojiten veprime të mëtejshme për të siguruar kapacitetet administrative dhe zbatuese në vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e migracionit ballkanik për të luftuar trafikimin e emigrantëve.

Në këtë këndvështrim dhe në përgjithësi, bashkëpunimi më i mirë rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë elemente thelbësore jo vetëm të integritit në BE dhe të Procesit të MSA, por edhe për sigurinë rajonale. Në mungesë të tij, vakuumi në bashkëpunim po plotësohet nga aktorë të tjerë me interesa të veçanta, duke rezultuar në efekte shkatërruese që forcojnë vektorët destabilizues dhe dobësojnë axhendat integruese. Sidoqoftë, ka disa zhvillime pozitive në bashkëpunimin rajonal në BP, sidomos koordinimi konstruktiv në menaxhimin e fluksit të emigracionit dhe progresin me ndërlidhshmërinë brenda rajonit dhe me BE-në, duke përfshirë përpjekjet për të rritur koherencën midis nismave të ndryshme rajonale. Bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës inkurajon po ashtu përpjekje të mëtejshme për kapërcimin e trashëgimisë së të kaluarës dhe nxitjen e pajtimit, duke përfshirë promovimin e një klime tolerance.

Së katërti, bazuar në vlerësimin e treguesve, të gjitha këto tregojnë se në 25 vitet e fundit proceset e stabilizimit, demokratizimit dhe perspektivës së integritit kanë sjellë gradualisht siguri, stabilitet dhe prosperitet më të madh në BP. Sidoqoftë, fenomenet e brendshme dhe të jashtme si pasojë e globalizimit, si kriza financiare dhe ekonomike, migracioni, terrorizmi dhe radikalizmi, të cilët kanë ndikuar negativisht jo vetëm në marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu kanë thelluar kompleksitetin e sigurisë në rajon duke e bërë atë të paqëndrueshme. Më tej, pavarësisht përshtypjes së jashtme se destabilizimi i mundshëm dhe çështjet e sigurisë nuk mund të jenë një skenar i mundshëm, një ngjarje në dukje e parëndësishme mund ta çojë rajonin në situatën kur ndërhyrja e huaj e sigurisë

është e nevojshme dhe të provojë se bashkësia ndërkombëtare nuk është në gjendje të mësojë nga përvojat e kaluara.

Situata e brendshme dhe e përgjithshme politike dhe marrëdhëniet midis vendeve të BP mbeten të ndjeshme. Vendet e mbetura në një vakum ka të ngjarë të bien në paqëndrueshmëri. Ndërsa nga jashtë situata mund të duket e qëndrueshme, rrethanat aktuale janë jashtëzakonisht të brishta. Përkeqësimi i marrëdhënieve të fqinjësisë, çështjet e migrimit dhe kërcënimet e vazhdueshme të sulmeve terroriste e mbështesin këtë argument. Një tjetër element shqetësues është prania dhe ndërhyrja në rritje e aktorëve të fuqishëm (globalë) dhe axhendat e tyre në rajon, të cilat nuk janë domosdoshmërisht në përputhje me axhendën euro-atlantike të BP.

Kjo është arsyeja pse nevojitet një qasje proaktive e vazhdueshme nga ana e BE-së. Prandaj, interesi strategjik i BE-së është që procesi i zgjerimit të mos ketë alternativë. Megjithatë, BE-së i mungon një qasje strategjike në rajon. Mund të jetë që një kuadër gjithëpërfshirës dhe vlerësues të tregojë se vetë zgjerimi nuk mund të bazohet në qasjen e modelit të paketave, pasi vendet po përparojnë me reformat me shpejtësi të ndryshme.

Shtypa e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar me BE qëndron në afërsinë gjeografike, mbështetjen për progresin dhe stabilitetin, ndërsa integrimi i tyre është një mekanizëm i rëndësishëm i procesit të qëndrueshëm të reformave, ndërtimit të institucioneve dhe promovimit të normave dhe standardeve të BE-së. Nismat rajonale kanë potencial të madh në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve. Bashkëpunimi rajonal duhet të promovohet vazhdimisht, ndërsa BE dhe vendet e saj anëtare duhet të mbeten të angazhuara në mënyrë aktive në rajon.

Së pesti, përparimi në rrugën e negociatave duhet të jetë dinamik. Kjo është e rëndësishme për Malin e Zi dhe Serbinë, si dhe për vendet e tjera që presin të fillojnë negociatat. Shqipëria po pret afatin kohor lidhur me diskutimin në lidhje me rekomandimin për hapjen e negociatave me një progres të besueshëm dhe të prekshëm në zbatimin e reformës gjyqësore. Ekziston një nevojë strategjike për të zgjidhur krizën në Maqedoni. BE duhet të shtyjë vendin drejt përparimit. Çështja më e rëndësishme aktualisht është stabilizimi i situatës politike pas zgjedhjeve të fundit, formimi i qeverisë dhe ndjekja e reformave. Duhet të sigurohet diskutimi mbi progresin, ndërsa zbatimi i marrëveshjes së Përzihinos, veçanërisht puna dhe mandati i prokurorit special, nuk duhet të neglizhohet.

Një hap përpara është bërë nga Bosnja. Momenti duhet të ruhet deri në pritje të avis-it. Pas referendumit dhe zgjedhjeve lokale, është e rëndësishme të këmbëngulet për shtetin ligjor, duke përfshirë respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sipas procedurave të duhura ligjore. Lidhur me Kosovën, liberalizimi i vizave dhe zbatimi i plotë i MSA-së me fokus në axhendën socio-ekonomike do të jenë hapa të rëndësishëm. Në të njëjtën kohë, nuk ka dyshim se Kosova duhet të përmbushë detyrimet e saj (ratifikimin e marrëveshjes kufitare me Malin e Zi, Dialogun Beograd-Prishtinë). Ky i fundit mund të shkojë në një bllokim nëse nuk ka angazhim të nivelit të lartë nga BE, e cila duhet të jetë më aktive, sepse roli i saj është të ndërmjetësojë, edhe nëse rezultatet nuk dalin menjëherë.

Së gjashti, procesi i stabilizimit dhe transformimit të BP ende nuk është arritur. Në këtë kuptim, integrimi euroatlantik i BP mbetet i papërfunduar, duke sfiduar kështu sigurinë dhe stabilitetin në Evropë. Me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, bazuar në programet e reformave të besueshme dhe zbatimin e tyre nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ata duhet të bëjnë pjesën e tyre dhe të marrin përgjegjësi për stabilitetin. Ndryshimi i secilit vend nga roli i një konsumatori të sigurisë tek një ogjenerues i sigurisë është vendimtar për paqen, begatinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit. Perspektiva euroatlantike nënkupton jo vetëm anëtarësimin në BE dhe NATO, por kryesisht aplikimin e të dy modeleve.

Si modeli më i mirë i mundshëm për tranzicionin, sipas Rupnik (2010), ato lejojnë që vendi aplikues në kohën më të shkurtër të ndërtojë institucione të qëndrueshme demokratike dhe një ekonomi tregu funksionale e bazuar në reformat strukturore, mbështetur nga asistenca dhe mekanizmat e ekuilibruara. Megjithatë, reformat në kuadër të procesit të integritimit duhet të perceptohen si një shtetndërtim i brendshëm i vendit dhe jo si një kërkesë e pranimit të jashtëm për të përfunduar transformimin.

Ruajtja e paqes dhe stabilitetit në rajon së bashku me stimujt për vendet e Ballkanit Perëndimor për të mbajtur dinamikën e reformave dhe për të vazhduar zgjidhjen e çështjeve të tyre të hapura dypalëshe mbeten në qendër të nismave të fundit ndërkombëtare për rajonin. Me sa duket, rajoni ka bërë përparime të konsiderueshme për stabilitetin, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe në modernizimin e qeverisë, shoqërisë dhe ekonomisë.³³ Megjithatë, nëse

³³ Shiko Deklaratën Përfundimtare të konferencës së Ballkanit Perëndimor në Berlin, 28 gusht 2014. E disponueshme te: https://www.auswaertigesamt.de/sid_1E5FFCD93D2ADF799424D7172E83601D/EN/Europa/

rritja e kompleksitetit të sigurisë në BP nuk zbutet nga progresi i integritit të rajonit në BE, kjo e fundit mund të lodhet dhe të rishikojë angazhimin e saj në rajonin e BP, duke i lënë kështu proceset e tranzicionit dhe ribashkimit të papërfunduara - si pika më e dobët në stabilitetin e Evropës dhe të sigurisë.

Bibliografia

- Brauch, H. G. (2011): Concepts of Security Threats, Challenges, Vulnerabilities and Risks. In H. G. Brauch, U. Oswald Spring, C. Mesjasz, J. Grin, P. Kameri-Mbote, B. Chourou, P. Dunay, J. Birkmann (eds.), Coping with Global Environmental Change, Disasters and Security Threats, Challenges, Vulnerabilities and Risks, 61–106. Vol 5 of the Hexagon Series on Human and Environmental Security and Peace.
- Buzan, B. (1991): People, States and Fear: An Agenda For International Security Studies in the Post-Cold War Era. 2nd edition, 1991. Hertfordshire: Harvester Wheatsheaf.
- Buzan, B. and O. Wæver (2003): Regions and Powers: The Structure of International Security. Cambridge: Cambridge University Press.
- Canovan, M. (1996): Nationhood and Political Theory. Cheltenham: Edward Elgar.
- Cohen, C. (2006): Measuring Progress in Stabilization and Reconstruction. Stabilization and Reconstruction Series. No. 1, Washington, DC: United States Institute of Peace.
- Coleman, I. and Lawson-Remer, T. (eds.) (2013): Pathways to Freedom: Political and Economic Lessons from Democratic Transitions. Washington, DC: Council on Foreign Relations Press.
- Coppitiers, B. et al. (2004): Europeanization and Conflict Resolution: Case Studies from the European Periphery. Ghent: Academia Press.
- European Commission (2016): 2016 Communication on EU Enlargement Policy. Accessible at http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_strategy_paper_en.pdf (21. 11. 2016).
- European Council (1998): Presidency Conclusions and Annexes. Vienna European Council, 11 and 12 December 1998. Accessible at http://www.europarl.europa.eu/summits/wie1_en.htm (21. 11. 2016).
- Gligorov, V., M. Holzner and M. Landesmann (2003): Prospects for Further (South) Eastern EU Enlargement: From Divergence to Convergence? Vienna: Global Development Network Southeast Europe.

WestlicherBalkan/AktuelleArtikel/140828Abschlusserkl_Konf_Westl_Balkan.html?nn=474202(31. 8. 2014).

- Grizold, A. (2015): Svet na prelomu. Ljubljana: Založba FDV.
- Jano, D. (2008): From “Balkanization” to “Europeanization”: The Stages of Western Balkans Complex Transformations. *L’Europe en formation*, 3 (349–350): 55–69.
- Kopecky, P. and C. Mudde (2000): What has Eastern Europe Taught Us about the Democratisation Literature (and Vice Versa)? *European Journal of Political Research*, 37 (4): 517–539.
- Kumar, K. (1997): The Nature and Focus of International Assistance for Rebuilding War-Torn Societies. In Krishna Kumar (ed.): *Rebuilding Societies after Civil War: Critical Roles for International Assistance*. Boulder, London: Lynne Rienner Publishers.
- Kuzio, T. (2001): Transition in Post-Communist States: Triple or Quadruple? *Politics*, 21 (3): 168–177.
- Linz, J. J. and A. Stepan (1996): *Problems of Democratic Transition and Consolidation. Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*. Baltimore: Johns Hopkins University Press.
- Luard, E. (uvodni študiji: Simoniti, I. in A. Grizold) (2001). *Človek, država in vojna*. Ljubljana: Založba FDV.
- McFaul, M. (2002): The Fourth Wave of Democracy and Dictatorship: Non-cooperative Transitions in the Post-communist World. *World Politics*, 54 (2): 212–244.
- Mearsheimer, J. (1994–95): The False Promise of International Institutions. *International Security*, 19 (3): 5–49.
- Roeder, P. G. (1999): Peoples and States after the 1989: The Political Costs of Incomplete National Revolutions. *Slavic Review*, 58 (4): 854–881.
- Rupnik, J. (2010): Reassessing European Challenges in the Balkans. *European Perspectives– Journal on European Perspectives of the Western Balkans*, 2 (2): 7–12.
- Snyder, J. (2000): *From Voting to Violence. Democratization and Nationalist Conflict*. New York: W.W. Norton.
- Stern, M. and J. Öjendal, J. (2010): Mapping the Security–Development Nexus: Conflict, Complexity, Cacophony, Convergence? *Security Dialogue*, 41 (2): 5–30.
- Stone, M. (2009): *Security According to Buzan: A Comprehensive Security Analysis*. Security Discussion papers series 1. Spring 2009, Sciences PO – Paris, France. Columbia University, School of International and Public Affairs: New York, USA.

VËSHTRIM MBI TREGUN E SHËRBIMEVE PRIVATE TË SIGURISË NË SHQIPËRI QË NGA MIRATIMI I LIGJIT PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE NË 2014

Arjan Dyrmishi

1. Përmbledhje Ekzekutive

Në vitin 2014 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri për shërbimet private të sigurisë fizike. Ligji synonte të rregullonte veprimtarinë e shoqërive privatë të sigurisë (SHPS) duke përcaktuar: (1) kontrollin dhe licencimin e SHPS-ve dhe personelit të tyre, (2) rregullat e sjelljes së SHPS-ve, detyrimet kontraktuale si dhe realizimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes, (3) detyrimet administrative dhe ligjore, trajnimin dhe përdorimin e armëve dhe forcës.

Ligji i ri shfuqizoi ligjin ekzistues të miratuar në vitin 2001 me qëllim reflektimin e zhvillimeve dhe dinamikave në fushat e tregut dhe atë ligjor por edhe për të ofruar një kuadër më të mirë rregullator për tregun që po rritej vazhdimisht, rritje që nuk ishte shoqëruar nga rritja e cilësisë në ofrimin e shërbimit.

Me qëllim krijimin e kushteve për një treg më të gjallë privat të sigurisë, ligji hoqi një sërë pengesash ligjore që dëmtonin konkurrencën dhe pengonin rritjen e investimeve të SHPS-ve si dhe e hapi tregun shqiptar për operatorët ndërkombëtarë. Përveç kësaj, si mjet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve duke u bërë të mundur SHPS-të të rekrutonin dhe të mbanin një fuqi punëtore më cilësore dhe më të motivuar, ligji përcaktoi një pagë minimale prej 50% më të lartë se paga minimale kombëtare për rojet private të sigurisë. Ligji u miratua si pjesë e një reforme më të gjerë policore dhe administrative që synonte përmirësimin e sigurisë publike dhe siguronte një kontroll më të mirë të territorit.

Megjithatë, në periudhën prej dy vjet e gjysmë që nga miratimi i ligjit nuk ka pasur ndryshime të mëdha apo përmirësime në pothuajse asnjë nga fushat që ligji synonte të trajtonte.

Në fushën e trajnimit dhe certifikimit të personelit nuk ka pasur aspak progres. Qendrat private të trajnimit nuk kanë filluar të funksionojnë ende duke bllokuar kështu rrugën për certifikimin e rreth 8,000 punonjësve.

Po ashtu, ligji nuk ka sjellë ndonjë përmirësim të dukshëm në fuqinë punëtore dhe motivimin e saj, siç evidentohet në një disa ngjarje të mëdha ku rojet private të sigurisë nuk përmbushën detyrimet e tyre profesionale në parandalimin e këtyre ngjarjeve të bujshme. Edhe pse raste të tilla mund të mos shërbejnë si element përgjithësues për të gjithë fuqinë punëtore në tregun e sigurisë private, ligji në vetvete në përgjithësi nuk ka mundur të sjellë përmirësimin e pagës dhe kushteve të punës për rojet e sigurisë private. Ministri i Brendshëm pranoi kohët e fundit se rojet e sigurisë private marrin gjysmën e pagës që duhet të merrnin dhe i ngjajnë më shumë “një ushtri skllevërih”.

Ligji ka dështuar edhe në përmirësimin e konkurrencës, rrjedhimisht, në përmirësimin e shërbimeve. Problemet me prokurimet publike tregojnë se SHPS-të mbështeten vetëm tek ulja e vazhdueshme e çmimeve të shërbimeve të tyre teksa përballen me një detyrë thuajse të pamundur për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale pas fitimit të tenderëve pa iu kthyer shkeljeve të kodit dhe standardeve të punës.

Kjo klimë pasigurie ka penguar investime serioze në burimet njerëzore, infrastrukturën dhe logjistikën, të cilat, siç tregohet edhe nga ngjarjet e fundit, kanë minuar performancën e tyre dhe besimin e konsumatorëve dhe të publikut.

Duke pasur parasysh sa më sipër, nevojitet një diskutim serioz për të kuptuar më mirë shkaqet e tendencave të tilla dhe me pjesëmarrjen e përfshirjen e të gjitha institucioneve përkatëse dhe aktorëve kryesorë për të punuar në drejtim të përmirësimit të situatës.

2. Hyrje

Në këtë dokument analizohen tendencat e tregut të sigurisë private në Shqipëri që nga miratimi i Ligjit për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike në 2014.¹

Kjo kumtesë (dokument) synon të shërbejë si një platformë diskutimi mes shoqërive private të sigurisë dhe institucioneve përgjegjëse për kontrollin dhe

¹ Në këtë dokument do t'i referohemi si Ligji 75/2014

mbikëqyrjen e tyre si dhe me aktorë dhe palë të tjera të interesuara, si klientë që blejnë shërbimet e sigurisë private, donatorë, media dhe organizata të shoqërisë civile.

Ky dokument fokusohet kryesisht në analizën e Ligjit 75/2014 dhe objektivin e tij politik si dhe në analizën e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse dhe media dhe që mundësojnë vlerësimin e zbatimit të tij.

Ky dokument ka këtë strukturë: në seksionin tjetër jepet një panoramë e përgjithshme e kontekstit në të cilin u miratua ligji i ri, objektivat e tij politikë dhe mjetet ligjore për arritjen e këtyre objektivave. Në seksionin e mëpashtëm analizohet zbatimi i ligjit deri tani dhe niveli i arritjes së objektivave të përcaktuara. Në pjesën e fundit jepen disa përfundime e rekomandime.

Ky dokument është një kontribut në kuadër të Projektit të Bashkëpunimit për Kërkimet në Sigurinë Private në Evropën Juglindore, objektiva të të cilit janë identifikimi i mangësive dhe sfidave në kuadrin rregullator, rritja e ndërgjegjësimit për mangësitë dhe problemet e identifikuara dhe angazhimi në diskutime të bazuara në të dhëna e informacione me qëllim që t'i përgatiten sa më mirë për trajtimin e këtyre mangësive dhe problemeve.²

3. Ligji 75/2014 dhe objektivat e tij politikë

Ligji për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike u miratua në vitin 2014 n kuadër të një reforme të gjerë të ndërmarrë nga qeveria e re që kishte marrë pushtetin një vit më parë dhe që synonte të ushtronte një kontroll më të fortë në territor dhe të përmirësonte sigurinë publike.

Në mënyrë më specifike, Ligji 75/2014 synonte të pasqyronte kërkesat që lindën nga zbatimi i ligjit të ri për policinë;³ nevoja për të harmonizuar ligjin me ndryshimet që kishin ndodhur në fushën e legjislacionit në periudhën që nga viti 2001, vit kur ishte miratuar edhe ligji për shërbimet e sigurisë

² Për më shumë informacion për këtë projekt, vizitoni: <http://www.ppps.dcaf.ch/en/private-security-research-collaboration-southeast-europe-2014-2017>

³ Ligji Nr. 108/2014, datë 31.7.2014, "Për Policinë e Shtetit"

private⁴, përfshirë përafrimin e tij me legjislacionin evropian; dhe më shumë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.⁵

Për të përbushur objektivat e përcaktuara të politikës, Ligji 75/2014 përcaktonte një sërë dispozitash, mes të cilave:

- Përmirësimi i kriterëve dhe standardeve në lidhje me aftësitë profesionale që duhet të ketë aplikanti (shoqëritë, administratorët, drejtorët teknikë, rojet) për të marrë licencë;
- Përmirësimi i procedurave të verifikimit dhe kontrollit të personelit të SHPS-ve, përfshirë aksesin tek të dhënat fizike e elektronike që kanë të gjitha institucionet shtetërore;
- Licencimin e qendrave private të trajnimit për rojet dhe personelin e sigurisë private
- Detyrimi për t'u paguar rojeve të sigurisë private dhe personelit përkatës një pagë minimale 50% më të lartë se paga minimale zyrtare kombëtare
- Ndalimin e dhënies me kontratë të këtij shërbimi nga një kompani tek tjetra me synim përmirësimin e kontrollit dhe përgjegjësisë për përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata;
- Përmirësimi i procedurave të mbajtjes dhe përdorimit të armëve dhe forcës gjatë veprimtarive të tyre;
- Sigurimi i kriterëve dhe kushteve për përbushjen e detyrueshme të qendrës së komandës dhe kontrollit;
- Përmirësimi i kriterëve, kushteve dhe specifikimeve teknike për mbajtjen, licencimin dhe përdorimin e autobindave;
- E drejta e shtetasve të huaj për të krijuar një SHPS në Shqipëri dhe për t'u punësuar në sektorin e sigurisë private në Shqipëri;
- Ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.⁶

Po ashtu, me qëllim rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, Ligji 75/2014 hoqi kufizimet në fushën e veprimit (brenda rrethit ku është licencuar shoqëria) dhe për një numër punonjësish dhe armësh.⁷

⁴ Ligji Nr. 8770, datë 19.4.2001, "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike" (në këtë dokument do t'i referohemi si Ligji 8770/2001)

⁵ Kuvendi i Shqipërisë. "Relacion Për Projektligjin "për shërbimin privat të sigurisë fizike". https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/11/rel_sig_fizike_17460_1.pdf.

⁶ Kuvendi i Shqipërisë. "Relacion Për Projektligjin "për shërbimin privat të sigurisë fizike". https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/11/rel_sig_fizike_17460_1.pdf.

⁷ Arjan Dyrmishi dhe Gentiola Madhi. "Shqipëria", tek Franziska Klopfer dhe Nelleke van Amstel (Eds.) 'Siguria Private në Praktikë: Studime rasti nga Evropa Juglindore. DCAF, Beograd/Gjenevë 2015

4. Zbatimi i ligjit: rezultate dhe probleme

4.1 Ndikimi i ligjit në strukturën e tregut

Pavarësisht zhvillimit në përgjithësi të tregut të sigurisë private në Shqipëri, që nga krijimi i ekonomisë së tregut të lirë në vitin 1991, SHPS-të mbetën përgjithësisht të vogla, me deri në 200 punonjës, dhe kishin vështirësi në hartimin e planeve për investime afatgjate në burimet njerëzore, infrastrukturë dhe logjistikë. Kjo vinte kryesisht për shkak të kufizimeve ligjore në fushën e veprimit, numrit të punonjësve dhe armëve.⁸

Miratimi i ligjit u shoqërua me një rritje të tarifave, me dyfishin ose trefishin e atyre ekzistuese, për licencat e lëshuara për shoqëritë, drejtorët teknikë, punonjësit dhe automjetet e blinduara, si dhe tarifat e trajnimit.⁹

Heqja e pengesave ligjore dhe vendosja e tarifave më të larta pritej të ndryshonin strukturën e tregut duke larguar shoqëritë më pak konkurruese dhe duke u mundësuar atyre që punonin mirë të rriteshin edhe më shumë.

Në fakt, shumë pak ndryshime janë vënë re për sa i përket numrit të SHPS-ve që veprojnë në treg dhe numrit të punonjësve. Aktualisht në Shqipëri janë të regjistruara 236 SHPS. Nga këto, 22 SHPS ofrojnë shërbime të sigurisë fizike dhe transport të sigurt të vlerave monetare dhe materialeve e sendeve të çmuara. Në këtë sektor punojnë 8,934 punonjës (Grafiku 1) që u ofrojnë shërbime të sigurisë private 2,721 subjekte publike dhe private.¹⁰

Në grafik vihet re se ka pasur fare pak ndryshime në numrin e SHPS-ve dhe të punonjësve në periudhën që nga miratimi i ligjit, që do të thotë se ndikimi i ligjit në lidhje me strukturën e tregut ka qenë i papërfillshëm.

Gjithsesi, këto shifra mund të mos japin të gjithë panoramën, sepse ka edhe disa shoqëri që nuk marrin pjesë aq aktivisht në treg. Aktualisht, këto shoqëri që vazhdojnë të mbijetojnë duke ofruar shërbime vetëm për një kontraktor apo

⁸ Arjan Dyrmishi and Gentiola Madhi. "Shqipëria", tek Franziska Klopfer dhe Nelleke van Amstel (Eds.) 'Siguria Private në Praktikë: Studime rasti nga Evropa Juglindore. DCAF, Beograd/Gjenevë 2015

⁹ Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Financave nr. 345, datë 24.6.2015. "Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifat financiare për veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike"

¹⁰ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 16 mars 2017.

shoqëri të tjera të cilat qëndrojnë zyrtarisht aktivë me qëllimin e vetëm për të përdorur licencën për të pasur të drejtën ligjor për mbajtjen e armëve.¹¹



Grafiku 1. Numri i shoqërive të sigurisë private dhe numri i punonjësve në 2015 dhe 2017¹²

4.2 Trajnimi dhe certifikimi

Një nga risitë e ligjit 75/2014 ishte decentralizimi i trajnimit, që deri në vitin 2014 kishte qenë monopol i shtetit, duke përcaktuar ngritjen e qendrave private të trajnimit sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit. Ligji e kufizon rolin e Akademisë së Policisë në miratimin e programeve që do të mësohen nga qendrat private të trajnimit dhe në funksionet e inspektimit dhe kontrollit.

Praktikisht, edhe pse ligji përcaktonte se trajnimi në qendrat private të trajnimit të fillonte gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, nuk është bërë asnjë progres me licencimin dhe funksionimin e këtyre qendrave të trajnimit për shkak të mungesës së harmonizimit të Ligjit 75/2014 me aktet nënligjore për licencat dhe lejet.¹³

¹¹ Ministri i Brendshëm. “Siguria publike: 1 muaj afat për standarde sigurie të Policisë Private, nisur nga burimet njerëzore”. 8 shkurt 2017. <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/siguria-publike-1-muaj-afat-per-standarde-sigurie-te-policise-private-nisur-nga-burimet-njerezore>

¹² Grafiku është përpiluar me të dhëna që janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 16 mars 2017 dhe nga botimi “ Një Force për gjithmonë? Përcaktimi i peizazhit të sigurisë private në Evropën Juglindore”, DCAF 2015

¹³ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 16 mars 2017.

Si rezultat, në periudhën që nga miratimi i ligjit vetëm 900 punonjës të rinj janë licencuar nga Akademia e Policisë, ndërkohë që procesi i certifikimit për pjesën e mbetur prej 8,000 punonjësish nuk ka nisur ende.¹⁴ Sipas Ministrit të Brendshëm, ka raste kur rojet private as nuk përmbushin kriteret për punësim në këto shoqëri.¹⁵

4.3 Pagat dhe të drejtat e punës

Një tjetër risi e rëndësishme e Ligjit 75/2014 ishte rritja e detyrueshme e pagave për rojet private të sigurisë me 50% të pagës minimale zyrtare kombëtare. Sipas kësaj dispozite, asnjë roje private nuk duhet të marrë më pak se 31,500 lekë në muaj. Me objektivin për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve, kjo dispozitë synon ta bëjë këtë sektor më tërheqës për një fuqi punëtore më të kualifikuar dhe më të motivuar.

Megjithatë, zbatimi në praktikë i kësaj kërkesë të ligjit ka dalë si një nga problemet kryesore të tij deri tani. Në fazën fillestare të zbatimit të ligjit ishte e paqartë për autoritetet e kontrollit se si të trajtoheshin kontratat që ishin lidhur para miratimit të ligjit. Paqartësia në interpretimin ligjor të kësaj klauzole çoi në rritje të numrit të ankesave nga punonjësit e sektorit dhe një numër i madh i tyre u pushuan nga puna pas mosmarrëveshjeve në punë.¹⁶ Por situata nuk u përmirësua në fazën e mëvonshme. Pagat e paguara për rojet private të sigurisë ishin 20,000 - 22,000 lekë, që është afër pagës minimale pa 50% mbi të, apo edhe më pak 15,000 - 18,000 lekë, sipas Ministrisë së Brendshme.¹⁷

Në një takim me pronarët dhe administratorët e SHPS-ve, Ministri i Brendshëm vuri në dukje se si rezultat i pagave të pamjaftueshme dhe trajtimit jo të mirë të fuqisë punëtore, shërbimet e ofruara nga sektori privat i sigurisë

¹⁴ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 16 mars 2017.

¹⁵ Ministria e Brendshme. "Siguria publike: 1 muaj afat për standarde sigurie të Policisë Private, nisur nga burimet njerëzore". 8 shkurt 2017. <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/siguria-publike-1-muaj-afat-per-standarde-sigurie-te-policise-private-nisur-nga-burimet-njerezore>

¹⁶ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 7 mars 2017.

¹⁷ Ministria e Brendshme. "Për një Shqipëri më të sigurt, të cilën e bëjmë të gjithë bashkë". 17 shkurt 2017 <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/newsroom/lajme/per-nje-shqiperi-me-te-sigurt-te-cilen-e-bejme-te-gjithe-bashke&page=2>

ishin përkeqësuar.¹⁸ Ministri pranoi në media se rojet private të sigurisë ngjanin më tepër me një “ushtri skllevërish” që marrin paga qesharake në vetëm 40% të pagës së deklaruar dhe që nuk u paguhen pushimet dhe lejet vjetore.¹⁹

Zbatimi i dispozitës për pagën minimale është evidentuar si një nga problemet kryesore nga Policia e Shtetit gjatë kontrollit dhe inspektimeve të kryer tek SHPS-të.²⁰ Po ashtu, ka pasur probleme të vazhdueshme edhe me zbatimin e Kodit të Punës. Sipas këtij Kodi, për punën e kryer ndërmjet orës 19.00 dhe 22.00, shoqëritë duhet të paguajnë një shtese mbi pagë në orë jo më pak se 20% dhe për punën e kryer ndërmjet orës 22.00 dhe 6.00, shoqëritë duhet të paguajnë jo më pak se 50% më shumë për orë. Për punën e kryer gjatë ditës së pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare, shoqëritë duhet të paguajnë jo më pak 25% më shumë për orë.²¹

Duke pasur parasysh se në një masë të madhe rojet e sigurisë private punojnë gjatë turnit të mbrëmjes dhe të natës, paga që ata marrin është shumë më pak se 40%, nëse në llogaritje përfshijmë edhe mungesat që rrjedhin nga të drejtat e parashikuara në Kodin e Punës. Sipas ligjit rojet private të sigurisë duhet të punojnë 174 orë në muaj.

5. Prokurimet publike

Pavarësisht përpjekjeve për përmirësimin e procedurave dhe praktikave për prokurimin publik të shërbimeve të sigurisë, sistemi vazhdon të lëngojë nga probleme të shumta që kanë çuar në një dëmtim të mëtjetshëm të besimit në sistem.

¹⁸ Ministria e Brendshme. “Siguria publike: 1 muaj afat për standarde sigurie të Policisë Private, nisur nga burimet njerëzore”. 8 shkurt 2017. <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/siguria-publike-1-muaj-afat-per-standarde-sigurie-te-policise-private-nisur-nga-burimet-njerezore>

¹⁹ Ministria e Brendshme. “Siguria publike: 1 muaj afat për standarde sigurie të Policisë Private, nisur nga burimet njerëzore”. 8 shkurt 2017. <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/siguria-publike-1-muaj-afat-per-standarde-sigurie-te-policise-private-nisur-nga-burimet-njerezore>

²⁰ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 16 mars 2017.

²¹ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. Maj 2016. Neni 81 dhe 84.

Për të ndihmuar në trajtimin e kësaj çështjeje, Agjencia e Prokurimit Publik (PPA) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) miratuan një rekomandim të përbashkët në vitin 2015, i cili synonte t'u ofronte autoriteteve kontraktuese një udhëzim praktik se si të llogaritej fondi limit bazuar në llogaritjen mujore të faktorëve të tillë si paga minimale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pushimet dhe lejet, orët e përditshme të ofrimit të shërbimit.²²

Duke pasur parasysh se ofrimi i shërbimeve të rojës varet kryesisht nga burimet njerëzore, komponentët bazë që përdoren për llogaritjen e fondit limit të përcaktuar për prokurimin e shërbimeve të sigurisë përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore. Meqenëse çmimet për këto njësi jepen në legjislacion nëpërmjet tarifave fikse, ato nuk mund të ndryshohen nga entet prokuruese apo SHPS-të që marrin pjesë në tender.

Si rezultat, të gjitha SHPS-të konkurruese tentojnë të japin oferta të ngjashme ose shumë të përafërta që shpesh ndryshojnë vetëm me qindarka ose edhe në presje dhjetore të shumës së ofruar. Në mjaft raste ka më shumë se një fitues, kështu që entet prokuruese duhet të përdorin procedurën e shortit për të përcaktuar fituesin. Si rregull, SHPS-të humbëse paraqesin një ankesë, e cila kërkon kohë për t'u shqyrtuar e përfunduar dhe krijon kështu një hapësirë kohore mes përfundimit të kontratës ekzistuese dhe kontratës së re.

Për të trajtuar këtë problem, entet e prokurimit kanë përdorur gjithnjë e më shumë procedurën e negociatave. Në vend që të kontribuojë në zgjidhjen e problemit, rritja e numrit të prokurimit përmes procedurës së negociatave ka çuar në rritjen e pakënaqësive dhe të numrit të ankesave nga ana e SHPS-ve që e shohin këtë procedurë si të predispozuar për korrupsion.

Numri i madh i ankesave dhe diferencat e vogla mes ofertave të paraqitura nga SHPS-të e ndërlikojnë edhe më tej shqyrtimin dhe marrjen e të vendimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik si dhe shumë më pak të besueshëm për shoqëritë humbëse.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 Komisioni i Prokurimit Publik ka regjistruar dhe përpunuar 1,393 ankesa lidhur me prokurimet publike. Nga këto ankesa, 844, ose 60.5% të numrit të përgjithshëm të ankesave, janë paraqitur nga SHPS-të.²³

²² Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik. "Rekomandim për mënyrën e prokurimit të shërbimeve të sigurisë fizike private". Datë 01.04.2015.

²³ Të dhënat janë dërguar me shkrim për qëllime të këtij studimi nga Policia e Shtetit në 10 mars 2017.

Përballë kësaj situatë dhe duke pasur parasysh se rekomandimi i përbashkët i vitit 2015 nuk shërbeu për të zgjidhur problemet, APP dhe KPP e shfuqizuan atë rekomandim dhe nxorën një rekomandim tjetër në shkurt të vitit 2017. Rekomandimi i ri synonte të trajtonte problemin e mungesës së konkurrencës dhe rënien e vazhdueshme të çmimit të ofertave nga SHPS-të duke u rekomanduar autoriteteve kontraktuese që të kërkojnë nga SHPS-të të ofrojnë justifikime me shkrim për ofertat që autoritetet kontraktuese i konsiderojnë ‘anormalisht të ulëta’.²⁴ Rekomandimi parashikon që një ofertë është ‘anormalisht e ulët’ kur është 25% më e ulët se fondi limit.

Mbetet për t’u parë nëse ky rekomandim do të sjellë ndonjë përmirësim, por, duke pasur parasysh se origjina e mungesës së besimit i mbetet vetë autoriteteve kontraktuese dhe mënyrës se si ato interpretojnë ose përcaktojnë rregullat në mënyrë që procedura t’i përshtatet profilit të një SHPS të caktuar, shanset janë mjaft të pakta.

Nga perspektiva e SHPS-ve, problemi me prokurimet publike janë mungesa e sistemit të rankimit që do t’u jepte shoqërive pikë bonus për performancën më të mirë dhe mundësi më të mira për të fituar tenderin.

Një zgjidhje tjetër është shtyrja e afatit të kontratave. Aktualisht, kontratat zgjasin 6 muaj ose një vit maksimumi, ndërkohë që SHPS-të mendojnë se kontratat duhet të jenë të paktën 2 ose 3 vjeçare me qëllim që t’u bëjnë të mundur atyre të planifikojnë më mirë investimet dhe zhvillimet në burimet e tyre njerëzore.²⁵

²⁴ Agjencia e Prokurimit Publik. “Rekomandim për mënyrën e prokurimit të shërbimeve të sigurisë fizike private”. Nr. 183, datë 06.02.2017.

²⁵ Blerina Hoxha. “Epoka e (pa)sigurisë”. Revista Monitor 18 korrik 2016.
<http://www.monitor.al/epoka-e-pasigurise-2/>

Kutia 1. Ngjarje kryesore ku përfshihen SHPS që nga viti 2015

Që nga viti 2015, që përkon me fillimin e zbatimit të ligjit të ri, ka pasur katër ngjarje të mëdha ku janë përfshirë katër SHPS të ndryshme, ngjarje në të cilat kanë humbur rreth 13 milionë euro.

1. Shkurt 2015 – grabiten 3.2 milionë euro prej shoqërisë private të sigurisë “Eurogjici Security” gjatë kohës që rojet private të saj po ngarkonin vlerat monetare nga banka drejt autobлиндat për t’i transportuar në një vend tjetër.
2. Dhjetor 2015 – grabiten 3.8 milionë euro prej një grupi shoqërimi të shoqërisë private të sigurisë “Rogat Security” gjatë shoqërimit të vlerave monetare drejt Aeroportit Ndërkombëtare të Tiranës.
3. Qershor 2016 – grabiten 3 milionë euro prej një grupi shoqërimi të shoqërisë private të sigurisë “Nazeri 2000” nga grabitës që sulmuan kolonën brenda perimetrit të sigurisë të Aeroportit Ndërkombëtare të Tiranës.
4. Shkurt 2017 – grabiten 2.8 milionë euro prej një grupi shoqërimi të shoqërisë private të sigurisë “Jaguar Security” gjatë shoqërimit të vlerave monetare drejt Aeroportit Ndërkombëtare të Tiranës.

6. Përmirësimi i teknologjisë dhe logjistikës

Përveç përmirësimit të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve përmes përmirësimit të trajnimeve, verifikimit dhe shpërblimit, inkurajimi i investimeve në teknologji dhe logjistikë si një mjet për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga SHPS-të është një tjetër objektiv i Ligjit 75/2014.

Megjithatë, ashtu si në rastin e burimeve njerëzore, investimet në logjistikë dhe materiale kanë qenë të pamjaftueshme. Hetimet ndaj SHPS-ve që kanë dështuar në mbrojtjen e ngarkesës së tyre duke rezultuar në humbjen e miliona eurove kanë treguar se ato përdornin modele të vjetra të automjeteve të blinduara dhe kishin mangësi në mbrojtje deri në atë masë sa hajdutët ishin në gjendje të thyenin edhe dritaret e blindit duke përdorur çekiç. Për më tepër, të katër shoqëritë e përfshira në ngjarjet e mësipërme konsiderohen si ndër më të mirat në vend.

Nga perspektiva e SHPS-ve, kontratat afatshkurtra dhe ulja e çmimeve për shkak të rritjes së konkurrencës çojnë në pasiguri që i dekurajojnë shoqëritë të bëjnë investime duke u bazuar në plane afatgjate biznesi.²⁶

Hetimet e policisë pas ngjarjes së shkurtit të vitit 2017 evidentoi një sërë mangësish që kishin të bënin me logjistikën por edhe disa dështime si rezultat i praktikave të dobëta të sigurisë.

Sipas Policisë së Shtetit, SHPS-të e përfshira në humbjen e vlerave monetare kanë shkelur tetë rregulla të procedurave standarde, përfshirë këtu:

- Automjete të papërshtatshme të blinduara
- Shoferë të patrajnuar për të drejtuar automjete të blinduara
- Automjete shoqëruese (eksorte) pa logon dhe shenjat dalluese të shoqërisë së sigurisë private
- Nuk ishin vendosur mbikëqyrja me kamera
- Procedura të gabuara për vendosjen e pajisjeve të gjurmimit
- Dështimi i rojeve të sigurisë private për të njoftuar policinë në kohën e duhur
- Dështimi i qendrave të komandës dhe kontrollit të SHPS-ve
- Dështimi në përdorimin e armëve nga rojet private, edhe pse përdorimi i armëve në këto raste do të ishte plotësisht i ligjshëm.²⁷

7. Kontrolli dhe mbikëqyrja

Ligji 75/2014 i vë theks të veçantë kontrollit të SHPS-ve nga Policia e Shtetit, që përgjigjet për të siguruar që SHPS-të ofrojnë shërbimet e tyre në përputhje me detyrimet kontraktuale dhe ligjore.²⁸

Dështimi sistematik i SHPS-ve për të respektuar plotësisht kërkesat e ligjit, siç tregohet nga natyra e shkeljeve të identifikuara pas ngjarjeve të ndodhura

²⁶ Blerina Hoxha. "Epoka e (pa)sigurisë". Revista Monitor, 18 July 2016. <http://www.monitor.al/epoka-e-pasigurise-2/>

²⁷ Policia e Shtetit. "Konferenca për shtyp: Drejtori i Përgjithshëm për Sigurinë Publike, Drejtues i Lartë Altin Qato. 10 shkurt 2017. <https://asp.gov.al/index.php/2014-09-22-09-11-14/drejtori-i-policise-se-shtetit/275-slideshow-home/10852-konferenca-per-shtyp-drejtori-i-pergjithshem-per-sigurine-publike-drejtues-i-larte-altin-qato>

²⁸ Ligji Nr. 75/2014, Nenet 18, 19, 20

gjatë dy viteve të fundit, tregojnë se edhe Policia e Shtetit ka dështuar në punën e saj për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit.

Dështimet e tilla janë bërë aq rutinë sa që një ditë pas incidentit, e njëjta SHPS u thirr nga banka për të transportuar përsëri vlerat monetare.²⁹

Grabitja e muajit dhjetor 2015, që ndodhi brenda perimetrit të sigurisë së Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nxori në pah bashkëpunimin e dobët mes Policisë së Shtetit dhe SHPS-ve. Grabitësit ishin në gjendje të çanin sigurinë e aeroportit që ishte nën mbrojtjen e shoqërisë së sigurisë private të Aeroportit, të mposhtnin SHPS-në që transportonte vlerat monetare dhe të largoheshin, ndërkohë që Policia e Shtetit nuk ishte lajmëruar në kohë për të bërë të mundur ndërhyrje e saj.

8. Përfundime dhe rekomandime

Është e qartë se miratimi i ligjit 75/2014 nuk ka kontribuar në përmirësimin e situatës së përgjithshme të tregut të sigurisë private.

Dështime ose lidhen me dispozitat ligjore, pra me prezantimin e dispozitave të caktuara dhe afateve ligjore pa ndërmarrë më parë një analizë të plotë të zbatueshmërinë së tyre dhe rezultateve të pritshme, ose vijnë nga kapacitetet e dobëta administrative, mungesa e bashkërendimit mes institucioneve dhe agjencive të ndryshme dhe nga mungesa pothuajse e plotë e mbikëqyrjes.

Policia e Shtetit, e cila ka pjesën më të madhe të kompetencave për kontrollin dhe mbikëqyrjen e SHPS-ve, ka vetëm rreth 50 vetë që janë përgjegjës për kryerjen e një sërë detyrave, të tilla si licencimi i personelit, i armëve, i mjeteve të transportit, verifikimi, kontrolli i zbatimit të detyrimeve kontraktuale dhe kështu me radhë, për 2,721 kontrata. Situata me Inspektoratin e Punës dhe atë Social është disi më e mirë, pasi këto inspektorate kanë rreth 150 persona të përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e detyrave të inspektimit. Megjithatë, kjo nuk ka kontribuar në përmirësimin e situatës në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pagave dhe të drejtave të punës. Ç'është më e rëndësishme, duket se nuk ka bashkërendim të punës mes Policisë së Shtetit dhe Inspektoratit të Punës dhe atij Social, ndërkohë që një

²⁹ Policia e Shtetit. "Konferenca për shtyp: Drejtori i Përgjithshëm për Sigurinë Publike, Drejtues i Lartë Altin Qato. 10 shkurt 2017. <https://asp.gov.al/index.php/2014-09-22-09-11-14/drejtori-i-policise-se-shtetit/275-slideshow-home/10852-konferenca-per-shtyp-drejtori-i-pergjithshem-per-sigurine-publike-drejtues-i-larte-altin-qato>

bashkëpunim i tillë do të ndihmonte në plotësimin e përpjekjeve të tyre të ndara dhe në arritjen e rezultateve më të mira.

Mungon bashkëpunimi ose ky bashkëpunim nuk është i kënaqshëm edhe midis Policisë së Shtetit, SHPS-ve dhe kontraktorit të tyre kryesor, sektorit bankar. Shoqata Shqiptare e Bankave ka bërë thirrje për bashkëpunim më të mirë si mjet për t'i bërë masat e sigurisë edhe më efektive.³⁰

Një tjetër faktor i rëndësishëm që ka penguar zbatimin më të mirë të ligjit dhe eliminimin e tendencave negative të diskutuara më sipër është paaftësia e SHPS-ve për t'u organizuar në shoqata aktive dhe efektive. Çështje, të tilla si korrupsioni dhe konkurrenca negative, në të cilën suksesi i një shoqërie varet tërësisht nga dështimi i shoqërisë tjetër të përfshirë në tender, gjë që është më e dukshme jo vetëm në prokurimin publik, por edhe në fusha të tjera, mund të trajtoheshin më mirë nëse SHPS-të do të ishin organizuara dhe do t'i trajtonin këto problematika bashkërisht.

³⁰ Etleva Xhajanka. "Sfidat e sigurisë fizike në banka, AAB apelon për më shumë bashkëpunim". Agjencia Telegrafike Shqiptare. 21 shtator 2016 <https://www.ata.gov.al/sfidat-e-sigurise-fizike-ne-banka-aab-apelon-per-me-shume-bashkepunim/>

ENGLISH ABSTRACTS

POST MISSION ADJUSTMENT OF ALBANIAN MILITARY PERSONNEL

Redion Qirjazi

The issue of military personnel, and particularly veterans, being implicated with the criminal justice system has always been a contentious issue among academics and social work professionals. In field research has deliberated that there is an increasingly positive correlation between the military profession, combat missions, war trauma, Post-Traumatic Stress Disorder (PTSD) and increased rates of criminality. Although the phenomenon has been widely researched in many Western countries, the issue has never been debated in Albania, allowing for a buildup of cases in which military personnel has been involved with violent criminal and extremist activities.

After identifying a number of cases, this paper relied on previous literature and a series of grassroots research analyses such as: expert interviews, surveys and focus groups, to better understand the causes and impact of the phenomenon in Albania. Among the several causes identifies, the main ones were lack of effective psycho-social support, low income, unemployment after military service and difficulties of re-integrating into the society. The research also discusses the need for greater institutional and/or social awareness on the issue as well as offers recommendations how to best mitigate the risk of this phenomenon arising again in the future.

NATO'S SMALL STATES: ALBANIA AS A CASE STUDY

Brandon R. Burden

This paper examines Albania, one of the newest Alliance members, as a case study in the debate as to whether small states serve as security importers or providers in the North Atlantic Treaty Organization (NATO). It investigates the hypothesis that the benefits for NATO as a whole associated with Albania's NATO membership outweigh the costs. Albania's accession to NATO, the evolution of its roles, and its potential for expanded contributions are evaluated to assess the advantages and costs of Albania's membership in the Alliance.

This project also analyzes Albania's contributions to NATO during its Partnership for Peace (PfP) membership in 1994–2009 and as an Alliance member since 2009. This paper concludes that despite its weak economy, domestic issues, and numerically small military forces, Albania is a valued member of the Alliance that provides important capabilities in support of NATO's core tasks.

MACEDONIAN ACCESSION TO NATO AS A FACTOR OF REGIONAL STABILITY

Vesna Poposka

After NATO Summit in Romania 2008, a huge amount of disappointment towards the processes was obvious among Macedonian citizens. The situation in the foreign politics was used for internal daily politics and caused damage both inside and outside the country, especially toward interethnic relations.

Although the most of the homework has been done, the name issue and the lasting political crisis brought delay in the highly expected and well-deserved NATO membership. However, the recently elected Macedonian government has shown significant dedication over the issue. Hopefully, it will make up the way, since in security matters, it is “Hanibal ante portas”.

Due to the geopolitics, history, economic crisis and current security challenges, NATO membership for Macedonia can certainly improve the things, not only for Macedonia but for the region as a whole. The paper aims to approach those issues.

THE COMPLEX OF SECURITY IN THE WESTERN BALKANS: PROCESSES AND ISSUE

Nina SKOČAJIČ JUVAN, Anton GRIZOLD

After the wars came to an end following Yugoslavia's dissolution, the Western Balkans (WB) embarked upon a path of transition and reform which for various political, security, economic and other reasons is still continuing today. Based on a broader analysis of the security framework in the region, this paper identifies the main transformative processes and analyses their elements and implications, which constitute the complex security in the WB. We assess the situation at the level of individual countries and extrapolate the findings for the whole region and Europe. With a view to evaluating the region's dynamics and underlying issues that correlate with and mutually impact on each other, we divide the transformation period into three processes: stabilisation with state-building, democratisation with institution-building, and Euro-Atlantic integration.

Western Balkans security has been becoming ever more complex in the past 25 years due to these unfinished processes together with unresolved past issues arising from inter-related and mutually reinforcing political, socio-economic and ethno-national elements. Moreover, new-old security challenges have emerged that are further complicating the state of security. Instead of making progress with the democratic transition and the integration path, the various elements' interaction seems to place the region at risk of destabilisation and stalled progress coupled with the fact that not all requirements for stability have so far been met. The analysis concludes that the security framework is becoming increasingly complex and aggravated, in turn affecting the whole region's functioning and development and thus the entire Continent's stability and prosperity.

AN OUTLOOK ON THE ALBANIAN PRIVATE SECURITY MARKET SINCE ADOPTION OF THE LAW ON PRIVATE PHYSICAL SECURITY SERVICES IN 2014

Arjan Dyrmishi

In 2010 the Albanian parliament adopted a new law on private physical security services. The aim of the law is to regulate the activity of the private security companies (PSCs) by providing for (1) the vetting and licensing of PSCs and their personnel, (2) the rules of conduct of the PSCs, their contractual obligations and the control and oversight provisions (3) and the administrative and legal obligations, training and use of weapons and force.

However, in the period of two and half years since the adoption of the law there have been no major changes or improvements in the almost none of the areas the law sought to address.

This paper analyses the trends in the Albanian private security market since the adoption of the Law on Private Physical Security in 2014. The aim of this paper is to provide a platform for discussion among the private security companies and the institutions in charge of their control and oversight as well as other stakeholders and interested parties such as customers who purchase security services, donors, media and civil society organisations.